



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**DOKUMENTAT STANDARDE TË PROCEDURËS  
SHËRBIME KONSULENCE<sup>1</sup>**

**“HARTIMI I PROJEKTIT TË DETAJUAR TEKNIK (DETAILED DESIGN)  
TË PORTIT TË RI TREGTAR TË INTEGRUAR TË DURRËSIT NË PORTO  
ROMANO”**

---

<sup>1</sup>

Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

## I NJOFTIMI I KONTRATËS

### Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

#### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri                      Autoriteti Portual Durrës  
Adresa                    Lagjja nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës  
Tel/Fax                    +355 52 2 93420  
E-mail                    s.mece@durresport.al  
Faqja e Internetit      www. durresport.al

#### 1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion qëndror	Institucion i pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njësie qeverisjes vendore	Tjetër
<input type="checkbox"/>	<b>X</b>

#### 1.3 Kontratë në kuadrin e një Marrëveshjeje të veçantë ndërmjet Shqipërisë dhe një Shteti tjetër

Po            Jo      **X**

### Seksioni 2                    Objekti i kontratës

#### 2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-97696-06-08-2021

#### 2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”

Shërbime Konsulence  
**X**

#### 2.3 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuadër

Po            Jo      **X**

#### 2.4 Lloji i Marrëveshjes Kuadër

Me një Operator Ekonomik

Me disa operatorë ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po  Jo

Në Marrëveshjen Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara, të jepen arsyet e përzgjedhjes së kësaj lloj Marrëveshje Kuadër

--

2.5 Numri i operatorëve ekonomikë me të cilët do të perfundojë Marrëveshja Kuadër: \_\_\_\_\_ (Këtu duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër).

2.6	Kushtet që do zbatohen në rastin e rihapjes së konkurimit dhe/ose përdorimi i mundshëm i blerjes elektronike	
-----	--	--

2.7 Autoriteti kontraktor / Autoritetet kontraktore, të cilat do të lidhin marrëveshjen kuadër:

---

---

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

1. Fondi limit/Vlera e pritshme e kontratës **1.145.354.372,96** (një miliard e njëqind e dyzet e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy / presje nëntëdhjetë e gjashtë) leke pa tvsh
2. Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është** \_\_\_\_\_
3. Burimi i Financimit: **Vënë në dispozicion nga fondet e vetë institucionit**
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: **“Hartimi i Projektit të detajuar teknik (Detailed Design) të Portit të ri tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano”**

**2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në muaj: **8 (tetë) muaj** nga data e lidhjes së kontratës.

ose

duke filluar nga □□/□□/□□□□ me përfundim në □□/□□/□□□□

**2.9.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër**

<b>Kohëzgjatja në muaj:</b> □□ose ditë: □□□□ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër(jo më shumë se (4) vjet)
Ose duke filluar nga □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)
Përfunduar më □□/□□/□□ (dd/mm/vvvv)

**2.10 Vendi i kryerjes së shërbimeve, objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:**

**2.11 Ndarja në Lote:**

Po            Jo     

Nëse po,

**2.12 Përshkrim i shkurtër i loteve**

(Objekti dhe fondi limit i loteve)1 \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_ etj

Një Ofertues mund të aplikojë për [një lot], [disa lote], [të gjitha lotet]. Për çdo lot paraqitet një ofertë e veçantë.

**2.13 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme (nëse ka): □ □

Ose: nga □ □ në □ □

**2.14 Do të pranohen variantet:**

Po            Jo     

**2.14.1Do të pranohet nenkontraktimi:**

Po            Jo

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim: \_\_\_\_\_

Autoriteti kontraktor do t'i beje pagesa te drejperdrejte nenkontraktorit:

Po  Jo

### Shenime te tjera

- Ligji i zbatueshem eshte ligji nr. 162/2020, date 23/12/2020, "Per Prokurimin Publik"
- Ne perfundim te procedures se prokurimit, per nenshkrimin e kontrates, operatori ekonomik duhet te ketë:
- Kopje te Certifikates elektronike per Fiskalizimin, per tatimpaguesit qe perdorin Platformen Qendrore te Faturave.
- Kopje te Certifikates elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje te vlefshme te Kontrates se lidhur me Shoqerine e Certifikuar per zgjidhjen softwer-ike ne perdorim, per tatimpaguesit qe leshojne faturat nepermjet zgjidhjes softwer-ike.

### Seksioni 3 Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

**3.1 Kriteret e Pranimit:** sipas shtojces 10.

**3.2 Sigurimi i Ofertes:** ( i zbatueshem ne rastin e procedurave te prokurimit me vlerë me te larte se kufiri i larte monetar, ne rast se kerkohet nga autoriteti kontraktor). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, sipas Shtojces 6. Vlera e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte **22.907.087,46 (njëzet e dy milion e nëntëqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e shtatë/ presje dyzet e gjashtë) Lekë**

Ne rastet e dorëzimit te ofertes per Lote, vlera e sigurimit te ofertes, kur kerkohet, per secilin nga Lotet eshte si me poshte:

Loti 1 \_\_\_\_\_ Lekë

Loti 2 \_\_\_\_\_ Lekë

### Seksioni 4 Procedura

**4.1 Lloji i procedures:** Shërbim konsulence

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore:

#### **Faza 1 – Shprehja e interesit dhe Parakualifikimi (lista e shkurtër):**

Kandidatët do të dorëzojnë kërkesën për shprehje interesi dhe dokumentat e kerkuara ne DT. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga Kandidatët, dhe do të vlerësojë

nëse ky dokumentacion plotëson kërkesatë përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kandidatët, që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit, skualifikohen dhe njoftohen menjëherë për këtë skualifikim.

Në përfundim të kësaj faze, kandidatët e kualifikuar përshihen në një listë të shkurtër, e cila duhet të përmbajë të paktën 2 (dy) kandidatë.

**Faza 2 – Paraqitja e propozimeve:** Autoriteti Kontraktor dërgon një ftesë për të dorëzuar propozime, kandidatëve që janë kualifikuar në Fazën 1 (Ofertuesit e përzgjedhur në listën e shkurtër).

Propozimet përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kriterëve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

#### 4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**Oferta më e mirë bazuar në:**

Çmim

dhe

Propozim teknik

**Kriteret e Vleresimit teknik**

**Pikët**

- |       |  |      |
|-------|--|------|
| (i)   | Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit  | [- ] |
| (ii)  | Metodologjia e Propozuar<br>(Përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative) | [- ] |
| (iii) | Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar   | [- ] |
| (iv)  | Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)  | [- ] |

- **Shikoni dokumentin e ngarkuar në SPE "Lidhja 4 - kriteret e vleresimit"**

#### 4.3 Afati kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi :

**Data: 09/07/2021**(dd/mm/vvvv) **Ora:11:00**

Vendi : [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Kur kërkesa për shprehje interesi kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

**4.4 Afati kohor për hapjen e kërkesës për shprehje interesi :**

**Data: 09/07/2021**(*dd/mm/vvvv*) **Ora:11:00**

Vendi : [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**Informacioni që merret gjatë hapjes publike të kërkesave, që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesa, në bazë të kërkesës së tyre.**

**4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150** (*e shprehur në ditë*)

**4.6 Gjuha(-ët) për hartimin e propozimit dhe shprehjes së interesit:**

Shqip	<input checked="" type="checkbox"/>	Anglisht	<input checked="" type="checkbox"/>
Tjetër	_____		

**Seksioni 5 Informacione plotësuese**

**5.1 Dokumenta me pagesë (i zbatueshëm vetëm për procedurat që nuk zhvillohen me mjete elektronike):**

Po	<input type="checkbox"/>	Jo	<input type="checkbox"/>
----	--------------------------	----	--------------------------

*Nëse Po*

Monedha	_____	Çmimi	_____
---------	-------	-------	-------

Ky çmim mbulon kostot aktuale të kopjimit dhe shpërndarjes së DT tek Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë DT para blerjes së tyre.

**5.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

---

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **09/06/2021**

**Njoftimi i kontrates për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri	Autoriteti Portual Durrës
Adresa	Lagjja nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës
Tel/Fax	+355 52 2 93420
E-mail	s.mece@durresport.al
Faqja e Internetit	www.durresport.al

**2. Lloji i procedurës se prokurimit: "Shërbim Konsulence"**

**3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Hartimi i Projektit të detajuar teknik (Detailed Design) të Portit të ri tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano"**

**4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-97696-06-08-2021**

**5. Fondi limit 1.145.354.372,96** (një miliard e njëqind e dyzet e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy. pikë nëntëdhjetë e gjashtë) **leke pa tvsh**

**6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:** 8 (tetë) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

**7. Afati kohor për dorëzimin e kërkesës për shprehje interesi: date: 09/07/2021 Ora:11:00**

**8. Afati kohor për hapjen kërkesave për shprehje interesi: date 09/07/2021 Ora:11:00**

**Ligji i zbatueshëm është ligji nr. 162/2020, datë 23/12/2020, "Për Prokurimin Publik"**



## II. UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË

### Seksioni 1. Hartimi i kërkesës/ofertës

- 1.1 Kandidatët/Ofertuesit janë të detyruar të përgatisin kërkesën/ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Kërkesat/Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.
- 1.2 Kandidatët/Ofertuesit përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij. Autoriteti Kontraktor nuk është përgjegjës për këto kosto.
- 1.3 Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i kërkesës/ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë qe nuk fshihet. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertes duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e kërkesës/ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga Personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në kërkesë/ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.
- 1.4 Në rast të ofertave të paraqitura nga një bashkim operatorësh ekonomikë, oferta duhet të shoqërohet me Prokurën/autorizimin me Shkrim për Personat e Autorizuar që do të përfaqësojnë bashkimin gjatë procedurës së prokurimit
- 1.5 Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.

### Seksioni 2 Faza I - Parakualifikimi(Lista e shkurtër)

- 2.1 Paraqitja e kërkesave për shprehje interesi duhet të bëhet brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Njoftimin e Kontratës.

Me plotesimin e Shtojcës“Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së Dispozitave Ligjore në Marrëdhëniet e Punës,, operatori ekonomik pranon se ka kontrata pune me çdo punëmarrës dhe që respekton të drejtat e punëmarrësve, sipas dispozitave të Kodit të Punës (ku përfshihen edhe të drejtat e gruas shtatzënë, gruas që sapo ka lindur dhe/ose gruas me fëmijë në gji, të parashikuara në nenet 104, 105, 105/a, 106, 108 dhe 115), dhe të legjislacionin të punës në tërësi.

Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i kthehen Kandidatit të pahapura.

**Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të kërkesave që paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesat e tyre.**

- 2.2 Kërkesat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

\_\_\_\_\_.

**Kur Kërkesa kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

- 2.3 Për procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore, operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Kandidatit dhe të shënuar: “Kërkesë për parakualifikimin në procedurën Nr. e Njoftimit të Kontratës \_\_\_\_\_  
**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS. DHE JOPARA \_\_\_\_\_**  
**(dd/mm/vv), \_\_\_\_\_ orë”.**

**Kur Kërkesa kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë atë në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

### **Seksioni 3 Faza II Dorëzimi dhe vlerësimi i propozimeve**

- 3.1 Propozimet do të dorëzohen vetëm nga kandidatët që kanë marrë një ftesë për propozim nga Autoriteti Kontraktor, sipas modelit të dhënë në Shtojcën 2.

- 3.2 **Propozimi duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

Propozimi përbëhet nga propozimin teknik dhe propozimi ekonomik.

#### **Propozimi teknik përfshin:**

- a) Përshkrim të detajuar të Shërbimeve të propozuara dhe metodologjinë e tyre, që përmbajnë gjithë informacionin e kërkuar në Dokumentat e Tenderit, dhe që është i mjaftueshëm për Autoritetin Kontraktor, për të përcaktuar nëse Shërbimet e propozuara plotësojnë kërkesat e specifikuar në Termat e Referencës;
- b) Listën dhe Curriculum Vitae të Personelit Kryesor;
- c) Grafikonin e Zbatimit;
- d) Propozimin alternativ teknik, nëse lejohet;  
*(çdo dokument tjetër të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor)*

#### **Propozimi ekonomik:**

- a) Formatin e Strukturës së Çmimit (shtojca 4);

Një Ofertues duhet të paraqesë vetëm një propozim.

b) Deklarata për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 4/1.

3.3 Fshehtësia e procesit sipas nenit25 të LPP-së.

3.4 Për procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore ofertuesit duhet të dorëzojnë propozimin origjinal, i cili përbëhet nga zarfi i propozimit teknik dhe zarfi i propozimit ekonomik, të cilët identifikohen qartë duke bërë shënimet përkatëse.

Propozimiduhet të futet në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar: “Propozim për shërbime konsulence \_\_\_\_\_ ; Nr. e Njoftimit të Kontratës\_\_\_\_\_

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS DHE JO PARA \_\_\_\_\_ (dd/mm/vv), \_\_\_\_\_ orë”.**

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

3.5 Për procedurat e prokurimit, që zhvillohen në rrugë shkresore ofertuesit mund të modifikojnë ose të tërheqin propozimet e tyre, me kusht që ky modifikim ose tërheqje të kryhet para afatit kohor përfundimtar për paraqitjen e propozimeve. Si modifikimet, ashtu edhe tërheqjet duhet t'i komunikohen Autoritetit Kontraktor me shkrim para datës së fundit për dorëzimin e ofertave. Rrjedhimisht, zarfi që përmban deklaratën e Ofertuesit duhet të shënohet përkatësisht: **“MODIFIKIM PROPOZIMI ”** ose **“TËRHEQJE PROPOZIMI ”**.

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, ofertuesi mund të modifikojë në çdo kohë ofertën deri para afatit kohor përfundimtar për dorëzimin e ofertave pa patur nevojë për ndonjë komunikim me autoritetin kontraktor, pasi veprimet kryhen në llogarinë e tij, në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

#### **Seksioni 4** **Përlllogaritja e ofertës ekonomike**

4.1 Të gjitha çmimet e propozuara duhet të jenë fikse dhe jo objekt rishikimi. Kandidati duhet të dorëzojë:

-Tarifa për njësinë e kohës për çdo person;

-Përmbledhje të kostove direkte dhe indirekte dhe shpenzimeve, duke përfshirë taksat, tarifat, tarifat e liçensave, siguracionin dhe kosto të tjera të lidhura me kryerjen e Shërbimeve;

-Çmimin total të propozimit pa TVSH; dhe vlerën e TVSH, nëse është e aplikueshme.

- (ndonjë informacion tjetër të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor).

#### **Propozimet Alternative**

- 4.2 Nëse lejohet në Dokumentat e Tenderit, Ofertuesit mund të ofrojnë propozime alternative teknike për kërkesat e specifikuar në Dokumentat e Tenderit. Autoriteti Kontraktor mund të shqyrtojë vetëm alternativat teknike, nëse ka të tilla, të atij ofertuesi që ka paraqitur propozimin fitues, në pajtim me të gjitha kërkesat e DT.
- 4.3 Nëse kërkohet në Dokumentat e Tenderit, secili ofertues duhet të paraqesë sëbashku me propozimin kryesor, një propozim të veçantë për shërbime të caktuara, të përshkruara në Dokumentat e Tenderit, të cilat Ofertuesi mund t'i përfshijë ose jo në kontratë. Këto propozime të veçanta quhen "propozime alternative/të mundshme". Përzgjedhja e propozimit fitues do të marrë në konsideratë propozimet alternative/të mundshme, vetëm nëse një gjë e tillë lejohet specifikisht në Dokumentat e Propozimit.
- 4.4 Në rastin e një marrëveshje kuadër ku të gjitha kushtet NUK janë përcaktuar Çmimet për kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk janë të fiksuara, ato janë objekt i ndryshimit pas një Mini-konkurrimit në mes të palëve në marrëveshjen kuadër.
- 4.5 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Mospajtimi me kërkesat për sigurimin e ofertës do të ketë si pasojë refuzimin e ofertës.
- 4.6 Sigurimi i Ofertës, kur kërkohet, mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare e pakushtëzuar,
  - b) garanci sigurimi

Formulari i sigurimit të ofertës duhet të nënshkruhet nga lëshuesi (Banka, kompania e sigurimit, etj) dhe duhet të dorëzohet së bashku me ofertën para hapjes së ofertave, përndryshe oferta do të refuzohet.

Dokumentat si më sipër duhet të jenë të vlefshëm përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së ofertës. Në rastin kur sigurimi i ofertës ka formën e një garancie bankare, Autoriteti Kontraktor ia rikthen ofertuesve sigurimin përkatës brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

#### 4.7 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon që nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshëmrinë e ofertave, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund t'a refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton Autoritetin Kontraktor me shkrim, dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një

sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti Kontraktor do të refuzojë ofertën.

4.8 Veprimet e jashtëligjshme sipas Nenit 26 të LPP-së

## **Seksioni 5. Vlerësimi i propozimeve**

### **Vlerësimi i Propozimeve Teknike**

5.1 Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

### **Hapja e Propozimeve Financiare**

5.2 Pas përfundimit të vlerësimit të propozimeve teknike, Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesit, propozimet e të cilëve janë refuzuar, pasi nuk kanë plotësuar disa aspekte të rëndësishme të Kërkesave, ose nuk kanë arritur të marrin rezultatin minimal, nëse ky është parashikuar. Në përfundim të afatit të ankimit Autoriteti Kontraktor i dërgon njoftimin për ditën dhe orën e hapjes së propozimeve ekonomike të gjithë kandidatëve, propozimet ekonomike të të cilëve do të hapen. Në datën dhe orën e përcaktuar, Autoriteti Kontraktor hap propozimet ekonomike. Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e propozimeve. Zarfë ku shkruhet “Propozimi Ekonomik” për secilin propozim që nuk është refuzuar më parë, do të hapet dhe informacioni i mëposhtëm do të shpallet e regjistrohet: emri i Ofertuesit, rezultati i vlerësimit të propozimit teknik, Çmimi i propozuar, siç shprehet në propozimin ekonomik.

### **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike**

5.3 Autoriteti Kontraktor përcakton nëse propozimet ekonomike janë të plota, korrigjon ndonjë gabim aritmetik dhe për qëllime krahasimi e vlerësimi, i konverton të gjitha çmimet e propozimit në një monedhë të vetme. Autoriteti Kontraktor rendit dhe cakton një rezultat për çdo propozim ekonomik.

### **Krahasimi i Propozimeve**

5.4 Autoriteti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata dhe për lidhjen e kontratës.

**Kriteret e vlerësimit**

- **shiko dokumentacionin e ngarkuar ne SPE "Lidhja 4 - kriteret e vleresimit"**

5.5 Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

<b>Kriteret e Vleresimit</b>	<b>Pikët</b>
(i) Përvoja per Pune te Ngjashme te Konsulentit	[0-10]
<b>Nënkriteret</b>	
<b>i/a Përvoja për punë të ngjashme</b>	<b>40-80%</b>
Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.	
<b>i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë</b>	<b>10-20%</b>
Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.	
Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.	
<b>(ii) Metodologjia e Propozuar</b>	<b>[20-30]</b>
<b>Nënkriteret</b>	
ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia	[20-30%]
ii.b Plani i punës dhe grafiku u dorëzimit të projektit	[30-40%]
ii.c. Organizimi i Stafit	[20-30%]
<b>ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia:</b> Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqsjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).	
<b>ii/b.Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit:</b> Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlihdhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqsjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar	

kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave te Referencës në plan pune konkret. Njëlistë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

**ii/c. Organizimi dhe Staf:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar** [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b. Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

**(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet)** [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

**Total (Propozimi Teknik) 100%**

- **Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

### **Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik:  $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$**

**Pesha për Propozimin Ekonomik:  $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Operatori ekonomikëqë ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

## **5.6 Korigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra**

5.6.1 Autoriteti Kontraktor korigjon ato gabime në propozimin ekonomik, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të propozimeve. Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t'a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korigjimin e propozuar, atëherë propozimi do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

5.6.2 Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korigjohen nga Autoriteti Kontraktor, sipas shëmbujve të mëposhtme:

- a) në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, atëherë do të mbizotërojnë shumat e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shuma në fjalë lidhet me një gabim aritmetik,
- b) nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojnë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korigjohet shuma në total,
- c) nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojnë nëntotali dhe totali duhet të korigjohet. Shumat e korigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar



5.7 Ankimi administrativ në dispozicion të Operatorëve Ekonomikë sipas nenit 63 të LPP-së.

## **Seksioni 6. Nënshkrimi i kontratës**

### **6.1 Njoftimi i fituesit**

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit, siç parashikohet në Shtojcën 17. Një kopje e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, siç kërkohet në Nenin 58 të LPP-së.

### **6.2 Sigurimi i kontratës**

6.2.1 Autoriteti Kontraktor kërkon sigurim për ekzekutimin e kontratës. Shuma e sigurimit për ekzekutimin e kontratës do të jetë 10 % e vlerës së kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, sipas Shtojcës 24të DT, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet para nënshkrimit të kontratës.

6.2.2 Sigurimi për ekzekutimin e kontratës mund të dorëzohet në një nga format e mëposhtme:

- i. garanci bankare
- ii. garanci sigurimi

**Ky formular nuk përdoret nga autoritetet kontraktore në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale.**

### **6.3 Njoftimi i kontratës së nënshkruar**

Në pajtim me RrPP, pas nënshkrimit të kontratës, autoriteti kontraktor dërgon një njoftim në APP për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

**Shënim:** Autoritetet kontraktore nuk duhet të ndërhyjnë për të bërë asnjë lloj ndryshimi në dokumentat e tenderit nga pika 1 në pikën 6.

### III. SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e DT:

- Shtojca 1: Kërkesë për shprehje interesi
- Shtojca 2: Ftesapër Propozim
- Shtojca3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
- Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
- Shtojca 4/1: Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur
- Shtojca 5: Formulari i Ftesës për Propozim (në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
- Shtojca 6: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 7: Formulari i Informacionit Konfidencial
- Shtojca 8: Deklarata per konflikt interesi
- Shtojca 9: Deklarate për disponueshmerinë e stafit te konsulentit
- Shtojca 10: Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes
- Shtojca 11: Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme
- Shtojca 11/1: Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave Ligjore në marëdhëniet e punës
- Shtojca 12: Specifikimet teknike
- Shtojca 13: Planifikimi i kontratave në marrëveshjen kuadër
- Shtojca 14: Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit
- Shtojca 15: Termat e Referencës
- Shtojca 16: Formular i Njoftimit te skualifikimit
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 18: Formulari i Njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 19: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Shtojca 20: Kushtet e Vecanta të Kontratës
- Shtojca 21: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar
- Shtojca 22: Formulari i Njoftimit të Kontratës së Nënshkruar për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike
- Shtojca 23: Formulari i Anulimit të Procedurës
- Shtojca 24: Formulari i Sigurimit të Kontratës
- Shtojca 25: Formulari i Ankesës ne autoritetin kontraktor
- Shtojca 26: Draft Marrëveshja Kuadër ku Jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara
- Shtojca 27: Draft Marrëveshja Kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik* ]

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI**

---

*(Emri i operatorit ekonomik )*

*[Data\_\_\_\_\_]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për shprehje interesi për këtë procedurë:

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**Shtojca 2.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor ]

**FTESË PËR PROPOZIM**

*(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për shprehje interesi)*

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

\_\_\_\_\_

**Procedura e Prokurimit:** \_\_\_\_\_

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të kapaciteteve tuaja ligjore, financiaro-ekonomike dhe teknike, jeni kualifikuar për në fazën e ofertimit .

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [këtij autoriteti kontraktor]

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin e propozimit është :**

**Data, ora dhe adresa**

Data □□/□□/□□□□(dd/mm/vvvv)

Ora: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

**Kur propozimi kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

**Afati kohor për hapjen e propozimeve është:**

**Data, ora dhe adresa**

Data □□/□□/□□□□(dd/mm/vvvv)

Ora: \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

**Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të propozimeve, qe paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip

Anglisht

Tjetër \_\_\_\_\_

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

Autoriteti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata dhe për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimittuaj.

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### **FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës:[objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- 1 Kemi shqyrtuar Dokumentat e kesaj procedure dhe paraqesim këtë Propozim, **pa rezervime ose përjashtime** për kërkesat ose afatet dhe kushtet e shprehura këtu.
- 2 Ne ofrojmë të kryejmë Shërbimetsiç specifikohet në Dokumentat e kesaj procedure dhe në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
- 3 Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.
- 4 Propozimi ynë do të jetë i vlefshëm për periudhën e specifikuar në DT.
- 5 Nëse propozimi ynë pranohet, Ne do të bejme sigurimin e kontratës, siç parashikohet në DT.
- 6 Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë prokurim.
- 7 Neautorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/dokumentet, që i bashkëlidhen kësaj oferte.
- 8 Pajtohem për të firmosur kontratën sipas kushteve të kontratës nëse shpalle fitues.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik* ]

**STRUKTURA E PROPOZIMIT EKONOMIK**

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës:** (Nëntotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** (Nëntotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** (Nëntotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** (Nëntotali i detajuar)

**TOTALI**

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 4/1**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË**

**Për paraqitje Oferte të Pavarur**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: \_\_\_\_\_; nga Autoriteti Kontraktor: \_\_\_\_\_; me objekt: \_\_\_\_\_; me fond limit: \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: \_\_\_\_\_ që:  
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
  - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
  - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):



## Dokumentat standarte të tenderit

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Nëveçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), tëpërmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;  
b) metodat, faktorët ose formulat e përdorur për llogaritjen e çmimit;  
c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,  
d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6. b).

---

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

---

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

## Shtojca 5

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor në Marrëveshjen Kuadër gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit]

### FTESA PËR PROPOZIM

(shkruani emrin e Autoritetit Kontraktor)

fton për të paraqitur propozime në procedurën për kryerjen e shërbimeve të mëposhtme:

.....  
.....  
.....

(jepni një përshkrim të saktë të objektit të kontratës dhe sasisë siç përkufizohet në Dokumentacionin e Tenderit (DT)).

Vendi i kryerjes së shërbimit

(jepni një përshkrim të shkurtër)

Kohëzgjatja e shërbimit \_\_\_\_\_

Propozimi duhet të paraqitet

.....[Je  
p adresën e saktë]

Përpara

.....  
[Përcaktoni datën dhe orën e afatit përfundimtar]

Forma e komunikimit:

Me shkrim \_\_

Elektronik ( email, fax etj.) \_\_\_\_\_

Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

## Shtojca 6

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik, kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS<sup>2</sup>

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.references ne faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej **22.907.087,46 (njëzet e dy milion e nëntëqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e shtatë/ presje dyzet e gjashtë) Lekë**

si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

<sup>2</sup> Vetëm për procedurat mbi kufirin e lartë monetar

**Shtojca7**

**LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

**KUJDES**

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

Vula

**Shtojca 9**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit<sup>3</sup>**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, **Deklarojse:**

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacione të nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

---

<sup>3</sup>Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga seciliprij anëtarëvetë stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

## Shtojca 10

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.**

**Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

**a.** Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht<sup>4</sup>;

**b.** Prokura e posaçme.

**Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 14, pika 2, nëse oferta dorëzohet nga një grup operatorësh ekonomikë, marrëveshja e noterizuar dhe prokura e posaçme duhet të paraqiten pasi ky grup operatorësh të jetë shpallur fitues.**

---

<sup>4</sup>Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.



## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 6; me një vlerë prej 22.907.087,46 (njëzet e dy milion e nëntëqind e shtatë mijë e tetëdhjetë e shtatë/ presje dyzet e gjashtë) Lekë*

*b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*

*c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;*

*ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 11/1:*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 1. Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikim

### 2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

**2.1** Një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2020 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument). Në rastet e OE të huaj, kjo pikë do të provohet me anë të një dokumenti lëshuar nga institucionet zyrtare në vendet ku OE janë të regjistruar.

**2.2** Pasqyra financiare (Bilanci) e viteve 2018, 2019 dhe 2020 të certifikuara nga organe kombëtare ose ndërkombëtare të njohura nga ana ligjore në rastin e OE të huaj.

**2.3** Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore për vitet 2018, 2019, 2020, e cila duhet të mos jetë më e vogël se 40% e fondit limit.

### 3. Kapaciteti teknik

**3.1** Përvoje e mëparshme, për shërbime të ngjashme, nuk duhet të jetë më e vogël se 10% e fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara;

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

### **3.2 Licenca - (Licenca dhe certifikime profesionale te kompanive projektuese dhe stafit)**

Subjektet Projektuese, pjesmarrëse kërkohen të zotërojnë, Liçensa në Projektim, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për liçensimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Për ofertuesit e huaj, në zbatim të dispozitave ligjore më sipër, duhet të kenë të ekuivalentuar licensën sipas licensimit të Legjislacionit Shqiptar.

- Kat 2. Projektues Arkitekt:
  - Pika a. Projektim arkitekturor për objekte banimi -objekte industriale -objekte turistike;
  - Pika b-1. 1.objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastructure;
- Kat 3. Projektues Konstruktor:
  - Pika a. Objekte civile -industriale -turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate;
  - Pika b-1. Objekte civile -industriale -turistike mbi 5 kate -2. objekte me skelet metalik;
  - Pika c-1. Objekte me shkallë të lartë vështirësie Beton arme -metalike -2. troje dhe shpate me qëndrueshmëri të ulët;
- Kat 4. Projektues Instalator:
  - Pika a. Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
  - Pika b. Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme;
  - Pika c. Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
  - Pika f. Projektim të sistemeve kundra zjarrit
  - Pika g. Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa
  - Pika h. Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.)
  - Pika i. Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj
  - Pika j. Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale
- Kat 5. Projektues Vepra hidraulike:
  - Pika b. Furnizim me ujë -kolektorë shkarkimi;

Pika c. Ujësjetës-kanalizime urbane -rurale;

Pika d. Vepra ujitje -kullimi -impiante vaditëse -diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) -damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino;

Pika h. Vepra hidroteknike -kulla ekuilibri -porte –pontile;

- Kat 6. Projektues Rrugë – Hekurudha:

Pika a. Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore;

Pika e. Hekurudha -degëzime hekurudhore;

- Kat 8. Projektues Gjeodet:

Pika a. Rivelime inxhinierike;

Pika b. Rilevime inxhinierike kadastrale;

Pika c. Sisteme GIS;

Pika d. Bazamente gjeodezike

Pika e. Projektim fotogrametrik dhe hartografik

- Kat 9. Studim Gjeologo-Inxhinierik - Hidrogjeologjik:

Pika a. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile -ekonomike deri 5 kate;

Pika c. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/Ç, porte aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha;

Pika d. Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët

Pika e. Studime e projektme hidrogjeologjike

- Kat 10. Projektim i Impianteve të Prodhimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike:

Pika d. Nënstacione elektrike, primare sekondare -linja të tensionit të lartë

Pika e. Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës -linja të tensionit të ulët -të mesëm

- Kat 11. Projektim i Impianteve të Prodhimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike:

Pika a. Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime;

Pika b. Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën;

Pika d. Sinjalistikë ndriçuese në infrastructure

- Kat 12. Studime të Sizmologjisë Inxhinierike:

Pika a. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për klasifikimin gjeosizmik të trojeve;

Pika b. Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore;

Pika c. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore të të gjitha llojeve, ura, tunele, viadukte etj;

Pika d. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për trojet ku ndërtohen objekte komplekse, si: hidrocentrale (për çdo fuqi të instaluar), termocentrale, porte, aeroporte, tunele për vepra hidroteknike, bazamente për ngarkesa të mëdha dhe objekte industriale

Pika e. Studime/vlerësime të sizmologjisë inxhinierike për troje e shpate me qëndrueshmëri të ulët dhe për troje ndërtimore të shkriçta me mundësi lëngëzimi

Pika f. Studime të rrezikut sizmik në nivel rajonal (mikrozonime sizmike) dhe në nivel kombëtar (hartat kombëtare të rrezikut sizmik)

**3.3** Ekspert Mjedisor të certifikuar nga Ministria e Mjedisit, si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor.

**3.4** Ekspert Zjarrfikës Privat, i certifikuar për ushtrimin e profesionit “Ekspert Zjarrfikës Privat” nga MNZSH (MZSH).

*Individët apo personat juridik të cilët disponojnë licenca të cilat nuk janë në përputhje me pikat e Lidhjes 2 “Kategorite në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim”, të V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016, duhet të bëjnë rinovimin dhe ekuivalentimin e tyre. Në rastin e mosparaqitjes së licencave, ofertuesit nuk do të merren në konsideratë për kualifikim. Licencat duhet të jenë të paraqitura dhe të plotësohen nga licenca e subjektit si dhe të gjitha pikat e sipërpërmendura të cilat jepen edhe për individë duhet të përmbushen nga shumatorja e pikave të licencave individuale të stafit inxhinierik.*

*Pikat e licencave apo certifikimeve që nuk trajtohen në V.K.M. nr. 943, datë 28. 12. 2016 duhet të jenë në përputhje me V.K.M. Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Nëpërmjet Qendrës Kombëtare Të Licencimit (Qkl) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”, Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, V.K.M. Nr. 407 date 19.06.2019 “Për Miratimin e Procedurës, to Kategorive, Kushteve, Kërkesave to Kualifikimit dhe te Eksperiencës Profesionale për Personin, te Cilit i Lëshohet Certifikata e Audituesit Energjetik” dhe akteve nënligjore në fuqi.*

### **3. 5 Staf**

Numri dhe personeli i kërkuar primar dhe sekondar për t'u identifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

a. Drejtues Projekti që mban një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një minimum prej 15 vjet përvojë, duhet te paraqesi: Diplomë, kontratë pune, CV që pasqyron përvojën e inxhinierit të propozuar.

b. Një menaxher projekti që mban një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me experience minimale prej 10 vjet përvojë, duhet te paraqes: Diplomë, kontratë pune, CV që pasqyron përvojën e inxhinierit të propozuar.

c. Një Inxhinier hidroteknik - që mbajnë një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një minimum 7 vjetësh përvojë;

d. Një Inxhinier i Strukturave Detare që zotëron një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një përvojë minimale prej 7 vjetësh;

e. Një inxhinier Ndërtimi profili Strukturist që zotëron një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një minimum prej 7 vjet përvojë;

f. Një inxhinier Ndërtimi që zotëron një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një minimum prej 7 vjet përvojë;

g. Një Inxhinier Gjeolog që zotëron një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një përvojë minimale prej 7 vjetësh;

h. një inxhinier mjedisi që mban një Master Shkencor ose një diplomë ekuivalente, me një përvojë minimale prej 7 vitesh.

Për secilin anëtar të stafit kryesor duhet të paraqitet: Diplomë, kontratë pune, CV që pasqyrojnë përvojën e inxhinierit të propozuar. Për inxhinierët e stafit kryesor duhet të paraqitet edhe licenca individuale në projektim (e kërkuar gjithashtu në Kreun 1 të këtij dokumenti), licencë individuale në projektim.

### 3.6 Certifikimet ISO

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate ISO 14001:2015 “Per sistemin e menaxhimit mjedisore” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objektin e kontrates. paraqese Certifikate ISO 14001-2015 (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objektin e kontrates. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik të paktën një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate ISO SSH EN 9001:2015 “Sistemi I menaxhimit” (te vlefshme) ose ekuivalent ne perputhje me objektin e kontrates. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik të paktën një anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme.

- ***Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqip ose anglisht si dhe në rastin e dokumenteve të lëshuara nga autoritete publikë, t'i certifikojnë ato me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Per vetedeklaratat e paraqitura nga nga ofertuesit e huaj duhet te kryhet vertetimi i firmes para nje noteri dhe certifikimi me vulen apostile. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues.***

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.***

## Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>5</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

---

<sup>5</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

## Dokumentat standarte të tenderit

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

**Shtojca 11/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE  
NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**



## **Shtojca 12**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 14**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: "**Hartimi i Projektit të detajuar teknik (Detailed Design) të Portit të ri tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano**".

Afatet e ekzekutimit: **8 (tetë) muaj** nga data e lidhjes së kontratës sipas grafikut me poshte:

<b>Emertimi i raportit</b>	<b>Permbajtja</b>	<b>Koha e dorezimit</b>
Raporti fillestar i projektit		Java 6
Raporti i studimit topografik		Java 8
Raporti i studimit batimetrik		Java 8
Raporti i studimit gjeologjik/gjeoteknik		Java 10
Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis		Java 12
Raporti i kriterëve te projektit - Draft		Java 16-20
Projekt Zbatimi, Raporti Final - Draft		Java 24
Raporti i kriterëve te projektit - Final		Java 24
Projekt Zbatimi, Raporti Final (***)		Java 32
Projekti per miratimin e lejeve zhvillimore	I gjithë dokumentacioni dhe materiali teknik i duhur per aplikim dhe miratimin e lejes se ndertimit. (****)	

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

**1. HYRJE**

Këto specifikime teknike mbulojnë Specifikimet Funksionale dhe Parametrat e Projektit për projektin dhe ndërtimin e portit të ri në Porto Romano, sistemet e trajtimit dhe pajisjet që do të instalohen.

APD-ja synon të projektojë një hapësirë të re portuale dhe logjistike intermodale në zonën strategjike të interlandit mbrapa hapësirës portuale sipas interesave të aktorëve Rajonalë dhe kërkesave të tregut të përpunimit të mallrave.

Skicimet tregojnë planimetrinë afatgjate të portit dhe shtrirjen e Fazës 1 të zhvillimit. Planimetria e master planit do të përdoret nga projektuesi si bazë për propozimet e detajuara të projektit.

Fushëveprimi i specifikimeve teknike përfshin planimetrinë, projektin, ndërtimin, furnizimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë punimeve inxhinierike të ndërtimit, ndërtesave, shërbimeve dhe pajisjeve që duhen për portin.

**2 KERKESAT E PËRGJITHSHME TEKNIKE**

**2.1 Faza 1 Fushëveprimi**

Projekti do të përfshijë por pa u kufizuar objektivat e mëposhtme:

- a) Një terminal shumë funksional i pajisur tërësisht për të përballuar të gjithë trafikun e kontejnerëve, mallrave të përgjithshëm, mallrave të projektit si dhe trafikun e grurit dhe vajit vegjetal që përpunohen aktualisht në Portin e Durrësit;
- b) Një terminal i mallrave rifuxho i pajisur tërësisht për të përballuar të gjitha ngarkesat e papastra, përfshirë qymyrin, mineralet, plehrat kimikë, materialet prej metali për skrap dhe çimento, që aktualisht përpunohen me shumicë në Portin e Durrësit;
- c) Ambientet për përdorimin e organizatave përgjegjëse për rregullimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të portit, duke përfshirë autoritetin portual, kapitenerinë e portit, doganat, autoritetet shëndetësore dhe shërbimet e zjarrfikjes, ambulancës dhe sigurisë;
- d) Një port krejtësisht i ri, që përfshin dallgëpřitës, kanale të pastruara dhe basene dhe tokë të bonifikuar, për të siguruar hyrje të sigurt për mjetet e lundrimit tranzit dhe në vendakostim si dhe për operacionet e terminalit.

## 2.2 Kërkesat e Përgjithshme - Detyrat Primare të Projektimit

Përgjegjësitë janë si më poshtë vijon:

Konsulenti i Projektit (gjithashtu i referuar në të gjithë dokumentin si projektuesi) duhet:

- Të planifikojë/ kryej të gjitha vëzhgimet, analizat dhe modelimet në terren që mund të kërkohen për planifikimin, projektin dhe ndërtimin e detajuar të mjedisve portuale.
- Të projektojë dhe detajojë planimetrinë e portit dhe terminalit, të përcaktojë shtrirjen e kërkuar të të gjitha punimeve, masat e shtimit të sipërfaqes së tokës (nëse ka), të gjitha strukturat e reja dhe themelet e tyre, dispozitat e aksesit rrugor dhe hekurudhor, shërbimet komunale dhe lidhjet e tyre të jashtme, dispozitat e sigurisë duke përfshirë rrethimin , ndërlidhjet me zonat ngjitur dhe të gjitha mjetet e tjera të kërkuara për një port dhe terminale detare tërësisht funksionale.
- Të rregullojë / të kryejë modelimin numerik dhe fizik të kërkuar për projektin dhe VNM-në.
- Të projektojë punimet në mënyrë të detajuar, të cilat duhen të jenë në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike të paraqitura këtu dhe kërkesat e standardeve dhe kodeve të praktikës të referuara në këtë dokument si dhe bazuar në legjislacionin kombëtar për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit Nr.107/2014 dhe VKM 408 " Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit ".
- Planifikimin, zhvillimin dhe propozimin teknik, ligjor dhe financiar mbi zhvillimin e zonës dhe të shesheve mbrapa Portit (Zona e Interesit sip-300 ha) sikurse lidhjen e tyre me akset rrugore dhe hekurudhore ndërmjet infrastrukturave ekzistuese dhe atyre në projektim të portit.
- Projektimin dhe detajimin e infrastrukturës rrugore, hekurudhore, elektrike, hidrike, mbrojtjes nga zjarri, drenazhimin dhe rrjetin e sigurisë IT dhe infrastrukturen e shërbimeve IT.
- Projektin për auditimin energjistik bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.5 datë 21.01.2021 "Për formatin e auditimit Energjistik dhe pagesën e audituesit."

- Rrethimi Perimetral te respektohet sipas normave nderkombetare ISPS.
- Bazuar në infrastrukturën e propozuar dhe infrastrukturën ekzistuese të bëhet një studim dhe planifikim për një terminal logjistik tranzitor në afërsi ose në Qytetin e Tiranës.
- Studimin, planifikimin dhe projektim e infrastruktures te destinuat per akostimin e mjeteve detare dhe sheshet ne sherbim per Forcat e armatosura sipas parashikimit te MASTERPLANIT.
- Propozim projektim të të gjithë hapësirës portuale të re dhe të gjithë komponentëve infrastrukturës detare dhe tokësore të detajuara me detaje teknike.
- Studim për akostimin, perpunimin dhe operimin e anijeve të tipit POST-PANAMAX me kuote zhytje maksimale -15.00 m.

Kontraktorët e punimeve marrin përsipër:

- Ndërtimin e punimeve të Fazës 1, i cili do të mbikëqyret nga një Inxhinier i caktuar nga Autoriteti Portual.
- Ndërtimin e çdo pune zgjerimi pas Fazës 1, i cili do të mbikëqyret nga një Inxhinier i caktuar nga Autoriteti Portual.

Zona do t'i dorëzohet kontraktorit të Fazës 1 pa ndërtesat ekzistuese dhe asetet e tjera të pronës.

Porti dhe терминаlet e rinj do të projektohen për të funksionuar në të gjitha kushtet atmosferike, 365 ditë në vit, 24 orë nëditë.

Projektuesi do të tregojë që, për të gjitha kategoritë e mallrave, projektet e tij për Fazën 1 do të mundësojnë dorëzimin e sigurt dhe efikas të volumeve të trafikut jo më të ulët se parashikimi i rastit më të lartë të përcaktuar nga projektuesi dhe miratuar nga APD-ja.

Të gjitha projektet do të përgatiten duke marrë parasysh zgjerimin ose azhurnimet pasuese, të mundshme ose të planifikuara, siç identifikohen në Projektin e Referencës, në mënyrë të tillë që punimet pasuese të mund të ndërtohen me ndërprerje minimale të punëve të mëparshme dhe të operacioneve të portit. Në zgjerimet pasuese, porti do të projektohet për të akomoduar një nivel të përshtatshëm zgjerimi, siç do të bihet dakord me APD-në, referuar si “Zhvillimi Përfundimtar”.

Kriteret për projektin dhe ndërtimin e të gjitha punimeve dhe ambienteve që nuk përfshihen në kontratën e punës në Fazën 1 duhet të jenë të paktën të njëjta me ato të specifikuara për Fazën 1, por do të bazohen në standardet, kodet e praktikës, udhëzimet, teknologjinë dhe normat operationale dhe do të jenë në përputhje me rregulloret ekzistuese në atë kohë.

### **3 PROJEKTIMI**

#### **3.1 Hyrje**

Projekti i Referencës përfshin planet planimetrike që ilustrojnë kërkesat konceptuale të portit të propozuar.

- Projekti i Referencës i treguar në Master Plan dhe specifikimet teknike i ofrojnë udhëzime projektuesit mbi kërkesat minimale për projektin. Propozimet e paraqitura nga projektuesi do të jenë të njëjta ose më të mira se Projekti i Referencës.
- Projektuesi mund të propozojë ambiente më të mëdha sesa ato që tregohen në Projektin e Referencës, në pajtueshmëri me normat përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me distancat e sigurisë nga instalimet ekzistuese.
- Projektuesit i kërkohet të propozojë masa që do të maksimizojnë efikasitetin dhe do të shmangin ose minimizojnë ndikimet mjedisore gjatë gjithë periudhës së operimit që shkaktohen nga ndërtimi dhe operacionet e portit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, aspektet e mëposhtme:
  - Projektin e infrastrukturës dhe metodologjinë e metodave të ndërtimit;
  - Sistemet e përpunimit përmes terminalit;
  - Përdorimin e pajisjeve për përpunimin e ngarkesave dhe ambienteve të magazinimit;
  - Metodot e përpunimit, transportimit dhe magazinimit të ngarkesave;
  - Llojet dhe sasinë e pajisjeve, mjeteve, mekanizmave të përpunimit (llojet e vincave, piruneve, lefterakeve, reachstacker, sillosave, kokave terheqese, kamionave etj) dhe automjeteve që do të zgjidhen;
  - Metodot për të zvogëluar emetimet nga mjetet lundruese;
  - Format e energjisë që përdoren në të gjithë portin;
  - Programet e mirëmbajtjes, rinovimit dhe azhurnimit të pajisjeve, automjeteve dhe infrastrukturës;
  - Planifikimin dhe transportin e mallrave dhe materialeve nga porti dhe në port;
  - Transportin e personelit për në, nga dhe brenda portit.
- Porti dhe терминаlet duhet të projektohen dhe të funksionojnë në përputhje me kërkesat e SNAP-i.
- Porti do të funksionojë mbi bazën që shërbimet e rimorkimit, pilotimit dhe furnizimi me karburant do të sigurohen nga kontraktorë të veçantë privatë.
- Терминалет e ngarkesave dhe porti në tërësi duhet të projektohen dhe të funksionojnë në përputhje me rregulloret ndërkombëtare dhe kombëtare të mjedisit. Autoritetit Portual dhe operatorët terminalë do t'u kërkohet të përgatisin plane të menaxhimit mjedisor për ambientet dhe operacionet e tyre në të ardhmen sipas zhvillimeve, të cilat pas miratimit do të zbatohen për të gjitha aktivitetet e TSHF-së.

### 3.2 Projektimet në Përgjithësi

Të gjitha projektet duhet të përgatiten duke marrë parasysh zgjerimin ose azhurnimet pasuese të mundshme ose të planifikuara, siç identifikohen në Projektin e Referencës, në mënyrë të tillë që punimet pasuese të ndërtohen me ndërprerje minimale të punëve të mëparshme dhe operacioneve të portit.

### 3.3 Kodet dhe Standardet

Projektimet duhet të kryhen në përputhje me një set të dakorduar të sistemit përkatës dhe të përputhshëm në mënyrë reciprokeme Kodet dhe Standardet Shqiptare dhe Ndërkombëtare dhe, kur nuk përcaktohet ndonjë referencë specifike në të, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Dokumente standarde të pranueshme për referencë, përfshijnë sa më poshtë vijon:

Botuesi	Data	Titulli
PIANC		Publikime të shumta me udhëzime dhe rekomandime për planifikimin dhe projektimin e infrastrukturës detare.
PIANC	2002	Udhëzime Sizmike për Strukturat Portuale.
CIRIA	2007	Manuali i Gurëve - përdorimi i gurëve në inxhinierinë hidraulike (C683, botimi i 2-të)
Korpusi i Inxhinierëve të Ushtrisë Amerikane	2002	Manuali i Inxhinierisë Bregdetare
Ëiley	2015	Rekomandimet e Komisionit për Strukturat Bregdetare EAU 2012 – botimi në anglisht
Thomas Telford	2016	Specifikimi ICE për Muret me Pilota dhe Muret Pritëse të Ngulura (botimi i 3-të)
Interpave	2007	Trotuare për Makineri të Tonazhit të Rëndë - projekti strukturor i trotuareve për makineri të tonazhit tërëndë për portet dhe industrinë e tjera (botimi i 4-të)

### 3.4 Karakteristikat e Materialeve të Tokës dhe të Mbushjes

Karakteristikat e tokës të përdorura për projektin do të bazohen në materialet marra nga vëzhgimet në terren në Zonë. Karakteristikat e materialeve mbushëse të importuara në Zonë do të përcaktohen në bazë të provave laboratorike.

### 3.5 Kushtet dhe Ngarkesat Mjedisore



Kushtet dhe ngarkesat mjedisore të zbatueshme për operacionet dhe projektin do të bazohen në të dhënat që do të merren nga vëzhgimet në terren dhe gjatë projektit të detajuar. Çdo e dhënë mjedisoree përfshirë në këtë dokument duhet të verifikohet nga projektuesi para se të përdoret.

### **3.6 Njësitë dhe të Dhënat**

Projektet, llogaritjet dhe skicimet duhet të jenë në njësitë SI.

Të gjitha nivelet në këtë dokument i referohen Grafikuttë të Dhënave (GDH), i cili përafrohet me nivelin e Baticës më të Ulët Astronomike (BUA). GDH do të përdoret në të gjitha projektet dhe skicimet. Projektuesi do të jetë përgjegjës për interpretimin dhe konvertimin e saktë të niveleve që u referohen të dhënave të tjera, siç janë ato që përdoren për vrojtimet e tokës.

### **3.7 Të dhënat e Zonës**

*Të dhënat e Vëzhgimit Mjedisor (Metocean)*

Të dhënat për kushtet e motit dhe e detit gjenden në Shtojcën bashkangjitur këtij materiali, kryesisht u referohen matjeve të regjistruara në Durrës. Ato përfshijnë të dhëna për motin të tilla si: erërat, reshjet e shiut, temperaturat e ajrit dhe lagështinësi dhe të dhëna detare si: nivelet e ujit, baticat, rrymat dhe valët.

Nivelet e baticës në Durrës janë si më poshtë, referuar Grafikut të të Dhënave (GDH) [për tu konfirmuar nga APD-ja]:

MHËS +0.3m

MHËN+0.2m

MLËN +0.1m

MLËS +0.0m

Sipas Master Planit të Portit të Durrësit (Royal Haskoning, 2008), nivelet ekstreme të ujit të regjistruara në Gjirin e Durrësit ishin + 0.92m dhe -0.48m, dhe vlerat e nivelit të kthimit për 100vjet u vlerësuan në + 1.07m dhe -0.48m.

Vetëm për qëllime paraprake të projektit, informacione të mëtejshme paraqiten në Mastër Planin e Portit të Durrësit dhe tezën e Masterit Shkencor të Master Planit të Gjirit të Porto Romanos (MK Kersten, TU Delft, 2010).

Rritja e nivelit të detit përgjatë bregdetit shqiptar është parashikuar me 0.24 m deri në vitin 2050 dhe 0.61 m deri në vitin 2100 (burimi: [www.climatechange.org](http://www.climatechange.org)).

*Kushtet e Tokës*

Të dhënat gjeoteknike paraqiten në Shtojcën bashkangjitur këtij materiali.

Sipas Master Planit të Portit të Durrësit, për projektin e terminalit të trageteve në Durrës, rritja maksimale horizontale tokës si pasojë e një tërmeti u përllogaritme 0.26g. Kjo shifër u bazua në një tokë të Kategorisë 3 dhe një ngjarje të shkallës VIII.

Vetëm për qëllime paraprake të projektit, informacione të mëtejshme paraqiten në tezën e Masterit Shkencor të Master Planit të Gjirit të Porto Romanos.

### **3.8 Projektimi i Strukturave në Përgjithësi**

Projektimet duhet të marrin parasysh kombinimet më ekstreme të ngarkesave të ndryshme që veprojnë mbi struktura gjatë gjithë jetëgjatësisë së tyre. Duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur ngarkesës sizmike në projekt, në përputhje me rekomandimet kombëtare dhe ndërkombëtare. Strukturat dhe elementët e betonarmesë të përdorin metodat e gjendjes kufitare. Punimet strukturore të çelikut, strukturat e gravitetit dhe muret mbajtëse do të analizohen me metodat e lejuara të presionit të punës ose të gjendjes kufitare.

Analiza e strukturave kryesore dhe qëndrueshmëria e tyre e përgjithshme do të kompletohet duke përdorur programe kompjuterike të miratuara.

### 3.9 Jetëgjatësia e Projektit

Tabela e mëposhtme përcakton jetëgjatësinë minimale të projektit të elementëve kryesorë të punimeve, të matura që nga përfundimi dhe intervalet kohore minimale gjatë mirëmbajtjes kryesore. Punimet duhet të projektohen, ndërtohen dhe mirëmbahen për të mbetur plotësisht të përdorshme të paktën gjatë jetëgjatësisë përkatëse të specifikuar të projektit, duke marrë parasysh ngarkesat ekstreme, kushtet mjedisore, ngjarjet dhe efektet e deformimit.

Artikulli	Jetëgjatësia e Projektit (vite)	Intervalet Kryesore të Mirëmbajtjes (vite)
Dallgëpritës	100	50
Bonifikimi i tokës duke përfshirë mbushjen prapa mureve të kalatës dhe përforcimin e tokës; muret e detit, shtrimi i rrugëve dhe shtresat e blinduara; mbrojtja kundër gërryerjes.	50	50
Muret e kalatave, muret mbajtëse dhe bazamente për shinat e vinçave	50	50
Strukturat me betonarme dhe strukturat prej çeliku, duke përfshirë pilotat dhe lidhjet midis elementëve; nyjet lëvizëse dhe kushinetat në struktura.	50	50
Kalune; punime çeliku dhe zinxhirë për fenderat; shkallë; shinat e vinçave, pika lidhëse të anijes dhe ganxha ankorimi; mbështetës kundërplasësi.	50	15
Fendera prej gome dhe fasada paneli të fenderave; sistemet e mbështetjes së shinave të vinçit	20	10
Mbrojtja katodike dhe sistemet e lysterjes	50	15
Trotuarët, rrugët dhe zonat e parkimit	20	20
Shinat hekurudhore	50	15
Rrethimet dhe portat	20	10
Sistemet e kullimit të ujërave sipërfaqësore; punimet e tubacioneve nëntokësore dhe kanaleve, ndarjet dhe mbulesat; hidrantët dhe valvolat; shtyllat e ndriçimit	50	15
Ndërtesat –punime murature	50	15

Ndërtesat - veshjet; instalimet dhe pajisjet	20	10
Instalimet mekanike dhe elektrike që nuk janë renditur më sipër	20	Sipas udhëzime të prodhuesit dhe në përputhje me planifikimin e mirëmbajtjes
Punime të ndryshme metalike jo-strukturore dhe artikuj të tjera që nuk janë renditur më sipër	20	10

### 3.10 Kriteret e Ngarkimit

Ngarkesat e ngarkuarave vinça dhe me pajisjet e tjera të transportit të mallrave në struktura dhe trotuare duhet të jenë në përputhje me të dhënat e prodhuesve. Për vinçat e montuar në shina, ngarkesat horizontale pingule ose paralele me shinën do të supozohet se janë 10% tëngarkesave vertikale.

Ngarkesat e mbivendosura në platformën e kalatës së TSHF-së dhe në zonën e pasme të vinçit do të jenë siç paraqiten më poshtë.

Përshkrimi	Ngarkesa
Vinça portualë të lëvizshëm	Ngarkesat e ngarkuara përmes krahëve të mjeteve ngritëse gjatë operacioneve të përpunimit. Ngarkesat e ngarkuara përmes gomave gjatë tranzitit ose gjatë qëndrimit
Kontejnerët	Ngarkesat e shpërndara nga kontejnerët dhe në skaje të depozituara deri në 3m lartësi.
Automjetet	Traktorë-rimorkio terminale që mbajnë kontejnerë 2 x 6 m me një peshë të kombinuar 50t. Kamion stivosës që mbajnë kontejnerë të mbushur.
Mbulesat e kapaxhës së mjeteve lundruese	Mbulesa 40t të depozituara deri në 5 m lartësi, duke qëndruar në piedestalet e qosheve, nën zonën e pasme të vinçit.

Për platformën e kalatës TMR-së dhe në të gjitha zonat e magazinimit të TSHF-së dhe TMR-së, ngarkesat e projektit do të bazohen në lartësitë dhe pajisjet maksimale funksionale të grumbullimit të propozuara nga projektuesi dhe të rënë dakord nga Autoriteti Portual.

### 3.11 Qëndrueshmëria

#### *Punime çeliku*

Të gjitha sipërfaqet e punimeve prej çeliku duhet të mbrohen nga korrozioni duke përdorur një sistem me veshje mbrojtëse të provuar. Të gjitha pilotat prej çeliku dhe punimet strukturore prej çeliku nën Nivelin Mesatar të Detit do të kenë mbrojtje katodike përveç sistemeve të veshjeve mbrojtëse të regjistruara. Shufrat lidhëse dhe lidhjet e tyre duhet të mbrohen duke përdorur fasho

mbrojtëse të regjistruardhe sistemin me stuko. Elementët dhe pilotat prej çeliku duhet të projektohen pa marrë parasysh përfitimet e ofruara nga veshja mbrojtëse ose mbrojtja katodike.

Projekti lejon humbjen e trashësisë për shkak të korrozionit. Shkalla e korrozionit në secilën zonë do të bazohet në përvojën lokale dhe jo më pak se ato të rekomanduara në BS 6349 ose EAU 2012.

#### *Betonarmeja*

Betoni duhet të projektohet për qëndrueshmëri siç rekomandohet në BS 6349, duke përfshirë mbulesën për armaturën dhe kontrollin për plasaritje.

Kur është e mundur, betoni duhet të jetë i përgatitur dhe përdorimi i kallëpit mbi ujë duhet të minimizohet.

### **3.12 Materialet dhe Punëtorja**

Materialet dhe punëtorja e përdorur duhet të jenë në përputhje me standardet e rëna dakord, kodet e praktikës, udhëzimet e projektit dhe, kur nuk përcaktohet ndonjë referencë specifike në dokument, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.

## **4 KERKESAT FUNKSIONALE & OPERATIVE**

### **4.1 Fushëveprimi i Punimeve :**

Fushëveprimi i përgjithshëm i punimeve në Fazën 1 përfshin:

- Punimet detare duke përfshirë:
  - Dallgëpritis për të formuar një port të mbrojtur;
  - Pastrimi për të formuar një kanal hyrës, zona kthyese dhe basen;
  - Bonifikimi për të siguruar tokë të re portuale dhe mbushje për të rritur nivelet ekzistuese të tokës;
  - Muret e detit për të ruajtur dhe mbrojtur tokën e portit;
  - Muret e kalatës për akostimin e anijeve me ngarkesa.
- Punime në infrastrukturë për:
  - Një terminal shumë funksional;
  - Një terminal të mallrave rifuxho;
  - Ambientet e zakonshme portuale;
  - Lidhjet me rrugët e jashtme, hekurudhën që pritet në të ardhmen dhe shërbimet komunale.

Mjetet e transportit të mallrave, automjetet dhe pajisjet e tjera do të prokurohen veçmas.

Punimet janë të vendosura brenda kufijve tokësorë dhe detarë të portit të ri të propozuar. Punimet në tokën jashtë kufirit të portit, duke përfshirë rrugët hyrëse, hekurudhat (në të ardhmen) dhe shërbimet komunale, do të merren përsipër nga marrëveshje të veçanta, por projektuesi do të jetë përgjegjës për të siguruar që projektet dhe ndërtimi i tyre të jetë i koordinuar në mënyrë që të ndërlidhet pa probleme me ato punime.

Në varësi të volumit të trafikut në të ardhmen, punimet e Fazës 1 mund të zgjerohen me marrëveshje.

## 4.2 Trafiku

	Kontejner	Mallrat Rifuxho
--	-----------	-----------------

Është planifikuar që Porti i Durrësit të jetë i mbyllur për të gjithë trafikun e mallrave, përveç mallrave të transportuara me traget: si rrjedhim porti do të merret vetëm me tragete, anijelundrimi dhe mjete lundruese për kënaqësi. Porti i ri në Porto Romano do të kërkohet të merret me të gjitha mallrat për Durrësin dhe zonat përreth tij, si dhe trafikun tranzit për / nga vendet e tjera (duke përjashtuar ngarkesat ro/ro). Petrokimikatet trajtohen dhe do të vazhdojnë të trajtohen në терминаlet ekzistuese detare të Porto Romanos, të cilat do të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga porti i ri.

Parashikimet e trafikut të përgatitura nga Autoriteti Portual do të jepen gjatë projektimit me OR fitues, të cilat duhet të rishikohen dhe azhurnohen nga projektuesi. Parashikimet e azhurnuara të trafikut për [2053], pasi të bien dakord me APD-në, do të përdoren për kapacitetin e projektit të Fazës 1. Për zhvillim afatgjatë, porti do të projektohet për të akomoduar një nivel të përshtatshëm zgjerimi, siç do të bihet dakord me APD-në, referuar si “Zhvillimi Përfundimtar”.

### 4.3 Punime Detare

#### 4.3.1 Planimetria e Portit

Planimetria e portit do të projektohet për të lehtësuar operacionet e sigurta detare dhe për të shmangur baltoşjen në zonat e pastruara si dhe për të përmbushur kërkesat e mëposhtme:

- Planimetria e dallgëpritsve për të minimizuar depërtimin e valës në port dhe kthimin e valës në drejtim të kanalit dhe drejt terminalit ekzistues detar, për të gjitha drejtimet e valës, dhe për të kufizuar shqetësimet e shkaktuara nga valët në vendakostimet në mënyrë që të shmanget ulja e efikasitetit të operacioneve të transportit të mallrave.
- Planimetria për të shmangur rritjen e rrymave të baticës pranë hyrjes së portit.
- Hapësirë e mjaftueshme për të mundësuar ndalimin e anijeve që mbërrijnë, pa rrezikuar anijet e vendosura në vendakostimet aty pranë.
- Manovrim i drejtpërdrejtë midis zonës së kthesës dhe vendakostimit.
- Format e ndërtimit të strukturave skajore që minimizojnë kthimin e valës.
- Planimetria e basenit që shmang rezonancën e valës.
- Shmang konfliktin me instalimet ekzistuese të portit dhe operacionet detare.
- Shmang ose zbut ndikimet negative në vijën bregdetare.

Pritet që porti të funksionojë me përdorimin e rimorkimit.

Efektshmëria dhe ndikimet e planimetrisë së portit do të verifikohen dhe përmirësohen me modelimin numerik duke përdorur softuer të njohur nga industria. Testimi i modelit fizik hidraulik në një laborator me reputacion duhet të përdoret për të testuar planimetrinë përfundimtare.

#### 4.3.2 Mjetet lundruese të Projektit

Porti do të projektohet për të akomoduar mjetet e mëposhtme lundruese:

## Dokumentat standarte të tenderit

	<b>Zhvillimi Fillestar</b>	<b>Faza 1</b>	<b>Zhvillimi Fillestar</b>	<b>Faza 1</b>
Kapaciteti	3,500 TEU	8,000 TEU	30,000 dët	60,000 dët
LOA	255m	340m	190m	*230m
rrezja	32.2m	43m	28m	*35m
Draft me ngarkesë të plotë	12.2m	14.5m	11.3m	*14m
Draft maksimal nëport	11m	13m	11m	13m

- mbulesa e dimensioneve maksimale (mund të mos bashkekzistojnë të gjitha)

Ndërkohë që projektet e detajuara duhet të sigurohen për Fazën 1, në fazat fillestare të zhvillimit, anijet me përmasa më të vogla mund të lejojnë që pastrimi të kryhet brenda Fazës 1, siç kërkohet, për të zvogëluar kostot e kapitalit paraprak. Fazat e pastrimit duhet të përcaktohen më miratimin e APD-së gjatë fazës paraprake të projektit.

Vendastokimet e Fazës 1 gjithashtu duhet të projektohen për të akomoduar anije të vogla si më poshtë:

- Terminal shumë funksional: 80m LOA / 2,000 DËT.
- Terminal për mallrat rifuxho: 115m LOA / 6,500 DËT.

### 4.3.3 Zonat e Navigimit

Pozicionimi i kanalit të hyrjes do të zgjidhet për të maksimizuar menaxhimin e anijes dhe për të minimizuar volumin e pastrimit. Duhet të pastrohet në drejtim të detit të paktën deri në thellësinë ekzistuese të shtratit të detit që përputhet me nivelin e pastruar sipas specifikimeve dhe gjithashtu do të hiqet çdo pjesëmë e lartë me materiale në shtratine detit më në thellësi në pozicionimin e kanalit.

Kanali i navigimit, zona e kthimit dhe zonat e basenit / vendakostimit duhet të plotësojnë kërkesat e Raportit PIANC # 121, 2014, ose të ndonjë standardi tjetër të pranueshëm. Funkcionimi i kanalit në një drejtim është i pranueshëm.

Minimalisht duhet të sigurohen dimensionet e mëposhtme, por do të verifikohen me studim dhe modelim të detajuar:

- Thellësitë:
  - Kanali dhe zona e kthimit: 1.15 x drafti i anijes;
  - Baseni: 1,1 x drafti i anijes.

- Gjerësitë:
  - Kanali: fillimisht 180m dhe 240m në Zhvillimin Përfundimtar;
  - Zona e kthimit: fillimisht diametër me450m dhe 600m në përfundim (plus hapësira për vendakostimet ngjitur);
  - Baseni: 230m me vendakostimet përgjatë njëres anë dhe 270m me vendakostimet përgjatë të dy anëve (matur nga vijat e fenderit).

Planimetria dhe dimensionet e kanalit, zonës së kthimit dhe basenit në secilën fazë do të vlerësohen dhe optimizohen duke përdorur simulimin e navigimit / manovrimit me kohë të shpejtë bazuar në softuerin e njohur nga industria. Nëse rezultatet nuk janë bindëse, mund të kërkohet edhe simulim në kohë reale.

#### **4.4 Terminali Shumë Funkcional (TSHF)**

##### **4.4.1 Kërkesat e Përgjithshme**

Terminali Shumë Funkcional (TSHF) do të projektohet si një strukturë kryesore për të përpunuar kontejnerët, mallrat e përgjithshëm me shumicë, ngarkesat e projektit, drithërat dhe vajrave vegjetalë rifuxho. Ky Terminal duhet të projektohet për përpunim dhe magazinim efikastë të gjitha ngarkesave në breg në përputhje me kapacitetin mbajtës së vendakostimeve.

Është parashikuar që operacionet e kontejnerëve do të ndahen nga operacionet e mallrave të përgjithshëm, të drithërave dhe vajit vegjetal, me ambiente të veçanta për magazinim dhe porta për kamion për secilën prej tyre.

Pershkrim introduktiv i funksionimit teknologjik të terminalit:

Do të përdoret një sistem operativ modern në terminal që mundëson integrimin e të gjitha operacioneve të përpunimit, të gjithëkontejnerëve dhe ngarkesave të mallrave të përgjithshëm të gjurmohen teksavazhdojnë procesin në terminal, të gjitha lëvizjet e kontejnerëve të planifikohen, përfshirë ato nëbordin e anijes dhe në portën kryesore dhe numri i lëvizjeve joproduktive të kontejnerëve të minimizohet. Sistemet TOS dhe IT do të lidhen me çdo ambientku do të operojë Operatori në zonën e logjistikës tëPorto Romanos ose në Durrës.

Projekti i Referencës bazohet në sistemet e mëposhtme të përpunimit: projektuesi mund të propozojë sisteme alternative të provuara që ofrojnë rezultate të njëjta ose më të mira:

- Kontejnerë: bazuar në vinça porti të lëvizshëm (VPL) ose vinça–urë nga anija në breg (STS) dhe vinça-urë të kantierit të mbështetur nga automjete të lëvizjes së brendshme për të transportuar kontejnerë nga kalatanë pikën e depozitimit. Sistemi i përpunimit do të jetë i aftë të funksionojë me shpejtësi të lartë dhe pika depozituese të konsiderueshme, që përputhen me produktivitetin e vinçit të kalatës dhe zonën e sipërfaqes sëtokës.

- Mallrat e përgjithshëm: duke u bazuar tekvinça porti të lëvizshëm të mbështetur nga pirunjtë ose automjete të lëvizjes së brendshme për të transportuar ngarkesa midis kalatës dhe kantierit.
- Drithërat rifuxho: bazuar në shkarkimin pneumatik të anijeve, me tubacion (e) nëntokësore për të lëvizur materialin nga kalatanësilos.
- Vajra vegjetalë rifuxho: bazuar në shkarkimin e anijeve duke përdorur pompat e anijes për të lëvizur lëngjetnga kalatanëdepozita përmes tubacionit (eve) nëntokësore.
- Të gjithë vinçat dhe sistemet e përpunimit të mallrave rifuxhofunksionojnë me energji elektrike dhe pajisjet e lëvizshme dhe automjetet e lëvizjes së brendshme me energji të ulët / emetim të ulët ose motorë me naftë hibride.
- Të gjitha lëvizjet në tokë të ngarkesave bëhen me anë tërrugëve, por mund të merren masa për përdorimin e mundshëm të shinave për të kryer një pjesë të rendimentit.

#### 4.4.2 Baza e Planifikimit të TSHF-së

Projekti i Referencës së TSHF-së bazohet në supozimet kryesore si më poshtë:

- Hyrja e plotë e anijes + koha e daljes 2.5 orë për kontejnerë / mallra të përgjithshëm, 4 orë për drithërat.
- Operacione në 350 ditë në vit, 21 orë në ditë.
- Nivelet e shërbimit të anijeve të jenë në përputhje me praktikat më të mira moderne.
- Numrat e pajisjeve bazuar në lëvizjet produktive në vit: VLP 66,150, ERTG 40,000, ECH / RS 20,000; 3 traktorë-rimorkio për ERTG + 10% rezervë.
- Koha e qëndrimit të kontejnerëve për vitin 2008 sipas Master Planit tëPortit tëDurrësit: import i plotë 7 ditë, eksport i plotë 5 ditë, bosh 14 ditë. (Këto janë të dhëna të zakonshme krahasuar me të dhënat e APD-së për vitin 2020 për importin e plotë 5 ditë, eksportin e plotë 4 ditë)
- Depozitimi bazuar në kontejnerë të mbushur nga 1 mbi 5 ERTGs @ mesatarisht 3 kontejnerë të lartë dhe bosh nga ECH @ mesatarisht 5 të lartë. (Kapaciteti shtesë mund të arrihet duke përdorur 1 mbi 6 ERTG.)
- Mallrat e përgjithshëm: paletë mesatare 1,500t, shkalla e shkarkimit të vinçit neto 75 t / orë.
- Mesataret e mallrave të përgjithshme: koha e qëndrimit 10 ditë, dendësia 0,6 t / m<sup>3</sup>, përgjet e grumbullimit 2m të lartë, kapaciteti zënës 70%.



- Drithëra rifuxho: paletë mesatare 8,000 t, shpejtësia neto e shkarkimit 250 t / orë.

#### 4.4.3 Ambientet e TSHF-së

Zona e operimit të TSHF-së duhet të përmbajë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

- Një gjatësi të drejtë kalate prej të paktën 750m, me një thellësi përgjatë saj me -14.0m dhe në gjendje të akomodojë anije më një sërë kapacitetesh nga më e vogla deri tek anija e fundit e projektit.
- Një platformë kalate që të jetë gjerë të paktën 40m e projektuar për funksionim me vinça porti të lëvizshëm që funksionojnë në të gjithë gjatësinë e kalatës.
- Në gjatësinë e kalatësperëndimore prej 500m: një platformë kalate e gjerë së paku 65m e projektuar për funksionim në të ardhmen me vinça-urë nga anija në breg (STS), me shina në një hapësirë merrreze 20m deri 30,48m/ 100'për të mbështetur deri në katër vinça-ura me energji elektrike.
- Në gjatësinë e kalatës lindore prej 250m: kalatë e projektuar për funksionim nga një shkarkues i drithërave rifuxho që punon me energji elektrike dhe instalimet përcjellëse shoqëruese.
- Një gjerësi totale toke prej 250m, e matur midis murit ndarës dhe kufirit të pasmë, për të përfshirë zonat e magazinimit që operohen nga vinça-urë (për kontejnerë të mbushur) dhe pajisje të lëvizshme (për kontejnerë bosh dhe mallra të përgjithshëm).
- Një zonë toke në skajin lindor të kalatës, për siloset, cisternat, portat e kamionëve dhe zonat e pritjes, urat peshore, skanerat, ndërtesat, mirëmbajtja dhe pajisjet e tjera ndihmëse; një pjesë nga zona e Fazës 1 mund të vihen gjithashtu në dispozicion për zgjerimin e sheshit (eve) të depozitimit pas ndërtimit fillestar.
- Shërbime komunale duke përfshirë shpërndarjen elektrike, telekomunikacionet / lidhjen në rrjet të të dhënave, kontejnerë frigoriferikë, ndriçim me shtylla të larta, furnizimin me ujë, sisteme të furnizimit me ujë deti në rast zjarri dhe kanalizime.

Në Fazën 1 thellësia minimale mund të ulet fillimisht në -12.0m.

TSHF-ja do të projektohet për të mundësuar zgjerimin në të ardhmen në zonën perëndimore për të përmbushur volumet e rritura të kontejnerëve ose mallrave të përgjithshëm. Prandaj sheshi i kontejnerëve në Fazën 1 do të projektohet për zgjerim të zonës së depozitimit të mallrave të përgjithshëm në të ardhmen.

Afati kohori çdo pune zgjerimi vlerësohet nga projektuesi.

Sistemet e përpunimit dhe magazinimit të grurit duhet të projektohen duke marrë parasysh masat që do të miratohen për menaxhimin dhe zbutjen e rreziqeve, duke përfshirë shëndetin, zjarrin, ndotjen dhe shpërthimin.

Projektuesi mund të propozojë planimetri të ndryshme dhe marrëveshje për përpunimin për TSHF-në, me kusht që të mund të demonstrojë me llogaritje dhe/ ose simulim të verifikueshëm lehtësisht se propozimet do të rezultojnë në një terminal, ku efikasiteti i të cilit si dhe rendimenti, kapacitetet e magazinimit dhe ruajtjes janë të paktën të njëjta me ato të Projektit të Referencës.

#### **4.4.4 Fushëveprimi i Punimeve të TSHF-së**

TSHF-ja kërkon projektimin e të gjitha punimeve që lidhen me zhvillimin e terminalit, duke përfshirë, pa kufizim, sa më poshtë vijon:

- Të paktën 750m kalatë me një minimum thellësie ujipërgjatë saj sipas projektit prej -14.0m (fillimisht -12.0m), duke përfshirë:
  - platformë kundër gërryerjes përpara murit (nëse kërkohet).
  - të gjitha pajisjet e kalatave siç janë fenderat, kalunat, pengesat e sigurisë së automjeteve, shkallët dhe zinxhirët e sigurisë.
  - Kabllot e energjisë që të furnizojnë deri në tetë vinça porti të lëvizshëm.
  - Të sigurojë mundësinë për instalime për vinça-urënë të ardhmen të tilla si binarët, mbështetësit kundraplasës, pika lidhëse të anijes, spirancat për stuhi, ushqyesit e kabllove elektrike.
  - Të sigurojë mundësinë për instalime në të ardhmen për energjinë nga bregu në anije deri në tre anije.
  
- Punimet në infrastrukturë duke përfshirë:
  - Zonat e magazinimit duke përfshirë masat për ruajtjen e kontejnerëve të paktën në pjesën më perëndimore prej 500 m të zonës së kalatave dhe magazinimin e mallrave të përgjithshëm në pjesën e mbetur.
  - Platformat frigoriferike.
  - Një zonë për kontejnerët e cisternave që rrjedhin.
  - Sigurohet mundësia për magazinimin e mbuluar të mallrave të përgjithshëm dhe për magazinimin e ftohtë (nëse kërkohet: mund të shtohet më vonë nga operatori –duke rënë dakord me APD-në).

- Siloset për magazinimin e grurit rifuxho, me tubacione mes siloseve dhe vendakostimit lindor dhe ambiente magazinimi për ngarkimin e kamionëve (mund të shtohen më vonë nga operatori – duke rënë dakord me APD-në).
- Cisternat për ruajtjen e vajrave vegjetalë, me tubacione mes cisternave dhe vendakostimit lindor dhe ambienteve të ngarkimit të kamionëve (mund të shtohen më vonë nga operatori - duke rënë dakord me APD-në).
- Trotuaret për platformën e kalatës, vendet e magazinimit, rrugët, vendet e pritjes së kamionëve dhe vendet e parkimit për pajisjet e lëvizshme, automjetet dhe për makinat e tjera.
- Pengesat e sigurisë, sinjalistikat dhe shënjesit sipërfaqësor.
- Shinat hekurudhore.
- Ndërtesat për zyrat e terminalit, ofiçinat/ dyqanet, komoditetet dhe shërbimet.
- Shërbimet komunale dhe pikë karburanti.
- Rrethim sigurie.
- Sistemet e zbulimit dhe alarmit të zjarrit.
- Infrastruktura për TOS, IT dhe sistemet e sigurisë që do të instalohen më vonë nga operatori.

#### **4.5 Terminali i Mallrave Rifuxho (TMR)**

##### **4.5.1 Kërkesat e Përgjithshme**

Terminali i Mallrave Rifuxho (TMR) do të projektohet, pajisjet dhe funksionojësi një strukturë drejtuese për të trajtuar ngarkesat e mallrave rifuxho, duke përfshirë qymyrin, mineralet, plehrat, materialet prej hekuri për skrap dhe çimenton. Ai do të jetë i projektuar për përpunimin dhe magazinimin efikas të të gjitha ngarkesave në breg, në përputhje me kapacitetin e rendimentit të vendakostimeve.

Do të përdoret një sistem operativ terminal modern që mundëson që të gjitha operacionet e përpunimit të integrohen dhe materialet të gjurmohen ndërsa vazhdojnë procesin përmes terminalit. Projekti i Referencës bazohet në sistemet e mëposhtme të përpunimit: projektuesi mund të propozojë sisteme alternative të provuara që ofrojnë rezultate të njëjta ose më të mira:

- Çimento: bazuar në ngarkimin dhe shkarkimin pneumatik të anijeve, me tubacion (e) nëntokësore për të lëvizur materialin midis kalatës dhe siloseve dhe midis siloseve dhe kamionëve ose vagonëve hekurudhorë.
- Materiale të tjera: bazuar në shkarkuesit me rregullim presioniose vinçat e lëvizshëm të portit që shkarkohen përmes hinkave shkarkuese tek transportuesit ose kamionët e mallrave për të lëvizur materialet mes kalatës dhe pikës së depozitimit dhe ngarkuesit e lëvizshëm për të ngarkuar materialet në kamionë ose vagonë hekurudhorë. Nëse materialet rifuxho do të eksportohen, ngarkimi do të bëhet nga sisteme të ulët shkarkimi siç janë transportuesi i mbyllur dhe kaskada Cleveland. Sistemi i përpunimit do të jetë i aftë të funksionojë me shpejtësi të lartë dhe me depozitime të me kapacitet të dendur, në përputhje me produktivitetin e vinçit të kalatës dhe zonës së tokës.

- Të gjithë vinçat dhe sistemet e përpunimit të çimentos funksionojnë me energji elektrike, me pajisje të lëvizshme dhe automjete të lëvizjes së brendshme me energji të ulët / emetime të ulëta ose motorë me naftë hibride.
- Një terminal hekurudhor për të maksimizuar përdorimin e transportit pasi të ketë përfunduar lidhja hekurudhore me portin.
- Lëvizja në tokë me anë tërrugëve për të gjitha ngarkesat që nuk transportohen me shina.

#### 4.5.2 Baza e Planifikimit të TMR-së

Projekti i Referencës i TMR-së bazohet në supozimet kryesore të mëposhtme:

- Operacione në 350 ditë në vit, 21 orë në ditë.
- Mesataret e ngarkesave të mallrave të përgjithshëm: koha e qëndrimit 10 ditë, dendësia  $0,6 \text{ t} / \text{m}^3$ , depozitimi 2m i lartë, kapacitetit zënë 70%.
- Hyrja e plotë e anijes + koha e daljes 4 orë.
- Nivelet e shërbimit të anijeve të jenë në përputhje me praktikat më të mira moderne.
- Qymyr rifuxho: paletë mesatare 25,000t, normaneto e shkarkimit të vinçit 200 t / orë x 2 vinça, depozitimi deri në 10m të larta.
- Skrap, pleh: paletëmesatare 10,000t, norma neto e shkarkimit të vinçit 200 t / orë x 2 vinça.
- Çimento rifuxho: paletë mesatare 10,000t, norma neto e shkarkimit 250 t / orë, norma neto e ngarkimit 600 t / orë.

#### 4.5.3 Ambientet e TMR-së

Zona e operimit të TMR-së duhet të përmbajë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

- Një gjatësi të drejtë kalate prej të paktën 480m, me një thellësi minimale përgjatë saj me -14.0m dhe në gjendje të akomodojë anije me një sërë kapacitetesh nga më e vogla deri tek anija e projektit përfundimtar.
- Një platformë kalate që të jetë e gjerë të paktën 40m e projektuar për funksionim me vinça porti të lëvizshëm që funksionojnë në të gjithë gjatësinë e kalatës dhe që ka kapacitet të mjaftueshëm të shtrirjes, lartësisë dhe ngarkesës për t'i shërbyer anijevetë projektit dhe hinkave lëvizëse shkarkuese.
- Në gjatësinë 250 m të kalatës në skajin më lindor: kalatë e projektuar për funksionim nga një ngarkues / shkarkues çimentoje rifuxho me energji elektrike dhe instalimet përcjellëse shoqëruese.

- Një gjerësi totale toke prej 250m, e matur midis murit ndarës dhe kufirit të pasmë, për të përfshirë zonat e magazinimit dhe terminalin e ardhshëm hekurudhor.
- Një zonë toke në skajin lindor të kalatës, për siloset, portat e kamionëve dhe zonat e pritjes, urat peshore, ndërtesat, mirëmbajtjen dhe objektet e tjera ndihmëse; disa nga zonat e Fazës 1 mund të vihen gjithashtu në dispozicion për zgjatimin e sheshit të magazinimit pas ndërtimit fillestar.
- Shërbime komunale duke përfshirë shpërndarjen elektrike, telekomunikacionet / lidhjen në rrjet të të dhënave, kontejnerë frigoriferikë, ndriçim me shtylla të larta, furnizimin me ujë, sisteme të furnizimit me ujë deti në rast zjarri dhe kanalizime.

Në Fazën 1 thellësia minimale mund të ulet fillimisht në -12.0m.

TMR-ja do të projektohet për të mundësuar zgjerimin në të ardhmen në zonën perëndimore për të përmbushur volumet e rritura të trafikut.

Afati kohori çdo pune zgjerimi vlerësohet nga projektuesi.

TMR-ja do të projektohet duke marrë parasysh:

- Masat për menaxhimin dhe zbutjen e rreziqeve, përfshirë shëndetin, zjarrin, ndotjen dhe shpërthimin, që do të miratohen për secilin lloj të materialit që do të procesohet.
- Metodat e pastrimit dhe mbledhjes së derdhjeve që do të përdoren në secilën pjesë të terminalit.

Projektuesi mund të propozojë planimetri të ndryshme dhe marrëveshje për përpunimin, me kusht që ata të mund të demonstronë me llogaritje dhe/ ose simulim të verifikueshëm lehtësisht se propozimet do të rezultojnë në një terminal, ku efikasiteti i të cilit si dhe rendimenti, kapacitetet e magazinimit dhe ruajtjes janë të paktën të njëjta me ato të Projektit të Referencës.

#### **4.4.4 Fushëveprimi i Punimeve të TMR-së**

TMR-ja kërkon projektimin e të gjitha punimeve që lidhen me zhvillimin e terminalit, duke përfshirë, pa kufizim, sa më poshtë vijon:

- Të paktën 750m kalatë me një minimum thellësie ujipërgjatë saj sipas projektit prej -14.0m (fillimisht -12.0m), duke përfshirë:
  - Platformë kundër gërryerjes përpara murit (nëse kërkohet).
  - Të gjitha pajisjet e kalatave siç janë fenderat, kalunat, pengesat e sigurisë së automjeteve, shkallët dhe zinxhirët e sigurisë.
  - Kabllot e energjisë që të furnizojnë deri në katër vinça porti të lëvizshëm.
  - Të sigurojë mundësinë për instalime për energjinë në të ardhmen nga bregu në anije deri nëdy anije. *(mund të mos jetë i nevojshëm duke pasur parasysh konsumin e ulët të energjisë të transportuesve të mallrave rifuxho në port?).*

- Punimet në infrastrukturë duke përfshirë:
  - Zonat e magazinimit të zhavorrit.

- Silose për magazinimin e çimentos rifuxho, me tubacione mes siloseve dhe vendakostimit lindor dhe ambienteve të ngarkimit dhe shkarkimit me shina. (mund të shtohen më vonë nga operatori – duke rënë dakord me APD-në).
- Instalime për të minimizuar nxjerrjen e pluhurit siç janë magazinimi dhe transportuesit të mbuluar, sistemi i mbledhjes së sedimenteve, sistemi i nxjerrjes së pluhurit, rrethime kundra erës (mund të shtohen më vonë nga operatori – duke rënë dakord me APD-në).
- Trotuaret për platformën e kalatës, rrugët, vendet e pritjes së kamionëve dhe vendet e parkimit për pajisjet e lëvizshme, automjetet dhe për makinat e tjera.
- Pengesat e sigurisë, sinjalistikat dhe shënjesit sipërfaqësorë.
- Shinat hekurudhore.
- Ndërtesat për zyrat e terminalit, ofiçinat / dyqanet, komoditetet dhe shërbimet.
- Shërbimet komunale dhe pikë karburanti.
- Rrethim sigurie.
- Sistemet e zbulimit dhe alarmit të zjarrit.
- Infrastruktura për TOS, IT dhe sistemet e sigurisë që do të instalohen më vonë nga operatori.

#### **4.6 Ambientet e Përbashkëta Portuale**

Ambientete përbashkëta portuale do të projektohen dhe pajisen për organizatat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- a) Autoritetin Portual
- b) Kapitenerinë Portit
- c) Doganat
- d) Autoritetet shëndetësore
- e) Kontrollin / sigurinëkufitare
- f) Shërbimet e emergjencës
- g) Ambientet e tualeteve për stafin dhe vizitorët.

Projektimi i të gjitha punëve që lidhen me ambientet e përbashkëta portuale, duke përfshirë, pa kufizim, do të kryhet si më poshtëvijon:

- Ndërtesa që përmbajnë zyra për autoritetin portual, kapitenerinë e portit, doganat, autoritetet shëndetësore, kontrollin/ sigurinë kufitare dhe shërbimet e emergjencës.
- Ambiente të specializuara, përfshirë dhomën e kontrollit detar, klinikën e ndihmës së shpejtë.
- Të sigurohen ambiente të hapura dhe të mbyllura për inspektim për doganat dhe autoritetet shëndetësore.
- Garazhe për automjete patrullimi dhe automjete emergjence, përfshirë zjarrfikësen dhe ambulancën.
- Vendakostim për mjetet lundruese të portit, me thellësi provizore -6 metra, duke përfshirë:

- Njësia Detare 1: 4 anije tërheqëse, 6 anije të transportit të pilotëve, 2 anije shërbimi/anije për pastrimin e baseneve.
- Njësia Detare 2: 8 motoskafer deri në 13 metra të gjata (dy për kapitenerinë e portit, policinë kufitare, doganat dhe autoritetin portual).
- Vend magazinimi për pajisjet e derdhjes së karburantit.
- Ambient larjeje/tualet për vizitorët.
- Parkim makine, rrethim, rregullim peizazhi.
- Shërbime komunale për ndërtesat dhe zonat e jashtme, përfshirë ndriçimin.
- Sistemet e TI, të sigurisë, të zbulimit të zjarrit dhe alarmit: për ndarjen midis punimeve të Fazës 1 dhe përdoruesve të objektit do të bihet dakord me APD-në.

Pritet që mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve të kryhet në oficinën e M&R të TSHF-së.

#### **4.7 Ambiente të tjera**

Planimetria e portit duhet të parashikojë ambientet e mëposhtme jashtë kufirit të SNAP në ujërat e mbrojtura në mënyrë të përshtatshme.

- Marina/Rojet bregdetare: gjatësia e kalatës 120m dhe thellësia 6m, me sipërfaqe toke deri në 6,000 m<sup>2</sup>.
- Sheshi i riparimit të anijes: sipërfaqja 200m x 50m, me thellësi 8m të vendakostimit dhe ambient për të ngritur anijet deri në 500 GT nga uji

## **5 INFRASTRUKTURA E PËRGJITHSHME**

### **5.1 Dallgëpritisit**

Dallgëpritisit parashikohen si struktura me stivë gurësh me armatura me njësi shkëmbore ose betoni. Armaturat shkëmbore mund të përdoren vetëm nëse ka në dispozicion sasi të mjaftueshme të materialit me madhësinë e kërkuar dhe me cilësi të pranueshme.

Dallgëpritisit duhet të projektohen për të kufizuar tejkalimin e lartësisësë dallgës dhe transmetimin e dallgëve në zonat e lundrimit dhe në zonat tokësore ngjitur, si fillestare ashtu edhe të ardhshme, dhe për të minimizuar reflektimin e dallgëve. Ata duhet të projektohen duke përdorur të dhëna që do të merren nga vëzhgimet në terren të cilat do të ndërmerren nga projektuesi. Ata duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të kërkojnë mirëmbajtje minimale gjatë jetëgjatësisë së projektit.

Daljet e rumbullakëta duhet të projektohen për t'u siguruar që struktura të mos preket nga thellimi i ardhshëm i kanalit të hyrjes dhe zonës së kthimit.

Armaturat, shpatet dhe kreshta duhet të projektohen që të ofrojnë stabilitet në të gjitha kushtet e projektimit. Shpatet e brendshme të dallgëpritisve, në të cilat bonifikimi i ardhshëm do të kryhet së shpejti, duhet të projektohen për të lehtësuar heqjen e materialit të armaturës dhe vendosjen e shtresave të filtrit para se të vendoset materiali mbushës.

Projektimi i të gjithë elementëve të strukturave të dallgëthyesve duhet të integrohet plotësisht dhe duhet të jetë në përputhje me metodën dhe rendine ndërtimit. Themelet dhe pjerrësitëanësore duhet të projektohen të tilla që të marrin parasysh kushtet ekzistuese gjeoteknike përgjatë gjatësisë dhe

gjerësisë së strukturës, si dhe për të përmbushur faktorët e pranueshëm të sigurisë dhe shkallët e ngjeshjes, nën të gjitha kushtet e ngarkesës gjatë jetëgjatësisë së projektimit, përfshirë rastet e tërmeteve. Heqja dhe/ose përmirësimi i materialit të shtratit të dobët do të kryhet nëse është e nevojshme.

Stabiliteti dhe performanca hidraulike e projektit të pjerrësisë tërthore duhet të verifikohet duke përdorur testimin fizik të modelit hidraulik në një laborator të besueshëm.

## **5.2 Pastrimi**

Zonat e lundrimit do të pastrohen në thellësitë minimale të specifikuar për akses detar.

Materiali i gërryer i përshtatshëm për ripërdorim do të përdoret në bonifikim. Materiali i gërryer i papërshtatshëm për përdorim në bonifikim do të hidhet në një vend të licencuar në det të hapur, ose diku tjetër, ku i nënshtrohen miratimeve të nevojshme.

Metodat për operacionet e pastrimit, transportit dhe hedhjes duhet të projektohen për të minimizuar grimcat inerte pezull në përputhje me kërkesat e specifikuar për zbutjen e ndikimit në mjedis.

Materiali shtesë i bonifikimit mund të merret duke gërryer nga një vend i licencuar në det të hapur, i cili i nënshtrohen miratimeve të nevojshme.

Shpatet anësore duhet të projektohen në bazë të rezultateve të vëzhgimeve në terren dhe mund të modifikohen me marrëveshje gjatë punimeve.

Kur shtrati i detit në vendakostim përbëhet nga material i lirshëm ose i butë, zonat përpara murit të kalatës dhe muret e detit që kufizohen me basenin dhe zonën e kthimit do të mbrohen nga zhvendosja e materialit të shtratit nga helikat dhe shtytësit e mjeteve të lundrimit.

## **5.3 Sipërfaqet tokësore**

Të gjitha sipërfaqet tokësore portuale në secilën fazë do të bonifikohen ose ngrihen në lartësitë e specifikuar duke përdorur materialin mbushës të miratuar. Ato do të projektohen që të marrin parasysh kushtet ekzistuese gjeoteknike nën secilën sipërfaqe, si dhe për të përmbushur faktorët e pranueshëm të sigurisë dhe shkallët e ngjeshjes, nën të gjitha kushtet e ngarkesës gjatë jetëgjatësisë së projektimit, përfshirë rastet e tërmeteve. Përmirësimi i tokës dhe/ose heqja/zëvendësimi i materialit të shtratit të dobët do të kryhet nëse është e nevojshme.

Bazuar në një ngritje të parashikuar të detit prej 0.61m deri në vitin 2100, ngritja përfundimtare në perimetrin e sipërfaqes së Fazës 1 duhet të jetë jo më e ulët se +2.4m. Ngritja përfundimtare e sipërfaqeve të cilat nuk do të asfaltohen në Fazën 1 duhet të jenë jo më pak se +1.8m. Të gjitha strukturat, instalimet, asfaltimet, shinat, sistemet e kullimit dhe shërbimet duhet të projektohen të tilla që të parashikojnë pasojat e ngjeshjes për një periudhë mëse 50 vjeçare nga mbarimi i punimeve.

Materiali mbushës për bonifikim dhe për ngritjen e niveleve ekzistuese të tokës që nuk përftohet nga gërryerja, mund të merret nga burimet në tokë, në varësi të miratimeve të nevojshme.

Materiali i mbushjes duhet të vendoset brenda argjinaturave të mbajtjes nën kontroll për të minimizuar daljen e grimcave inerte pezull gjatë ndërtimit.

Pjesët anësore të të gjithë sipërfaqes tokësore portuale në drejtim të detit që nuk mbahen nga strukturat e tjera duhet të mbrohen kundër veprimt të dallgëve, rrymave, rrjedhjes dhe zhvendosjes së lëndës inerte nga helika me anë të shpateve që zbutin efektin e dallgëve. Shpatet duhet të formohen me shtresa mbushëse shkëmbore dhe armaturë shkëmbore, me filtër gjeotekstili për të



parandaluar rrjedhjen e materialit mbushës. Majat e shpateve gjithashtu duhet të mbrohen nga erozioni.

I gjithë materiali mbushës i vendosur mbi ujë duhet të ngjishet në shtresa duke përdorur pajisje të rënda për të kufizuar ngjeshjen me kalimin e kohës dhe për të maksimizuar kapacitetin mbajtës të ngarkesës. Përmirësimi i materialit të vendosur nën ujë dhe i materialit të shtratit të detit do të kryhet nëse kërkohet që punimet e përfunduara të jenë në përputhje me kriteret e specifikuar të ngjeshjes. Sistemi ekzistues i kullimit të tokës do të ndahet nga porti i ri. Kanalet ekzistuese të kullimit që përshkojnë zonën e re të portit do të devijohen sipas nevojës.

Të gjitha sipërfaqet e tokës portuale do të jenë të pjerrëta për të nxitur kullimin, me gradientë minimale prej 1: 100 për zonat e asfaltuara të magazinimit dhe platformën e kalatës dhe pjerrësinë anësore 1:50 për rrugët dhe sipërfaqet e pashtruara. Në përgjithësi, të gjithë ujërat sipërfaqësorë, përfshirë ata përgjatë perimetrit të sipërfaqes së tokës portuale të Fazës 1, do të drejtohen përmes kanaleve ose grykave në një rrjet të pavarur nga sistemi ekzistues i kullimit të tokës. Në zonat e depozitimit të TMR-së, duhet të shmangët përdorimi i kulluesve nëntokësorë dhe duhet të instalohet shtresa rezistente fleksibël të papërshkueshëm nga uji, nëse është e nevojshme, për të parandaluar rrjedhjen e ndotësve në ujërat nëntokësore ose në det.

Interceptorët do të kërkohet të vihen në zonat e oficinës dhe në të gjitha derdhjet në mënyrë që çdo karburant, vaj, graso ose ndotës të tjerë të derdhur, të mbahen nën kontroll dhe të mos shkarkohen drejtpërdrejt në det ose në sistemin e jashtëm të kullimit. Shpatet dhe rrjeti i kullimit duhet të projektohen për të shmangur krijimin e pellgjeve dhe për të marrë parasysh efektet e tjera të ngjeshjes pas ndërtimit.

#### **5.4 Vendakostimet dhe muret e kalatës**

Kjo pjesë i referohet mureve të kalatave dhe vendakostimeve për TSHF-në dhe TMR-në. Muret e kalatës për njësinë detare duhet të projektohen për t'iu përshtatur gamës së mjeteve lundruese që do të akomodohen.

Projektuesi do të marrë në konsideratë format alternative të ndërtimit që do të përdoren për muret e kalatës dhe do të rekomandojë opsionin e tij të preferuar, për aprovim. Projektimet do të përfshijnë të gjitha pajisjet e kalatave, të tilla si fenderat, kalunat dhe pajisjet e sigurisë, dhe shërbimet komunale duke përfshirë sigurimin e lidhjeve elektrike me vinça kalate, ujin e pijshëm për mjetet lundruese dhe sigurimin e ardhshëm të energjisë në breg për anijet.

Vendakostimet dhe muret e kalatave duhet të projektohen për të lejuar thellimin e mëvonshëm në nivelet minimale të specifikuar plus tolerancë prej të paktën 0,5 m për gërryerjen e tepërt. Projektuesi mund të propozojë thellësi më të mëdha, që duhet t'i nënshtrohen miratimit.

Vija e sipërme ndarëse dhe vija e fenderave për muret e kalatës duhet të jetë në vazhdimësi, dhe distanca minimale midis shinave të ardhshme të vinçit detar dhe vijës së sipërme ndarëse do të jetë 3m. Niveli për vijën e sipërme do të jetë + 2.4m.

Hapësira minimale midis faqes së pjesës nënujore të strukturës dhe skafit të anijes me listë 1° dhe fenderave të kompresuar plotësisht duhet të jetë 0,5 m.

Në secilën fazë zhvillimi, skajet e murit të kalatës do të kthehen në  $90^0$  në vijën e vendakostimit dhe do të zgjasin për një distancë të mjaftueshme për të mbajtur materialin mbushës deri në pikën ku ky funksion kryhet nga muri/pjerrësia e detit me mbushje shkëmbore.

Muri i kalatës duhet të përfshijë nyje dhe filtra për të minimizuar presionet diferenciale të ujit dhe për të parandaluar largimin e materialit mbushës, dhe përlllogaritjet duhet të tregojnë qartësisht presionet diferenciale maksimale të ujit të supozuara në projekt.

Projekti i kalatës duhet të marrë parasysh kërkesat minimale të mëposhtme operacionale:

- a) Në kushte normale, të paktën dy vinça që punojnë afër.
- b) Në kushte normale, katër VLP (vinça të lëvizshëm porti) ose vinça STS të cilët punojnë në anijen më të madhe të projektit.

Projekti i sistemit të fenderave duhet të bëhet optimal së bashku me konfigurimet e ankorimit të anijeve për të minimizuar lëvizjet e anijeve në vendakostim, për shkak të veprimit të valëve brenda basenit të portit. Hapësira mes fenderave nuk duhet t'i kalojë 15m. Hapësira dhe gjeometria e fenderave duhet të projektohet për t'u siguruar që gjithmonë të ruhet një hapësirë me vlerë pozitive ndërmjet anijes dhe strukturës së kalatës dhe të mos tejkalohet presioni maksimal i lejuar i skafit të anijes.

Do të sigurohen kaluna me kapacitet minimal prej 100 tonësh për të akomoduar anijet më të mëdha përgjatë gjatësisë së kalatës. Hapësira mes kalunave duhet të projektohet për t'iu përshtatur gamës së mjeteve lundruese dhe nuk duhet të kalojë 24m.

Projektimi i hollësishëm i ndërfaqeve me vinça të montuar në shina do të bazohet në informacionin e siguruar nga furnizuesi i vinçit. Instalimet e mëposhtme duhet të sigurohen si minimum, dhe të projektohen për t'iu përshtatur vinçave të ofruar, bazuar në të paktën një vinç për 100 metra gjatësi të kalatës:

- a) Sistemi i shinave për makineri të rënda për të mbështetur vinçat detarë dhe tokësorë me rrota mbi gjatësinë e plotë të kalatës, duke përfshirë shinën e salduar të mbështetur në tako elastike dhe pllakën mbështetëse horizontale, të gjitha të vazhdueshme. Kokat e shinave duhet të jenë të rrafshëta me sipërfaqen e platformës dhe shinat duhet të mundësojnë rregullim anësor me të paktën +/- 10 mm duke përdorur kapëse që lejojnë lëvizjen gjatësore termike të shinës dhe heqjen e saj nëse dëmtohet.
- b) Themelet e shinave të vinçit duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë që të kufizojnë ngjeshjen pas ndërtimit dhe lëvizjen anësore në vlerat brenda kufijve të përcaktuar nga prodhuesi i vinçit të kalatës dhe i nënshtrohet një kufiri të zgjerimit prej 15 mm në të dy drejtimet.
- c) Amortizatorë në skajet e shinave.
- d) Sete të pikave lidhëse të zhytura dhe fole të ganxhave të ankorimit, të vendosura në hapësirë afërsisht të barabartë përgjatë kalatës.

- e) Një fole e vazhdueshme për kabllot e energjisë së vinçit nga ana e detit të shinës detare detit. Foletë duhet të projektohen për të akomoduar numrin maksimal të kablllove që mund të rezultojnë nga numri i pozicioneve të funksionimit të vinçit.
- f) Pikat e lidhjes së kablllove. Gropat për vinçat e montuar në shina duhet të përfshijnë pjesët për ankorimin dhe tubat e kablllove, si dhe me madhësi për aksesin e personelit.
- g) Kanalizime adekuate për të gjitha foletë dhe ullukë shkarkimi për të gjitha gropat.

Foletë e shinave dhe kablllove duhet të mbushen me material rezistent deri në kohën kur ato kërkohen për përdorim.

### **5.5 Ndhimat në Navigim NnN**

Punimet në ndihmat në navigim (NnN) përfshijnë furnizimin dhe instalimin e bove të ndriçuara të navigimit në kanalën dhe zonën e kthimit, dritat e palëvizshme në majat e dallgëthyesve dhe skajet perëndimore të mureve të kalatës, dhe kullat drejtuese të ndriçuara tokë.

Autoriteti Portual gjithashtu mund të prokurorë dhe instalojë një Sistem të Trafikut të Anijeve (STA) të plotë me pajisje të instaluar në dhomën e operacioneve detare në zyrat e Kapitenerisë së Portit.

### **5.6 Rrugët/trotuaret**

Brenda zonave kryesore të terminalit, duhet të bëhen rrugët për qarkullimin e kamionëve të jashtëm dhe pajisjeve të terminalit, si dhe zonat e parkimit për pajisjet e terminalit dhe automjetet. Sistemi rrugor do të projektohet për të maksimizuar përdorimin e lëvizjeve të trafikut në një drejtim përmes sheshit të kontejnerëve për të gjitha automjetet. Shtrirja e rrugëve dhe rreshtave duhet të sigurojë gjerësi të mjaftueshme të korsisë, hapësirë kthimi dhe vija shikimi për të mundësuar kryerjen e operacioneve në mënyrë të sigurt.

Rrugët e hyrjes jashtë kufirit të portit duhet të projektohen për të lehtësuar lëvizjet e sigurta të trafikut. Parashikohen kryqëzimet kryesore me rrethrotullime që kanë një ishull qendror me diametër minimalisht 30m.

Trotuaret duhet të projektohen për përdorimin e pritshëm gjatë jetëgjatësisë së projektit, bazuar në numrin e pritshëm të lëvizjeve të secilës klasë të automjeteve.

Shtrimi i sheshit duhet të projektohet për kërkesat minimale të mëposhtme:

a) depozitimet e tejmbushura të kontejnerëve: për të mbështetur ngarkesat nga kontejnerët, siç u tha më lart, për t'iu përshtatur konfigurimit të renditjes të propozuar nga projektuesi. Në varësi të përdorshmërisë, opsionet e pranueshme përfshijnë shtrimin që parashikon makineritë e rënda, dhe trarët horizontalë prej betoni për të ruajtur kasat metalike të cepave të kontejnerëve me zhavorr ose shtresë të hollë midis tyre.

b) Pista (përfshirë pista të kryqëzuara) për vinçat urë të sheshit: për të mbështetur ngarkesat nga vinçat e furnizuar. Në varësi të përdorshmërisë, opsionet e pranueshme përfshijnë shtrimin që parashikon makineritë e rënda dhe trarët prej betoni. Në varësi të sistemit të kthimit të vinçit urë, mund të kërkohen pllaka kthyese për të parandaluar dëmtimin e sipërfaqes në kryqëzimet e pistave kryesore dhe atyre të kryqëzuara.

c) Zona të veçanta, p.sh. терминалет hekurudhore, zonat e mirëmbajtjes (përfshirë seksionin e shërbimit, tëlarijes, stacionin e karburantit, etj.), depozitimi i kontejnerëve që përkrahin: për të mbështetur ngarkesat nga automjetet më të rënda ose pajisjet e përpunimit dhe për të qenë rezistente ndaj përdorimit të pritur dhe derdhjeve aksidentale. Pllaka betoni të përforcuara me sipërfaqe të qëndrueshme, jo të rrëshqitshme, pa pluhur dhe rezistente ndaj vajrave.

d) depozitim të kontejnerëve të zbrazët dhe zona të magazinimit të ngarkesave të mallrave të përgjithshëm: asfaltim që parashikon makineritë e rënda, i projektuar për të mbështetur shkarkimet e imponuara nga ngarkesat si dhe për automjetet më të rënda të ngarkimit ose pajisjet e përpunimit.

e) Zonat e magazinimit të ngarkesave rifuxho duhet të kenë sipërfaqe me zhavorr të ngjeshur ose material tjetër të aprovuar.

Të gjitha trotuarët duhet të projektohen që të lejojnë ngjeshjen dhe të kërkojnë mirëmbajtje minimale gjatë jetëgjatësisë së projektit: brenda këtyre kufizimeve, mund të propozohen trotuare të ngjeshur ose fleksibël.

Shtresat e trotuarit duhet të ndërtohen në një themel të përshtatshëm të përgatitur, karakteristikat e rezistencës së projektit të të cilit do të nxirren në bazë të provave laboratorike. Do të kontrollohen karakteristikat aktuale të materialit të themelit dhe, nëse është e nevojshme, projekti do të përshtatet. Në varësi të projektit të vinçave urë, mund të kërkojnë pikatë zhytura lidhjeje për stuhi. Një set pikash të tilla duhet të ofrohet për secilin depozitim.

Mbulesat dhe skarat për instalimet e kullimit dhe shërbimeve komunale në secilën zonë të punimeve duhet të projektohen të tilla për t'iu përshtatur përdorimit dhe ngarkesave të cilave do t'i nënshtrohet zona.

Sistemi i sinjalistikës dhe shenjave sipërfaqësore në të gjitha rrugët dhe zonat e tjera të shtruar duhet të projektohet për të lehtësuar rrjedhën e trafikut dhe për të promovuar sigurinë.

## **5.7 Ndërtesat**

### **5.7.1 Të përgjithshme**

Të projektohen për të përmbushur kërkesat funksionale, operacionale dhe mjedisore të përdoruesve. Për të gjitha zonat e jashtme të ndërtesave të administratës dhe rrugët shoqëruese të shërbimit dhe zonat e parkimit, duhet të sigurohet zonë peizazhi.

Të gjitha ndërtesat duhet të projektohen në mënyrë integrale me sistemet e tyre të ngrohjes, ftohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit dhe të jepet siguri që kushtet e ambientit do të jenë të përshtatshme për personat që do të punojnë në to dhe pajisjet e tyre. Ndërtesat dhe instalimet e shërbimeve të tyre duhet të projektohen për të funksionuar me konsum të ulët të energjisë dhe prodhim të ulët të karbonit, ku përfshihet edhe sigurimi i kontrolleve elektronike. Duhet të merret parasysh përdorimi i paneleve diellorë për të siguruar energji për ndërtesën dhe objektet e tjera.

### **5.7.1 Terminali shumëfunksionësh (TSHF)**

#### *Administrimi/Operacionet*

Ndërtesa kryesore e zyrave për administrimin e terminalit, funksionet e menaxhimit dhe operacioneve, së bashku me hapësirën dhe ambientet në katin përdhës për linjat dhe agjentët e ndryshëm të transportit, si dhe një bankë dhe siguri për ndërtesën.

Zyra para portës të vendoset në katin përdhes ose afër zonës së pritjes së kamionëve.

Dhoma e kontrollit të terminalit të vendoset në katin e fundit.

Hapësira për parkim për automjete dhe motoçikleta/biçikleta të vihet në tokën anësore të ndërtesës për stafin e terminalit dhe vizitorët, dhe parkim i kufizuar në anë të terminalit vetëm për stafin e operacioneve të terminalit.

#### *Mirëmbajtja dhe Riparimet (M&R)*

Ambientet e M&R duhet të përfshijnë një ofiçinë të pajisur mirë me hapësirë të mjaftueshme për të punuar në afërsisht 10% të pajisjeve mobile dhe shpërndarësve në çdo kohë. Të vendoset jashtë, por afër zonave të magazinimit të kontejnerëve dhe të ngarkesave të përgjithshme. Të përfshihen të paktën tiparet e mëposhtme:

- Funksionet:
    - Mirëmbajtja dhe riparimi në vend, në vend të mbuluar, i të gjitha pajisjeve të lëvizshme të përpunimit në terminal, makinerive shpërndarëse, gomave, baterive dhe pjesëve përbërëse.
    - Hapësirat e hapura të shërbimit për RTG, të pajisura me pika të lidhjes së ngrohësit anti-kondensim.
    - Baza për mirëmbajtjen dhe riparimin e VLP-ve dhe vinçave urë të montuar në shinë.
    - Baza për monitorimin dhe riparimin e furnizimeve të energjisë për kontejnerët frigoriferikë.
    - Pikë karburanti (me tendë) për t'i shërbyer të gjitha pajisjeve terminale të lëvizshme, duke përjashtuar RTG-të dhe mjetet e tjera të mëdha që ushqehen nga cisternat.
    - Parkim për pajisje të lëvizshme.
    - Baza për mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës terminale.
  - Seksioni i ofiçinës: hapësirë pa pengesa me dyer të vazhdueshme përgjatë njëres anë dhe e pajisur me një vinç të lëvizshëm të varur; stacion karikimi për automjete elektrike dhe bateri; seksionet e saldimit; testimi i presionit të gomave; sisteme pastrimi; shërbime duke përfshirë ujin, ajrin e kompresuar, lubrifikantët, gazrat.
  - Bllok 2-katesh për zyra, magazina me pikë marrëse për automjete të jashtme, dhoma zhveshjeje për të gjithë personelin e ofiçinës, seksioni i ndihmës së shpejtë.
  - Ruajtje e sigurt për artikuj të mëdhenj (p.sh. goma).
  - Seksioni i larjes së jashtme në gjendje të akomodojë automjetet më të mëdha dhe pajisjet e lëvizshme.
  - Ofiçinë e lëvizshme për të minimizuar humbjen e kohës si rezultat i defekteve të vogla.
- Zonat që janë pre e derdhjes së naftës duhet të shtrohen me pllaka betoni dhe të kullohen përmes interceptorëve të vajit ose tubave shkarkues që mbledhin ujin me mbetje vajore për depozitim të veçantë.

#### *Mensa/komoditetet*

Ndodhet ngjitur me pikën kryesore të kontrollit të personelit në terminalin kryesor. Ambientet e mensës me një *katering* të kuzhinës për dy sektorë të veçantë: “të pastër” për stafin e zyrës dhe “të papastër” për operativët e terminalit dhe personelin e mirëmbajtjes.

Kuzhina duhet të ketë akses të veçantë për automjetet e jashtme për shpërndarjen e furnizimit të *kateringut*.

Ky objekt do të përfshijë gjithashtu dhomat e zhveshjes dhe dollapët për të gjithë personelin e sheshit.

Në pikat strategjike përreth terminalit, duhet të sigurohen blloqe të vogla që përmbajnë një dushe dhe strehim për personelin e terminalit.

#### *Kontejnerë që rrjedhin/të rrezikshëm*

Dy gropa për kontejnerë 40 ft të sigurohen jashtë zonave kryesore të grumbullimit për t'u kujdesur për kontejnerët që rrjedhin. Gropat do të projektohen për të përmbajtur shkarkime të rrezikshme dhe do të ndërtohen me interceptorë të veçantë të kullimit për të lehtësuar pastrimin. Kontejnerët që rrjedhin do të transportohen brenda terminalit duke përdorur një rimorkio speciale cisternë, e cila mund të përdoret gjithashtu për të ruajtur kontejnerin si një masë e përkohshme.

Të ofrohet një kompleks i sigurt për dy njësi 40 ft, të cilat përmbajnë materiale të rrezikshme, si hap rezervë për projektimet normale të magazinimit për kontejnerët e plotë IMDG. Kompleksi të ketë një tendë për mbrojtjen nga moti, ndriçimi dhe një sistem spërkatës zjarri. Hapësira e tendës të jetë e mjaftueshme për të mundësuar që kontejnerët të manovrohen nga kamionët e renditjes.

#### *Siguria*

Terminali duhet të jetë në përputhje me kriteret e SNAP-it, dhe i gjithë kompleksi i terminalit duhet të mbrohet nga hyrja e paautorizuar. Si minimum, duhet të sigurohen kërkesat e mëposhtme:

- Përgjatë perimetrit, një gardh të fortë me rrjeta metalike, ose mur të paktën 2.4m të lartë me tela me gjemba në majë, së bashku me CCTV dhe ndriçimin rrethues të sigurisë.
- Zyra qendrore e sigurisë të përfshijë një dhomë kontrolli CCTV. Zyra do të vendoset afër portës së kamionit ose në ndërtesën kryesore të zyrave. Do të përdoret gjithashtu për të përpunuar drejtuesit e mjeteve që kërkojnë një leje një ditore kalimi.
- Sistemet e kontrollit të hyrjes (përfshirë kamerat) do të përdoren për të gjitha automjetet, ngarkesat dhe personelin që hyjnë në zonën e sigurisë. Lëvizja e të gjitha automjeteve që hyjnë në terminal do të regjistrohet dhe secilës prej tyre do t'i lëshohet një leje (ose për një vizitë të vetme ose të rinovueshme për transportuesit e rregullt). Automjeti dhe shoferi (dhe personeli tjetër në kabinë) do të fotografohen gjatë hyrjes, dhe do të mbahen të dhënat. Duhet të merret parasysh instalimi i ardhshëm i inspektimit poshtë automjetit (IPU) në të gjitha korsi të automjeteve.
- Lëvizjet e këmbësorëve brenda terminalit duhet të minimizohen përmes përdorimit të autobusëve. Stacionet e autobusëve do të vihen brenda dhe jashtë terminalit, pranë postbllokut.
- Do të kërkohen masa të veçanta në portat dytësore/emergjente. Aty ku shinat hyjnë në zonën e sigurt, do të ketë një portë sigurie përmes shinave (me personel dhe kontroll CCTV) që do të hapet vetëm kur ka lëvizje në shina.
- Për të pasur fleksibilitet maksimal në rregullimin e projektit së rrugëve dhe magazinimit për t'iu përshtatur ndryshimeve të drejtimit të trafikut dhe procedurave të përpunimit, skajet e rrugëve dhe kufijtë midis zonave të depozitimeve të kontejnerëve dhe depozitimeve të

ngarkesave me materiale të përgjithshme zakonisht do të shënohen duke përdorur barriera të rënda të gatshme betoni që mund të lëvizin me një kamion renditjeje.

### *Dogana*

Ambientet brenda ose ngjitur me sheshin e kontejnerëve, që përmbajnë:

- Një ndërtesë prej 3,000 m<sup>2</sup>, për kontroll fizik dhe depo për magazinim të përkohshëm të mallrave dhe/ose mallrave të rrezikshëm.
- 7,000 m<sup>2</sup> zonë e hapur për inspektime të kontejnerëve, përfshirë zonën e pritjes.
- Zona e skanerit të kontejnerit 3.000 m<sup>2</sup>.

Një sipërfaqe prej 400 metra katrorë brenda ose ngjitur me sheshin e ngarkesave të mallrave të përgjithshëm, për të akomoduar zyrat dhe dy peshore doganore me 50 metra katrorë secila.

### *Të tjera*

Projektuesi do të propozojë ndërtesa të tjera të vogla shtesë, siç i sheh të nevojshme, për të operuar terminalin në mënyrë efikase, duke përfshirë dhomat e impianteve, blloqet e tualetit, zyrat e kalatës, kioskat e portave dhe tendën.

Do të sigurohet magazinim i mbuluar, nëse terminali do të trajtojë materiale të ndjeshme ndaj motit që nuk mund të ruhen në ambient të hapur. Mund të kërkohet edhe ruajtja e kontrolluar nga temperatura. Depot e mbuluara duhet të projektohen të tilla që mund të zërthehen, në mënyrë që të lehtësohen ndryshimet e përdorimit/zhvendosjes.

## **5.7.2 Terminali i Mallrave rifuxho (TMR)**

### *Administrimi/Operacionet*

Ndërtesa kryesore e zyrave për administrimin e terminalit, funksionet e menaxhimit dhe operacioneve, së bashku me hapësirën dhe ambientet për linjat dhe agjentët e transportit, si dhe sigurinë për ndërtesën.

Hapësira për parkim për automjete dhe motoçikleta/biçikleta që do të sigurohen në tokën anash ndërtesës për stafin e terminalit dhe vizitorët, dhe parkim të kufizuar në anë të terminalit vetëm për stafin e operacioneve të terminalit.

### **Mirëmbajtja dhe Riparimi (M&R)**

Ambientet e M&R duhet të përfshijnë një oficinë të pajisur mirë me hapësirë të mjaftueshme për të punuar në afërsisht 10% të pajisjeve të lëvizshme dhe atyre kapëse në çdo kohë. Të vendoset jashtë, por afër zonave të magazinimit. Të përfshihen të paktën tiparet e mëposhtme:

- Funksionet:
  - Mirëmbajtja dhe riparimi në vend, në vend të mbuluar, i të gjitha pajisjeve të lëvizshme të përpunimit në terminal, pajisjeve të kapjes, gomave, baterive dhe pjesëve përbërëse.
  - Baza për mirëmbajtjen dhe riparimin e VLP-ve, ngarkuesve/shkarkuesve të anijeve, sistemeve të siloseve, tubacioneve pneumatike, transportuesve.
  - Pika karburanti (me tendë) për t'i shërbyer të gjitha pajisjeve të lëvizshme të terminalit, duke përjashtuar pajisjet e mëdha që furnizohen nga cisternat.
  - Parkim për pajisje të lëvizshme.
  - Baza për mirëmbajtjen dhe riparimin e infrastrukturës së terminalit.

## Dokumentat standarte të tenderit

- Seksioni i ofiçinës: hapësirë pa pengesa me dyer të vazhdueshme përgjatë njërës anë dhe e pajisur me një vinç të lëvizshëm të varur; stacion karikimi për automjete elektrike dhe bateri; seksionet e saldimit; testimi i presionit të gomave; sisteme pastrimi; shërbime duke përfshirë ujin, ajrin e kompresuar, lubrifikantët, gazrat.
- Bllok 2-katesh për zyra, magazina me pikë marrëse për automjete të jashtme, dhoma zhveshjeje për të gjithë personelin e ofiçinës, seksioni i ndihmës së shpejtë.
- Ruajtje e sigurt për artikuj të mëdhenj (p.sh. goma).
- Seksioni i larjes së jashtme në gjendje të akomodojë automjetet më të mëdha dhe pajisjet e lëvizshme.
- Ofiçinë e lëvizshme për të minimizuar humbjen e kohës si rrjedhim i defekteve të vogla.

Zonat që janë pre e derdhjes së naftës duhet të shtrohen me pllaka betoni dhe të kullohen përmes interceptorëve të vajit ose tubave shkarkues që mbledhin ujin me mbetje vajore për depozitim të veçantë.

### *Mensa/komoditetet*

Ndodhet ngjitur me pikën kryesore të kontrollit të personelit në terminalin kryesor. Ambientet e mensës me një *katering* të kuzhinës për dy sektorë të veçantë: “të pastër” për stafin e zyrës dhe “të papastër” për operativët e terminalit dhe personelin e mirëmbajtjes.

Kuzhina duhet të ketë akses të veçantë për automjetet e jashtme për shpërndarjen e furnizimit të *kateringut*.

Ky objekt do të përfshijë gjithashtu dhomat e zhveshjes dhe dollapët për të gjithë personelin e sheshit.

Në pikat strategjike përreth terminalit, duhet të sigurohen blloqe të vogla që përmbajnë një dushe dhe strehim për personelin e terminalit.

### *Siguria*

Terminali duhet të jetë në përputhje me kriteret e SNAP, dhe i gjithë kompleksi i terminalit duhet të mbrohet nga hyrja e paautorizuar. Si minimum, duhet të sigurohen kërkesat e mëposhtme:

- Përgjatë perimetrit, një gardh të fortë me rrjeta metalike, ose mur të paktën 2.4m të lartë me tela me gjemba në majë, së bashku me CCTV dhe ndriçimin rrethues të sigurisë dhe CCTV të projektuar për të ofruar mbulim të plotë të secilës zonë të terminalit ku përfshihen kalatat, godinat, perimetri i zonës së sigurisë dhe çdo korsi e portës së automjeteve dhe porta e këmbësorëve.
- Zyra qendrore e sigurisë të përfshijë një dhomë kontrolli CCTV. Zyra do të vendoset afër portës së kamionit ose në ndërtesën kryesore të zyrave. Do të përdoret gjithashtu për të përpunuar drejtuesit e mjeteve që kërkojnë një leje një ditore kalimi.
- Sistemet e kontrollit të hyrjes (përfshirë kamerat) do të përdoren për të gjitha automjetet, ngarkesat dhe personelin që hyjnë në zonën e sigurisë. Lëvizja e të gjitha automjeteve që hyjnë në terminal do të regjistrohet dhe secilës prej tyre do t'i lëshohet një leje (ose për një vizitë të vetme ose të rinovueshme për transportuesit e rregullt). Automjeti dhe shoferi (dhe personeli tjetër në kabinë) do të fotografohen gjatë hyrjes, dhe do të mbahen të dhënat. Duhet



të merret parasysh instalimi i ardhshëm i inspektimit poshtë automjetit (IPU) në të gjitha korsitë e automjeteve.

- Lëvizjet e këmbësorëve brenda terminalit duhet të minimizohen përmes përdorimit të autobusëve. Stacionet e autobusëve do të vihen brenda dhe jashtë terminalit, pranë postbllokut.
- Do të kërkohen masa të veçanta në portat dytësore/emergjente. Aty ku shinat hyjnë në zonën e sigurt, do të ketë një portë sigurie përmes shinave (me personel dhe kontroll CCTV) që do të hapet vetëm kur ka lëvizje në shina.

#### *Të tjera*

Projektuesi do të propozojë ndërtesa të tjera të vogla shtesë, siç i sheh të nevojshme, për të operuar terminalin në mënyrë efikase, duke përfshirë dhomat e impianteve, blloqet e tualetit, zyrat e kalatës, kioskat e portave dhe tendën.

Do të sigurohet magazinim i mbuluar, nëse terminali do të trajtojë materiale të ndjeshme ndaj motit që nuk mund të ruhen në ambient të hapur. Depot e mbuluara duhet të projektohen të tilla që mund të zërthehen, në mënyrë që të lehtësohen ndryshimet e përdorimit/zhvendosjes.

### **5.7.3 Ambientet e përbashkëta të portit**

#### *Autoriteti Portual*

Zonë e dedikuar prej 2,000 m<sup>2</sup> për zyra dhe parkim.

#### *Kapiteneria e portit*

Zonë e dedikuar prej 400 m<sup>2</sup> për zyra dhe kullë kontrolli, plus hapësira parkimi dhe depo të sigurt për njësitë detare dhe pajisjet e derdhjes së naftës.

#### *Policia Kufitare*

Sipërfaqe totale toke prej 500 m<sup>2</sup>.

#### *Dogana*

Zonë e përgjithshme prej 3,000 m<sup>2</sup> për zyra, depo, parkim, qendër trajnimi, etj.

#### *Shërbimet e urgjencës*

- Stacion zjarrfikës, me sipërfaqe totale toke prej 1,000 m<sup>2</sup>, ku përfshihet tenda për makina zjarrfikëse.
- Qendra mjekësore që ofron pajisje të ndihmës së shpejtë, me një tendë për një ambulancë.

## **5.8 Shërbimet komunale**

Të projektohet për të përmbushur kërkesat funksionale, operacionale dhe mjedisore të përdoruesve. Parashikohen masat e mëposhtme, por të gjitha shërbimet duhet të projektohen në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

### **5.8.1 Furnizimi/Shpërndarja e Ujit**

Uji i pijshëm do të furnizohet nga sistemi publik. Propozohet që depozita e ujit të përbëhet nga një rezervuar tokësor, që mban kërkesën maksimale ditore, dhe një rezervuar më të vogël ajror të

mbushur duke përdorur pompat e instaluara në rezervuarin e tokës. Rezervuarët do të vendosen në zonën e përbashkët të porteve, jashtë terminaleve.

Rrjeti unazor do të shpërndajë ujin përreth çdo terminali, duke përfshirë kalatat për furnizimin e anijeve dhe ndërtesat e përbashkëta. Rrjeti duhet të sigurojë rrjedhje adekuate dhe presion minimal prej 4 bar në çdo pikë. Ndërtesat do të kenë rezervuarë në çati.

Magazinimi i rezervuarit tokësor do të jetë i mjaftueshëm për përdorim të paktën 24 orë kur terminalet operojnë me kapacitet të plotë, bazuar në kërkesën mesatare ditore të ujit nga fuqia punëtore dhe përdorime të tjera duke përfshirë TMR (shtypja e pluhurit), zonat e mirëmbajtjes (larja e pajisjeve, etj.) ) dhe kalatat (furnizimi i anijeve).

### **5.8.2 Mbrojtja nga zjarri**

Një sistem i veçantë zjarrfikës me ujë të ëmbël do të instalohet në secilin terminal dhe zonën e përbashkët të portit. Rrjeti unazor, i lidhur me hidrantët, do të sigurojë një sistem të vazhdueshëm nën presion që mbahet plot me ujë.

Sistemi i fikjes së zjarrit duhet të përfshijë një rezervuar të dedikuar, të vendosur në zonën e përbashkët të ambienteve të portit, të furnizuar nga rrjeti i ujit të pijshëm, me kapacitet furnizimi prej 150 cu m për të furnizuar dy hidrantë, të cilët secili nxjerr 600 l/min për dy orë. Dy pompa - një elektrike dhe një me motor - duhet secila të jenë të afta të mbajnë një rrjedhë minimale prej 600 l/min nga dy hidrantë ngjitur në presion 3 bar.

Pajisjet e zjarrfikësve do të instalohen gjithashtu në seksione të cënueshme, si rezervuarët dhe shpërndarësit e karburantit.

Sistemet e zbulimit dhe alarmit të zjarrit, duke përfshirë një panel alarmi për të treguar statusin e zonave dhe pajisjeve të alarmit, do të ofrohet në të gjitha ndërtesat dhe do të kthehen në një tastierë kontrolli në stacionin e zjarrit në port.

### **5.8.3 Kanalizimet**

Ujërat e ndotura shtëpiake dhe ujërat e zeza nga të gjitha ambientet në port duhet të mblidhen me anë të tubave në një ose më shumë impiante të trajtimit të ujërave të zeza të vendosura brenda portit.

Rezervuarët mbajtës do të vihen si rezervë në rast të prishjeve të pompës së shkarkimit. Ujërat e zeza të trajtuara ose do të përdoren për të ujitur zonat e peizazhit ose do të hidhen në rrjetin e gravitetit publik ose në det me kusht që të jenë në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare.

### **5.8.4 Mbledhja e Produkteve të Mbeturinave**

Do të sigurohen ambiente për të marrë mbeturinat nga anijet për t'u siguruar që çdo terminal është në përputhje me kërkesat e MARPOL, si dhe për të mbledhur mbeturina dhe ndotësit nga terminalet dhe ambientet e përbashkëta të portit.

### **5.8.5 Ambientet dhe depozitimi i karburantit**

Lënda djegëse naftë do të furnizohet përmes një tubacioni të dedikuar nga depoja ekzistuese, por gjithashtu do të sigurohen ambientet për dërgesat e cisternave rrugore. Karburantet do të përdoren për të furnizuar automjetet dhe pajisjet e lëvizshme.

Një pikë karburanti e përbërë nga pompa dhe shpërndarës të karburantit do të sigurohet në secilin terminal për traktorët e terminalit dhe automjetet e tjera të terminalit. Një cisternë karburanti do të përdoret për të ri-mbushur motorët ndihmës në VLP dhe ERTG, dhe kamionët e renditjes dhe ECH. Do të sigurohen të paktën dy shpërndarës për terminal.

Depozitat e ruajtjes së karburantit duhet të jenë ngjitur me pikat e karburantit të automjeteve, me kapacitet të mjaftueshëm për konsumin mesatar të afërsisht 12 ditëve kur terminali funksionon me kapacitet të plotë. Rezervuarët do të vendosen për të lejuar hyrjen e sigurt, me hapësirë për automjetet që presin karburantin dhe cisternën e dërgesës. Rezervuarët duhet të kenë rrethimin përkatës që përmban derdhjet, me kullim përmes interceptorëve.

Parashikohet që karburanti për anijet, nëse kërkohet, do të furnizohet nëpërmjet një anijeje mallrash nga një prej terminaleve ekzistues detarë në Porto Romano.

### **5.8.6 Shërbimet kabllore**

Sistemi elektrik i portit do të përfshijë një nënstacion kryesor hyrës të vendosur në zonën e ambienteve të përbashkëta të portit, shpërndarjen dhe nënstacionet e VL, dhe rrjetet e shpërndarjes në të gjitha ngarkesat dhe daljet elektrike. Projektimet, materialet dhe impianti duhet të jenë në përputhje me rregulloret aktuale të IEE dhe CEB.

Furnizimi me energji elektrike për kontejnerët frigoriferikë do të bëhet përmes lidhjeve të sigurta të montuara në platformat e çelikut të aksesit me sheshpushim në secilin nivel të kontejnerëve dhe shkallëve midis sheshpushimeve.

Burimet rezervë të energjisë duhet të sigurohen për ambientet thelbësore ku përfshihen siguria, sistemet e alarmit dhe TI, duke ofruar siguri për vinçat urë që mbartin një ngarkesë, nivele minimale për ndriçimin e jashtëm, kontejnerët frigoriferikë dhe pajisjet e ofiçinës, pompat, si dhe ndriçimin e ashensorët në ndërtesa. Në varësi të kriterëve të sistemit, energjia rezervë mund të kërkohet gjithashtu për instalimet e ngrohjes me vaj vegjetal dhe vende me temperaturë të kontrolluar. Duhet të merren masa për të lehtësuar furnizimin e ardhshëm me energji elektrike për anijet në të gjitha kalatat.

Lidhjet e jashtme telekomunikuese do të bëhen në zonën e përbashkët të ambienteve portuale.

Lidhjet e TI-së do t'i sigurohen të gjitha ndërtesave operacionale dhe objekteve, duke përfshirë depozitimet e kontejnerëve frigoriferikë, nënstacionet, dhomat e impianteve dhe impiantet dhe pikat e karburantit dhe të gjitha pajisjet e përpunimit.

Sistemet e telekomunikimit dhe transmetimit të të dhënave duhet të përfshijnë lidhje EDI me Portin, Doganat, sigurinë e portit dhe përdoruesit e portit. Në çdo ndërtesë administrate do të vendoset një qendër telefonike me karikues.

Sistemet e sigurisë për të kontrolluar dhe monitoruar aksesin e personelit përtej kufijve të portit dhe terminalit dhe brenda zonave të terminalit, dhe për të zbuluar hyrjen e paautorizuar dhe për të aktivizuar alarmet do të instalohen në të gjitha dyert e jashtme të ndërtesave dhe ambienteve operacionale.

Sistemi CCTV duhet të jetë i integruar me sistemet anti-ndërhyrje dhe të ndriçimit dhe duhet të plotësojë kërkesat e SNAP. Kamerat do të kontrollohen në distancë nga një qendër kontrolli e vendosur në zyrën e sigurisë. Kamerat e portave duhet të kontrollohen nga kioska e korsisë.

Një sistem i zbulimit dhe alarmit të zjarrit/tymit/nxehtësisë do të instalohet në të gjitha ndërtesat dhe ambientet operacionale dhe këto do të lidhen me një panel qendror në ndërtesën e administratës.

Të gjithë kabllot nëntokësore duhet të vendosen në kanale.

Duhet të sigurohet mbrojtja nga rrufeja dhe strukturat, përfshirë shinat hekurudhore, duhet të tokëzohen.

### **5.8.7 Ndriçimi**

Ndriçimi duhet të instalohet në të gjitha zonat për të siguruar nivele të vazhdueshme dhe uniforme të ndriçimit, të përshtatshme për aktivitetet në secilën zonë. Duhet të sigurohet ndriçimi i emergjencës për të lehtësuar daljen e sigurt në rast të ndërprerjes së energjisë.

Ndriçimi i zonës dhe ai i sigurisë do të projektohen për të lejuar punë të sigurt natën, me shtyllat e ndriçimit të vendosura për të bërë optimal përdorimin e hapësirës së terminalit dhe për të minimizuar hijet. Sisteme të tilla do të kontrollohen automatikisht por do të përfshijnë një kalim manual.

Do të sigurohen shtylla të larta ndriçimi për të ndriçuar platformat e kalatës, zonat e magazinimit, portat/zonat e pritjes së kamionëve dhe терминаlet hekurudhore. Projektimi i shtyllave do të lejojë që fenerët të ulen në tokë për inspektim dhe riparime.

Ndriçimi rrugor do të sigurohet për të gjitha rrugët e shërbimit dhe zonat e parkimit.

Në përgjithësi, duhet të përdoren pajisjet e aprovuara të ndriçimit LED.

### **5.8.8 Sistemet Operative të Terminalit (SOT)**

SOT-et që do të instalohen nga operatorët e terminaleve, të cilët do të formojnë një pjesë të sistemit të përgjithshëm të TI-së brenda terminaleve, do të jenë sisteme të provuara, të përshtatshme për llojet e ngarkesave dhe operacioneve në secilin terminal. SOT do të sigurojnë të gjithë funksionalitetin dhe stabilitetin e kërkuar që терминаlet të funksionojnë në mënyrë efikase.

Funksionet mund të përfshijnë planifikimin e anijes (planin e vendosjen së ngarkesës), planifikimin e sheshit (alokimet e sheshit/njoftimet) dhe kontrollin e të gjithë kontejnerëve dhe ngarkesave që hyjnë dhe dalin nga terminali dhe ndërsa ato ruhen ose zhvendosen në terminal. Sistemet duhet të lejojnë menaxhimin e portave, sheshit, mbërritjet dhe shkarkimet e anijeve, njoftimet (rezervimet), shtyrjeve dhe nxjerrjeve, si dhe funksionet arkivore. Ata duhet të lejojnë klientët (linjat, Doganat dhe marrësit e përzgjedhur) të kenë akses në informacion përmes internetit, dhe gjithashtu të lejojnë vendosjen dhe lëshimin e shtyrjeve nga linjat dhe Dogana.

Punimet do të përfshijnë infrastrukturën fikse e nevojshme për instalimet dhe pajisjet SOT nga operatorët.

### **5.8.9 Shërbimet dhe pajisjet e ofiçinës**

Ofiçinat e terminalit duhet të jenë plotësisht të pajisura për të mundësuar që operatorët të ndërmarrin mirëmbajtjen dhe riparimin e të gjitha pajisjeve dhe automjeteve të terminalit. Shërbimet e ofiçinës do të përfshijnë sisteme për ajër të kompresuar, lubrifikim dhe gazra, të gjitha të projektuara në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret lokale. Pajisjet e ofiçinës duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret vendore dhe do të furnizohen nga prodhues të njohur në përputhje me specifikimet e tyre standarde.

Projekti i ofiçinave dhe ambienteve duhet të përmbushë kriteret e pajisjeve të përpunimit dhe përdorimit në konsultim me prodhuesit. Duhet të sigurohet hapësira e përshtatshme për ruajtjen e pjesëve rezervë dhe materialeve të konsumit me hapësira të kondicionuara, sipas nevojës.

Do të sigurohet çdo pajisje e rekomanduar dhe e specializuar për të ndërmarrë mirëmbajtjen e pajisjes së përpunimit. Do të përfshihen zona adekuate të hapura ose të shtruara.

Sistemet e TI-së për të kontrolluar inventarët e pjesëve rezervë, sistemet e mirëmbajtjes dhe të dhënave duhet të sigurohen dhe përfshihen si pjesë e sistemeve të terminaleve.

## Shtojca - KUSHTET E REFERENCËS

### 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

#### Objektivat e projektit

Qeveria ka si objektiv që Portin e Durrësit ta shndërrojë në një qendër urbane për zhvillimin e pasurive të patundshme, turizmin dhe transportin detar të pasagjerëve. Si pjesë e këtij vizioni, disa nga veprimtaritë portuale ekzistuese që zhvillohen në Portin e Durrësit do të zhvendosen në Porto Romano, një zonë ekzistuese portuale, që ndodhet 10km në veri të Portit të Durrësit.

**Operacionet dhe infrastruktura e lidhur me mallrat në Portin e Durrësit, përfshijnë sa më poshtë:**

Shërbimet në Portin e Durrësit	Vendndodhja e shërbimeve në të ardhmen
Terminali i kontejnerëve. Ky terminal administrohet nga Autoriteti Portual Durrës (APD) (Aktualisht është shpallur një tender për gjetjen e një operatori që do të administrojë këtë terminal gjatë 5 viteve të mbetura para zhvendosjes së tij).	Këto shërbime do të zhvendosen në Terminalin e ri Shumë shërbimesh të Porto Romanos.
Mallrat Gjenerale (Terminali perëndimor) – administrohet nga APD	

<p>Terminali i Mallrave Rifuxho (Terminali Lindor) – administrohet nga EMS-APO</p>	<p>Këto shërbime do të zhvendosen në Terminalin e ri të Mallrave Rifuxho në Porto Romano dhe do të vazhdojnë të administrohen nga koncesionarët aktualë sipas kontratës në fuqi.</p>
<p>Terminali i Trageteve – administrohet nga kompania AFTO (Operatori Shqiptar i Terminalit të Trageteve)</p>	<p>Ky terminal do të qëndrojë në Portin e Durrësit.</p>

NëFigurën 1 më poshtë tregohet planimetria e Portit ekzistues të Durrësit dhe të tri terminaleve që do të zhvendosen nëPorto Romano.

Figura 1: Porti i Durrësit



### Porto Romano

Ndodhet në veri të qytetit të Durrësit. Në vitin 2004, Porto Romano u dha me koncesion të formës BOT (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) për transportin e produkteve tënaftës dhe të gazit të lëngshëm. Koncesioni i dytë, i cili ndodhet në jug të Porto Romanos, iu dha shoqërisëPorti MBM në vitin 2017 për përpunimin e mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure dhe mallra rifuxho: po planifikohet të ofrohet edhe shërbimi CBM.Siç tregohet në Figurën 2, zona në veri të instalacioneve ekzistuese është konsideruar si një vendndodhje e

mundshme për të zhvendosur jo vetëm veprimtaritë e terminaleve të Portit të Durrësit port edhe administrimin e mallrave.

Kërkoheq që studimi të ofrojë një projekt të detajuar për zhvillimin afat-mesëm të portit si dhe nëprojektet e planimetrisë duhet të përcaktohet mënyra e rritjes së kapaciteteve me qëllim për të pasur një rritje në planin afatgjatë. Dy fazat e planifikimit të zhvillimit përkufizohen si më poshtë:

Faza 1: Projekti i detajuar për Fazën 1 duhet të jetë mjaftueshëm i madh për të përballuar aftësinë e kalimit të mallrave portuale deri në vitin[2053], bazuar edhe në parashikimet e Këshilltarit për trafikun. Kapaciteti i terminaleve për Fazën 1 nuk duhet të jetë më i vogël se ai i terminaleve ekzistuese në Portin e Durrësit.

Zhvillimi përfundimtar: Në projektin e planimetrisë duhet të jepet gjithashtu edhe mënyra se si porti mund të zgjerohet me kalimin e kohës duke kaluar nëpër faza të ndryshme. Ndërkaq, kapaciteti përfundimtar do të përcaktohet duke u konsultuar gjithashtu edhe me APD-në.

Figura 2: Vendi i propozuar për Portin e Porto Romanos



Vendndodhja e re e Porto Romanos  
Kanali i drenazhimit



## **2 OBJEKTIVAT E KONSULENCËS**

Objektivi kryesor i kësaj konsulence është kryerja e të gjitha shërbimeve të nevojshme për të përfunduar master planin dhe për të përgatitur projektet e duhura për ndërtimin dhe dokumentet e tenderit që duhet t'iu dorëzohen kontraktorëve. Detyrat kryesore janë si më poshtë:

- a. Rishikimi i studimeve dhe të dhënave ekzistuese, si dhe përditësimi i master planit për Portin e Porto Romanos.
- b. Kryerja e analizave ekonomike dhe financiare.
- c. Planifikimi i kërkimeve për qëllime të projektit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.
- d. Përgatitja e planimeve të portit, përfshirë edhe modelimin numerik.
- e. Kryerja e vlerësimit për ndikimin që mund të ketë në mjedis projekti i portit.
- f. Përgatitja e planit të detajuar për punimet e Fazës 1, duke përfshirë edhe modelimin e valëve fizike.
- g. Përgatitja e dokumenteve të tenderit për ndërtimin dhe kryerjen e punimeve të Fazës 1.
- h. Hartimi i raporteve për secilën nga detyrat e përmendura më sipër.

Projekti do të jetë në përputhje me legjislacionin shqiptar, standardet dhe kodet e praktikës, në përputhje me standardet dhe kodet e punimeve detare dhe të tjera të njohura ndërkombëtarisht, përfshirë Standardet Britanike, Euro kodet dhe udhëzuesit PIANC.

## **3 RISHIKIMI I STUDIEMEVE DHE TË DHËNAVE EKZISTUESE**

### **3.1 Të përgjithshme**

Konsulenti do të studiojë dhe do të marrë parasysh të gjitha dokumentacionet ekzistuese për Porto Romanon, përfshirë edhe ato të përcaktuara më poshtë, si dhe të gjitha kërkimet, studimet projektet e mëparshme, dhe punimet e kryera për terminalët ekzistues detare dhe portin e ri. Ata do të studiojnë gjithashtu dhe do të marrin në konsideratë kushtet fizike në dhe që prekin kantierin, përfshirë batimet, topografinë, meteo-oqeanografinë, gjeoteknikën, sendimentimin dhe hidrologjinë.

Falë përdorimit të këtyre dokumenteve, Konsulenti do të përditësojë master planin, si dhe do të konstatojë boshllëqet lidhur me informacionet për kantierin, të cilat duhet të plotësohen me qëllim për të planimetri për të gjithë portin dhe skica të detajuara për Fazën 1.

### **3.2 Parashikimi i trafikut**

Porti i Durrësit parashikohet të mbyllet për të gjithë trafikun e mallrave me përjashtim të transportit të mallrave që kryhet përmes trageteve. Paskëtaj, në port do të ankorohen vetëm tragetet, anijet turistike dhe jahtet. Në portin e ri të Porto Romanos do të administrohen të gjitha mallrat e Durrësit dhe të zonave të tij të thella, si dhe trafikun tranzit për në / nga vende të tjera, me përjashtim të anijeve të tipit ro/ro. Derivatet e naftës administrohen dhe do të vazhdojnë të administrohen në terminalët ekzistues detare të Porto Romanos, funksionimi i të cilave do të jetë i pavarur nga porti i ri.

APD ka përgatitur një parashikim për trafikun e porteve të Durrësit dhe të Porto Romanos. Konsulenti do ta rishikojë dhe përditësojë parashikimin, si dhe do të bëjë parashikimet e tij për gjendjen e trafikut deri në vitin 2053. Duke marrë në konsideratë tregtinë rajonale, në parashikim do të trajtohet i gjithë trafiku detar i mallrave që administrohet në rajonin e Durrësit, përfshirë zonën logjistike të Porto Romanos, si dhe duke përfshirë trafikun tranzit për në/nga vendet në brendësi, si dhe zhbartjen e mallrave në një anije tjetër, nëse ka.

Në parashikim do të pasqyrohen vlerësimet vit pas viti për të gjitha llojet e mallrave, përfshirë edhe vëllimet që do të administrohen në Porto Romano. Në parashikimet për Porto Romano do të përfshihen tipet, madhësitë, skicat dhe numrin e vendndalimeve të anijeve në çdo tregti, si dhe tregon përmasat e mallrave që transportohen në brendësi të vendit përmes transportit rrugor dhe hekurudhor.

Krahas rastit bazë, do të përgatiten edhe parashikime gjithëpërfshirëse, të cilat do të përdoren si të dhëna kryesore për projektimin e portit të ri, përfshirë dhe kapacitetin e punimeve të Fazës 1. Kapaciteti i “Zhvillimit të fundit”, i cili duhet të përshtatet për të përballuar rritjen e mundshme afatgjatë dhe duhet përcaktuar pas konsultimeve me APD-në.

### **3.3 Planimetria konceptuale e portit**

Planimetria konceptuale për portet e Durrësit dhe të Porto Romanos u përgatit nga Porti Antëerp International [PAI]. Konsulenti do ta rishikojë raportin dhe do të paraqesë komente për qasjen e përgjithshme dhe përfundimet.

### **3.4 Master Plani i portit dhe specifikimet teknike**

Master plani dhe specifikimet teknike për Portin e Porto Romanos u përgatitën nga APD-ja. Ndonëse gjatë përgatitjes së master planit u morën në konsideratë një sërë planimetri portesh alternative, planimetria e zgjedhur bazohej në planin konceptual të portit, por me ndryshime. Master plani është një dokument i veçantë dhe specifikimet teknike janë pasqyruar në Shtojcën 12 të Termave të Referencës.

Për master planin referojuni materialet bashkalidhur.

Konsulenti do ta rishikojë master planin, planimetritë alternative të portit dhe specifikimet teknike, si dhe do të paraqesë komente lidhur me qasjen e përgjithshme, përfundimet e raportit dhe specifikimet teknike. Në rastet kur Konsulenti dëshiron të propozojë një planimetri tjetër për portin, përfshirë edhe një prej alternativave të marra në konsideratë më parë, ai duhet të japë në raportin e tij detajet dhe arsyet, të cilat do të analizohen nga APD-ja.

Në rishikim do të përfshihen pikat e aksesit rrugor dhe hekurudhor, si dhe lejet e sigurisë për në instalacionet ekzistuese të lëndëve petrokimike.

### **3.5 Dokumentacione të tjera**

Dokumentacionet shtesë që duhet të paraqiten në lidhje me projektin, janë si më poshtë:

Të përgjithshme:

- Studim batimetrik për zonën e propozuar për portin. Roja Bregdetare Shqiptare, 2020.
- Raport për kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike të Zonës së Projektit “Multi Buoy Mooring” të ndodhur në Porto Romano. Altea & Geostudio 2000, Maj 2017.
- Raport port kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike të Portit të llojit MBM në Porto Romano. Altea & Geostudio 2000, Korrik 2020.

- Hartimi/Përditësimi i Master Planit për Portin e Durrësit. Royal Haskoning për Komisionin Evropian, 10 Korrik 2008.
- Informacione të ndryshme lidhur me trafikun dhe operacionet e Portit të Durrësit të vëna në dispozicion nga APD.
- Regjistrime të ndryshme të erërave për Portin e Durrësit. [në shqip]
- Informacione të ndryshme lidhur me gjeologjinë dhe rrjetet e transportit për rajonin e Durrësit. [në shqip]
- Master Plani dhe Zonat Energjitike dhe Industriale në Porto Romano. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, 2008. [në shqip]
- Materiale të tjera me të dhëna. [në shqip]

#### Interneti:

- Imazhe satelitore të marra nga “Google Earth” nga viti 2002 dhe në vazhdim.
- Master Plani për Gjirin e Porto Romanos, Shqipëri. Temë për studimet Master e punuar nga MK Kersten, TU Delft, Qershor. 2010. <https://repository.tudelft.nl/islandora/object/uuid:62a2387f-6652-49f6-9c7a-1ccc714056c3>
- Bregdeti i Shqipërisë: morfologjia, evolucioni dhe çështjet e menaxhimit bregdetar. Simeoni Pano, Ciavola. Bulletin de l’Institut oceanographique, Monaco, no special 18, 1997. [https://www.researchgate.net/publication/292994225\\_The\\_coastline\\_of\\_Albania\\_morphology\\_evolution\\_and\\_coastal\\_management\\_issues/link/56b4cce008ae5ad36057601b/download](https://www.researchgate.net/publication/292994225_The_coastline_of_Albania_morphology_evolution_and_coastal_management_issues/link/56b4cce008ae5ad36057601b/download)
- Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë sipas Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Bruçi, Islami, Kamberi. Ministria e Mjedisit, Qershor 2016. [https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3\\_13%20October%202016\\_0.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/resource/Albania%20NC3_13%20October%202016_0.pdf)
- VNM për Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare të Shqipërisë. ERM së bashku me SËS për Bankën Botërore, Janar 2008. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/481951468004248997/pdf/E11410v30Rev10with0Cover1Jan02008.pdf>
- Raporti për Zbatimin, Plotësimin dhe Rezultatet për një kredi dhënë Republikës së Shqipërisë për Projektin e Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (P086807). Banka Botërore, 27 Prill 2016. <http://documents1.worldbank.org/curated/en/745151468193736473/pdf/ICR3327-P086807-Box394888B-OUO-9.pdf>

### 3.6 Përditësimi i Master Planit

Master Plani do të përditësohet nga Konsulenti duke u bazuar në rishikimet e dokumenteve dhe të dhënave ekzistuese. Më pas, do ta depozitojë atë pranë APD-së si një raport të vetëm. Master Plani i përditësuar do të jetë baza e skicave.

## 4 ANALIZA EKONOMIKE DHE FINANCIARE

### a. Analiza e kostos dhe përfitimit

Konsulenti do të kryejë një analizë të detajuar për kostot dhe përfitimet sociale. Analiza për ndikimin social ka për qëllim të trajtojë përfitimet sociale të projektit dhe qëndrueshmërinë e tij ekonomike. Analiza do të marrë në konsideratë skenarët “me” dhe “pa” projekt. Për qëllime të analizës së përfitimeve dhe kostove, në këto të fundit do të përfshihen kostot e zhvillimit, kostot e investimit, kostot operacionale, kostot vjetore të mirëmbajtjes, kostoja e zëvendësimit/mirëmbajtjes së vazhdueshme, kostot e kryera për shkak të ndikimeve mjedisore e sociale, si dhe të gjitha kostot e tjera që Konsulenti mendon se kanë lidhje me analizën.

Për sa i përket përfitimeve, Konsulenti do të përcaktojë vlerën e përfitimeve që do të ketë komuniteti ku ndodhet porti, si dhe përfitimet në shkallë vendi. Duke pasur parasysh se qëllimi i këtij projekti është t’i krijojë mundësinë portit të vjetër të Durrësit të zhvillohet më tej, në analizën e kostove dhe përfitimeve duhet të merren parasysh edhe përfitimet që do të ketë zhvillimi urban dhe turizmi i Portit të Durrësit, por njëkohësisht edhe zhvillimi që do të ketë Porto Romano.

Përlllogaritja e kostove dhe përfitimeve, si dhe e treguesve kryesorë ekonomikë do të bëhet për një periudhë 30-vjeçare. Treguesit kryesorë që do të përlllogariten janë si më poshtë:

- NBEK (norma e brendshme ekonomike e kthimit)
- VAN (vlera aktuale neto)
- RPK (raporti përfitim-kosto).

#### b. Analiza financiare

Konsulenti do të përgatisë një model për vlerësimin financiar të master planit të përditësuar. Në modelin e krijuar do të pasqyrohen dy dimensione: i pari lidhet me flukset financiare sipas këndvështrimit të autoritetit portual, ndërsa i dyti do të pasqyrojë të ardhurat financiare nga operatori i mundshëm i terminalit shumë shërbimesh (operatori i terminalit të mallrave rifuxho do të zhvendoset nga Porti i Durrësit). Qëllimi i dimensionit të parështë që autoriteti portual të ketë mundësinë të vlerësojë se çfarë ndikimi financiar do të ketë në financat e tij programi i propozuar për investim. Dimensionin e dytë përfaqëson perspektivën që ka operatori potencial privat për të përcaktuar vlerën e biznesit të përfshirë në një transaksion të mundshëm për investime në sektorin privat.

Në analizën financiare duhet të përfshihet parashikimi për një periudhë 30-vjeçare, ndërsa qëllimi duhet të trajtojë vetëm portin e Porto Romanos, duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat financiare nga rihvillimi i Portit të Durrësit.

Sipas këndvështrimit të autoritetit portual dhe investitorit të mundshëm, modeli duhet të gjenerojë sa më poshtë:

- Pasqyrat financiare Pro Forma, në të cilat do të pasqyrohet përlllogaritja e normës së brendshme financiare të kthimit (NBEK).
- Flukset financiare neto për qeverinë, duke parashikuar të ardhurat dhe shpenzimet e ardhshme që do të ketë autoriteti portual për hartimin e master planit. Në to do të përfshihen gjithashtu edhe pagesat për përdorimin e aseteve nga operatorët dhe qiramarrësit.
- Parashikimet e Vlerës, të cilat do të japin të dhëna lidhur me vlerën ekonomike të operimit, do të formulohen nga pasqyrat financiare, duke përdorur vlerat aktuale të flukseve të mëtejshme monetare ose shumëfishat e EBITDA (fitimeve para pagimit të interesave kreditorë, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit) bazuar në standardet e industrisë.

Në analizë duhet të pasqyrohet përlllogaritja e pikës kritike të rentabilitetit dhe treguesit standardë financiarë (përfshirë vlerën aktuale neto të Projektit dhe Kapitalit, ROI/Kthimin nga investimi, ROE/Kthimin nga kapitali, RMI/Raportin e Mbulimit të Interesave, dhe DSCR/Raportin e Mbulimit

të Shërbimit të Borxhit), si dhe vlerësimet për qëndrueshmërinë e të ardhurave financiare duke marrë parasysh trafikun e mundshëm të pafavorshëm dhe prirjet e kostove në të ardhmen.

## **5 KRYERJA E KËRKIMEVENË KANTIER**

Nga kërkimet e kryera në kantier duhet të sigurohen të dhënat e nevojshme për realizimin e projekteve dhe VNM. Gjithashtu, këto kërkime duhet të kryhen në fillim të projektit dhe ato do të kontraktohen nga Konsulenti, i cili do të zgjedhënjë ose më shumë shoqëri që kanë përvojën dhe kualifikimet e duhura.

Në lidhje me kryerjen e kërkimeve në kantier për projektin, Konsulenti do të marrë përsipër përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

- Do të përcaktojë kërkimet që duhet të kryhen në kantier për të plotësuar mungesën e informacione të konstatuara gjatë rishikimit të të dhënave: shikoni listën e mëposhtme.
- Do të përgatisë një listë me kërkimet e propozuara për t'u kryer në kantier, përfshirë planimetrinë, qëllimin e projektit, kohëzgjatjen dhe koston.
- Si pjesë e shprehjes së interesit të Konsulentit dhe dorëzimeve të ofertave, do të përgatisë një listë me kontraktorët që do të kryejnë kërkimet në kantier, të cilët janë propozuar nga Konsulenti, si dhe do të përgatisë kontratat e përkohshme/Memorandum Mirëkuptimi, në mënyrë që kontratat të mund të lidhen sa më shpejt të jetë e mundur, pas miratimit të kontratës së konsulencës.
- Do të përgatisë hollësitat e projektit, vizatimet dhe dokumentet e tenderit për kërkimet në kantier, përfshirë edhe kërkesat për testim e raportim.
- Do të merret me zgjidhjen e çështjeve që mund të dalin gjatë periudhës së kryerjes së kërkimeve.
- Do të marrë në dorëzim, rishikojë dhe analizojë rezultatet e vëna në dispozicion nga kontraktorët që kryejnë kërkimet në kantier gjatë periudhës së hulumtimeve në terren dhe testeve laboratorike.
- Do të këshillojë APD-it, sa më shpejt të jetë e mundur, lidhur me rezultatet që mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm në projekt.
- Do t'i propozojë APD-it ndryshime gjatë kryerjes së kërkimeve në kantier, dhe nëse kërkohet, do të përcaktojë ndikimin e përafërt që mund të ketë në kohëzgjatjen dhe koston e projektit, si dhe do të japë urdhrat për ndryshime sipas rastit. Konsulenti do t'i mbulojë vetë ndryshimet vlera e të cilave kam shumën e më pak se 5,000 Eurove, ndërsa APD do ta rimbursojë Konsulentin për ndryshimet që tejkalojnë shumën e 5,000 Eurove.
- Do të rishikojë dhe do të japë komente për draft-raportet përfundimtare të paraqitura nga kontraktorët që kanë kryer kërkimet në kantier, si dhe do të marrë në dorëzim raportet përfundimtare.
- Do të kryejë pagesat sipas faturave të paraqitura nga kontraktorët që kanë kryer kërkimet në kantier.
- Do të përgatisë për APD-it raportet për secilën nga kontratat e kërkimeve në kantier, duke bërë një përmbledhje të shkurtër të qëllimit dhe rezultateve. Gjithashtu, Konsulenti do të japë interpretimin e tij të rezultateve për qëllimet e projektit dhe VNM.

Kërkimet e mundshme që mund të kërkohen të kryhen në kantier jepen më poshtë. Gjatë përgatitjes së planit për kryerjen e kërkimeve në kantierin e propozuar për projekt, Konsulenti do të propozojë ndryshimin e listës, duke dhënë arsyet e mëposhtme:

- Studimi batimetrik dhe gjeofizik/sizmik i të gjitha zonave detare të cilat janë marrë në konsideratë për ngritjen e portit të ri, përfshirëzonat për depozitimin e sedimenteve të nxjerra nga pastrimitdhe vendet që do të mbushen për bonifikim, me qëllim për të matur thellësinë dhe për të vlerësuar natyrën e shtresave në sipërfaqen e detit.
- Studimi batimetrik dhe topografik i zonave të afërta detare te të cilat mund të ketë ndikim porti i ri (p.sh. shtimi i sedimenteve ose erozioni).
- Studimi me pajisjen “Side-scan” i të gjitha zonave portuale detare për të përcaktuar tiparet e fundit të detit, zbulimet shkëmbore, objektet arkeologjike e objekte të tjera, etj.
- Nëse kërkohet, studimi magnetometër (duke përdorur të njëjtat studime të kryera për më sipër), me qëllim për të zbuluar objektet metalike/armatimet e pashpërthyer.
- Puset e thella përgjatë vijës së strukturave kryesore(përfshirëvalëpritisit, muret e moleve, kullat e silosit) dhe puset më të cekëta për zonat e tjera të ndërtimit (pastrimi i trupave ujqorë, bonifikimi i zonave të tjera portuale si dhe përgjatë rrugëve e hekurudhave brenda 100 metrave nga kufiri portual), duke përfshirë marrjen e kampionëve të dheut e shkëmbinjve, plus metodat plotësuese si vibro-cores, testet e penetrimit tëkoneve, marrja e kampionëve nga fundi i detit, gjermimi i tokës për marrjen e kampionëve, metoda e marrjes sëkampionëve përmes testeve për përcaktimin e fortësisë së tokës së pakulluar në dherat kohezivë, etj. (në varësi të dherave që hasen gjatë procesit).
- Të dhëna hidraulike përfshirë matjen regjistrikeve të valëve të drejtuara, rrymës, baticës, erës dhe temperaturës për një periudhë sa më të gjatë që të jetë e mundur.
- Studimi topografik i të gjitha zonave bregdetare brenda kufirit të propozuar për portin dhe zonat përreth deri në 100 metra largësi nga kufiri, duke përfshirë kanalet e kullimit, ndërtimet mbrojtëse nga deti dhe përmbytjet, utilitetet, kufijtë e pronës dhe ngritjet nga toka të infrastrukturës/pronave ekzistuese që do të ruhen.
- Matje të tjera të kërkua për VNK (p.sh. marrja e kampionëve të ujit të detit dhe ujërave tokësorë, turbullira, ndotja, jeta detare, ekologjia tokësore).
- Kërkime për gurore për materiale shkëmbore që do të përdoren për mbushje dhe bonifikim, përfshirë marrjen e kampionëve.
- Kontrollimi i cilësisë dhe kapacitetit të guroreve ekzistuese për tëfurnizimin me materiale të cilat do të nevojiten për beton dhe për shtrimin e rrugëve.
- Analizimi laboratorik i kampionëve të marrë gjatë kryerjes së kërkimeve.
- Raportimi i të gjithave sa më sipër ku do të përfshihenskicat e planimetrisë, skicat e profilit, fotografitë, regjistrave, rezultatet e analizave, si dhe përshkrimi i qëllimit të punës, datave, metodave të përdorura, rezultateve të përfuara, përfundimeve dhe rekomandimeve.

Kërkimet gjeoteknike do të kryhen edhe në zona që ndodhen jashtë Fazës 1, por të cilat mund të kërkohen një Zhvillim të Fundit, si dhe shpimet e marrja e mostrave në zonat e pastrimit të trupave ujqorëdo të shtrihet deri në të paktën 1 metër poshtë thellësive përfundimtare.

Për qëllime të studimit detar, Konsulenti do të veprojë në bashkëpunim dhe do të konsultohet me Rojën Bregdetarë Shqiptare për të marrë miratimet e nevojshme, si dhe do të bashkëpunojë për të kryer studimet batimetrike si dhe studimet e tjera.

Konsulenti do të vlerësojë edhe masën e ndikimit që projekti do të ketë në lëvizjen e sedimenteve dhe cilësinë e ujit. Ai do t'i raportojë APD-së lidhur me këtë aspekt së bashku me rekomandimet përkatëse për të gjitha kërkimet e kryera në kantier, modelimi dhe studimi për qëllime të projektit dhe VNM. Të gjitha këto do të përfshihen në planin e kërkimeve në kantierin e propozuar.

Përveç kësaj, Konsulenti do të sigurojë të dhënat më të fundit e të besueshme meteorologjike për projektin dhe VNM, përfshirë reshjet e shiut, lagështinë, shikueshmërinë dhe temperaturën e ajrit. Matja e të dhënave duhet të jetë bërë për një periudhë të gjatë. Të dhënat do të përpunohen nga Konsulenti në një formë që është e me vlerë për projektin dhe VNM.

## 6 Studimi

### 6.1 Të përgjithshme

Pas rishikimit të dokumentacionit ekzistues dhe në përputhje me master planin e përditësuar, Konsulenti do të përgatisë një plan të përditësuar për portin e ri, duke përfshirë në të gjetjet e tij dhe duke bërë rregullimet pas marrjes së rezultateve të kërkimeve të kryera në kantier. Plani do të përfshirë, pa kufizim, të gjitha punimet dhe impiantet e kërkuara për portin. Për Fazën 1 dhe për fazat pasuese deri në Zhvillimin Përfundimtar do të përgatiten plane të veçanta..

Në studim do të përfshihen:

- Kërkesat funksionale:
  - Terminali shumëshërbimësh (TSHSH).
  - Terminali i mallrave rifuxho (TMR).
  - Administrimi i portit dhe funksionet e lidhura me të.
- Kërkesat operacionale në përgjithësi:
  - Lundrimi – kanali i qasjes, zona e kthimit, baseni, vendet për ankorim.
  - Vëllimet e mallrave, trajtimi, magazinimi dhe shpërndarja/marrja në dorëzim.
  - Lidhjet e brendshme – rrugë, hekurudhë.
  - Operatorët e terminalit, kontraktorët e rimorkiatorëve / pilotimit, përdoruesit e portit.
  - Administrata e portit dhe agjenci të tjera qeveritare, autoritetet lokale.

Nga të dhënat e mbledhura nga kërkimet e kryera në kantier, që do të përpunohen dhe analizohen, do të përftohen veçoritë fizike të materialeve që do të bëjnë të mundur përcaktimin e sa më poshtë:

- Natyrën e materialeve që do të pastrohen.
- Qëndrueshmërinë e shpateve me trupat ujore të nxjerra nga pastrimi.
- Ngarkesën e sedimenteve në ujë.
- Natyrën e materialeve nën valëpritisit, argjinaturat e zonat që do të bonifikohen dhe zonat ekzistuese tokësore brenda kufirit të portit.
- Gjendja e themeleve për muret e moleve, strukturat e tjera dhe punimet.
- Cilësia e materialeve për mbushje dhe e gurëve për mbushje që do të përdoren për valëpritisit dhe pritat dallgëthyese, si dhe për bonifikimin e zonës së portit.

## 6.2 Detyrat

Konsulenti, për tëmbuluar zhvillimet për Fazën 1 dhe Zhvillimin Përfundimtar, do të kryejë, pa kufizim, detyrat e mëposhtme:

- Do të konsultojë me palët e interesuara të portit, përfshirë edhe ato të përfshira në listën më sipër, kërkesat e tyre.
- Do të verifikojë distancat e sigurisë nga vendet ekzistuese të ankorimit të naftës/gazit si dhe rezervuarët e magazinimit.
- Në varësi të rezultatit të planimetrisë që do të miratohet sipas udhëzimeve të dhëna nga APD, do të përditësojë planimetrinë e portit aktual ose do të përgatisë një planimetri për një port alternativ.
- Do të konfirmojë se shërbimet e propozuara detare do të jenë në gjendje të përballojnë me siguri dhe efikasitet numrin e parashikuar të anijeve në periudhat e pikut.
- Do të kryejë vlerësime të pavarura për të verifikuar ose propozuar përshtatjen esupozimeve ekzistuese, rregullime për trajtimin dhe magazinimin, kohën e ndërprerjes së operimit, kapacitetet, planimetritë, specifikimet dhe numrat e pajisjeve, si dhe do të modifikojë skicat e shërbimeve bregdetare sipas rastit. Për të vlerësuar kapacitetin në të ardhmen, do të marrë parasysh ndryshimet bindëse si rritjen e madhësisë të parcelave, zhvillimet teknologjike dhe përmirësimin e performancës operationale.
- Do të marrë në konsideratë të dhënat metro-oqeanike, parashikimet për ngritjen e nivelit të detit dhe uljen e raportuar në vendet e ngritura ekzistuese të kërcësive të vlerësuesve, ndarëset e mureve të molit, skajet e bonifikimit dhe të zonave të shtruara, si dhe kufirin e portit.
- Do të përcaktojë kriteret e projektit për të gjitha punimet, përfshirë jetëgjatësinë e projektit, ngarkesat (përfshirë ngarkesat e kryera nga pajisjet që mund të instalohen në një periudhë më të mëvonshme në Fazën 1), standardet e projektit/kodet e praktikës. Do të përfshijë të gjithë grumbujt e ngarkesapërfshirë të rrethit.
- Do të marrë në konsideratë madhësitë e anijeve të parashikuara, grupet dhe llojin e materialeve që do të pastrohen, do të konsiderojë nëse punimet e pastrimit të trupave ujorë duhet të kryhen në faza, si dhe do të rekomandojë dimensionet dhe thellësitë e kërkuesve në Fillim, Fazën 1 dhe fazat përfundimtare.
- Do të marrë në konsideratë parashikimin e përqendrimit të vëllimeve të mallrave për një periudhë deri në vitin 2050, do të konsiderojë nëse punimet në zonën e magazinimit duhet të kryhen në faza, si dhe do të rekomandojë dimensionet e kërkuesve për Fillimin, Fazën 1 dhe fazat Përfundimtare.
- Do të krahasojë opsionet për format e ndërtimit që do të përdoren për strukturat kryesore dhe shtrimet e rrugëve, si dhe do të rekomandojë formën që duhet të miratohet në lidhje me skicat e themeleve, do të marrë në konsideratë rreziqet e operationeve të grumbullimit me perkusion për të siguruar integritetin e instalacioneve ekzistuese të lëndëve petrokimike.
- Do të përgatisë planet e skicave për të gjitha punimet që do të kryhen në port, të cilat duhet të verifikohen/modifikohen më tej bazuar në rezultatet e përftuara nga kërkimet në kantier dhe modelimi, nëse janë të vlefshme në kohë. Planet do të bazohen në modifikimet e propozuara nga Konsulenti për specifikimet teknike të pasqyruara në Shtojcën 12, siç është rënë dakord



edhe me APD-në, si dhe do të përfshijë skicat në të cilat tregohen rregullimet e përgjithshme, nivelet dhe kryqëzimet tipike.

- Do të identifikojë depot e mbuluara, kullat e silosit dhe asete të tjera, të cilat do të sigurohen nga operatorët që do të jenë përgjegjës për projektin e detajuar.
- Do të përgatisë skica planimetrike për të gjitha punimet detare dhe bregdetare, duke treguar të gjitha trupat ujorë të pastruar, valëpritisit, bonifikimin, pritrat dallgëthyes, muret e moleve, zonat e magazinimit, ndërtesat, zonat e hyrjes, rrugët e aksesit dhe hekurudhat.
- Do të përdorë skicat e planimetrisë, do të tregojë kontejnerët dhe grumbujt e tjerë të mallrave, platformat për anijet frigorifer, direktët e ndriçimit dhe fluksin e trafikut.
- Do të prezantojë projektet dhe planimetritë për një kantier për riparimin e anijeve jashtë punimeve të Fazës 1.
- Do të përfshijë projektet e detajuara për vendet e ankorimit të Flotës/Rojës Bregdetare në Fazën 1.
- Do të përgatisë projektet dhe planet e integruara në të cilat do të paraqiten të gjitha kanalet kryesore kulluese, shërbimet e utiliteteve dhe themelet.
- Do të përcaktojë numrin e personelit që do të bazohet në dhe do të vizitojë terminalin dhe shërbim portual, si dhe do të përgatisë planet për vizitat mesatare dhe të mëdha.
- Do të përcaktojë kërkesat e zonës për çdo ndërtesë, për sallat kryesore të impianteve të utiliteteve dhe rezervuarët e magazinimit.
- Do të përcaktojë numrin e kamionëve dhe lëvizjeve me hekurudhë për në dhe nga secili terminal, si dhe shërbimet e tjera portuale në përgjithësi dhe në periudhat më të ngarkuara.
- Do të llogarisë numrin e korsive të trafikut që kërkohen te portat dhe në rrugët që të shpien në vijën kryesore, numrin e vendeve të parkingut për makinat/automjetet me dy rrota, si dhe numrin e hekurudhave dhe traseve rezervë që kërkohen për çdo terminal.
- Do të përcaktojë kërkesën totale për energji elektrike dhe ujë për portin në tërësi dhe për secilin terminal, bazuar në normat shqiptare të konsumit për përdorimin nga personeli.
- Do të plotësojë skicat me detaje të tjera, sipas kërkesave, me qëllim për të marrë në konsideratë edhe rezultatet e detyrave të përcaktuara më sipër.
- Do të përgatisë një përmbledhje me gjetjet për të përcaktuar një opsion për materialet e ndërtimit dhe heqjen e sedimenteve.
- Do të propozojë masa lehtësuese, nëse kërkohet, për të minimizuar ose shmangur ndikimet negative si shtimi i sedimenteve dhe erozioni në bregun aty pranë ose pasqyrimet e valëve të cilat kanë një ndikim në operacionet e terminaleve ekzistuese detare.
- Do të bëjnë një përlllogaritje të kostove të buxhetit për punimet dhe pajisjet që do të kërkohen në bazë vjetore për Fazën 1, duke përfshirë zëvendësimet dhe zërat kryesorë të mirëmbajtjes.
- Do të përgatisin një program në të cilin do të pasqyrohen të gjitha aktivitetet kryesore deri në përfundimin e Fazës 1, përfshirë skicat, tenderit, dhënien e kontratave dhe ndërtimin, si dhe kohëzgjatjen e zhvillimeve të tjera.

Gjithashtu, Konsulenti do të përgatisë studimet për rrugët dhe hekurudhat jashtë kufirit të portit, të cilat do të jenë si më poshtë:

- Rishikim i përgjithshëm i rrugëve dhe bashkimeve që paraqiten në dokumentet ekzistuese.

- Shënime udhëzuese për aspektet e përgjithshme të projektit lidhur me rrugët dhe hekurudhat mes portit dhe rrjeteve ekzistuese në afërsi të Durrësit, përfshirë gjeometrinë, të drejtën e kalimit, autorizimet, etj.
- Do të vlerësojë kërkesat e kapaciteteve për Fazën 1 si dhe numrin e korsive dhe të binarëve me qëllim për t'i plotësuar këto kërkesa.
- Do të përgatisë studimin për rrugët dhe hekurudhat në largësinë deri në 100 metra nga kufiri i portit, duke përfshirë hyrjet në port, kryqëzimet, trotuaret, bordurat, punimet në hekurudhë, barrierat, sinjalistikën, ndriçimin, kanalet e kullimit, korridoret/kryqëzimet e shërbimeve dhe punimet e lidhura me kanalet tokësore të kullimit.

### 6.3 Modelimi numerik

Konsulenti, duke përdorur të dhënat ekzistuese dhe matjet e përfuara nga kërkimet e kryera në kantier, do të kryejë sa më poshtë:

- Do të përcaktojë klimën e valëve për zonën e kantierit, e cila do të përdoret në modelimet e mëpasshme hidraulike.
- Do të modelojë rregullimet e valëve për planimetrinë e portit të propozuar sipas një sërë kushtesh, me qëllim për ta testuar dhe optimizuar planimetrinë duke përfshirë edhe basenet detare.
- Në varësi të gjetjeve të Konsulentit për ndikimin që do të ketë projekti te zhvendosja e sedimenteve dhe cilësia e ujit: modelimi për transportin e sedimenteve për të studiuar efektet që do të kenë punimet te rrjedhat dhe bregdeti aty pranë, do të bëjë një vlerësim për sedimentimin në të ardhmen dhe do të rregullojë grumbujt e sedimenteve në zonat e këtyre të fundit. Këtu do të përfshihen dhe shkarkimet nga kanalet artificiale të drenazhimit/stacionet e pompimit që ndodhen në portin e tipit MBM.
- Simulimi kompjuterik brenda një kohe shumë të shpejtë (në konsultim me pilotët) për të verifikuar lundrueshmërinë e kanalit të propozuar, zonën me kthesa dhe basenin në Fazën 1 dhe Zhvillimin Përfundimtar, duke përdorur anijet dhe rimorkiatorët përkatës. Planimetria e propozuar dhe paraqitjet vertikale përfshirë shpatet anësore duhet të paraqiten edhe në modelin e simulimit të anijeve. Nëse kërkohet, duhet bërë rishikimi i dimensioneve dhe thellësisë.

Për të gjitha modelimet numerike që Konsulenti propozohen të nën kontraktohen, detajet duhet të jepen në të gjitha fazat e shprehjes së interesit/ofertës.

Modelimi pritet të nisë gjatë fazës së planimetrisë dhe mund të shtrihet deri në fazën e projektit të detajuar.

### 6.4 Raportet

Konsulenti duhet të përgatisë një draft raport për studimin e përgjithshëm të elementeve bazë, në të cilin duhet të trajtohen të gjitha aspektet e përcaktuara më sipër. Ky raport duhet t'i dorëzohet APD-së. Pas marrjes së komenteve përkatëse nga APD, do të vijohet me rregullimin e përfundimitin e raportit, i cili do të dorëzohet sërish.

Gjithashtu, Konsulenti duhet t'i dorëzojë APD-së edhe raporte për përfundimin e modelimit hidraulik dhe simulimin e shpejtë.

## 7 VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR

### Përputhshmëria me aktet rregullatorë

Përmbajtja e VNM-së duhet të jetë në përputhje me:

- Të gjitha rregulloret statusore që janë në fuqi për miratimet mjedisore në Republikën e Shqipërisë.
- Procedurat në fuqi për Vlerësimin Mjedor të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, si ‘Parimet e Ekuatorit’.
- Direktivat e Bashkimit Evropian për Vlerësimin Mjedor.

Në afërsi të portit ndodhet njëtokë e madhe, e cila do të përdoret për zonën e portit dhe për zhvillimet e mundshme të zonës në të ardhmen. Procesi i blerjes së tokës dhe vlerësimi i ndikimit sociale që lidhet me këtë proces është marrë përsipër nga APD-it. Konsulenti duhet të angazhohet së bashku me APD-në për ndërfaqen mes këtyre studimeve.

### Kërkesat e VNM

Kërkesat e VNM janë si më poshtë:

Seksioni VNM	Kërkimi i përmbajtjes
Përmbledhja ekzekutive	Një përmbledhje e saktë e projektit të propozuar, baza e tij logjike, mjedisi ekzistues, ndikimet e konsiderueshme në mjedis, masat e rekomanduara lehtësuese dhe për përmirësim, propozimet për monitorim.
Përshkrimi i projektit	Pjesa hyrëse në të cilën trajtohet sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëllimi i VNM</li> <li>• Përmbledhje e projektit</li> <li>• Plani për kohëzgjatjen e projektit përfshirë kufirin kohor për këshillime publike, vlerësimi dhe zbatimin e projektit.</li> </ul>
Mjedisi rregullator	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmbledhje e politikave, rregulloreve dhe udhëzimeve që janë në fuqi dhe duhet të zbatohen për projektin bërja publike e përgatitjes së VNM.</li> <li>• Përmbledhje e konventave/marrëveshjeve rajonale dhe globale që janë në fuqi dhe të zbatueshme për projektin dhe bërja publike e përgatitjes së VNM.</li> <li>• Përmbledhje e kërkesave mjedisore dhe të miratimit për financimin e Projektit. Në kontekstin e përgatitjes së VNM, në këtë seksion duhet të trajtohen sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Procedurat në fuqi të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare për Vlerësimin Mjedor për të mbështetur kërkesat për financim.</li> <li>○ Kuadri Rregullator Ndërkombëtar dhe i Republikës së Shqipërisë, standardet, udhëzimet dhe marrëveshjet në fuqi.</li> <li>○ Qasja ndaj studimeve krahasuese me praktikën më të mirë.</li> </ul> </li> </ul>
Përshkrimi i projektit	Përshkrimi i saktë i projektit të propozuar brenda kontekstit të tij gjeografik, mjedor dhe socio-ekonomik. Në këtë përshkrim do të përfshihen informacione lidhur me faktin se Projekti është pjesë e një programi më të gjerë zhvillimi i cili ka për qëllim rihvillimin e Portit të Durrësit si njëqendër detare për pasagjerët dhe turizmin.
Përshkrimi i mjedisit	Përshkrimi i kushteve fizike, natyrore, mjedisore dhe socio-ekonomike në zonat si detare ashtu edhe tokësore, që do të preken nga ky Projekt. Në këtë seksion

ekzistues	<p>duhet të paraqitet një vlerësim i të paktën:</p> <p><i>Mjedisit Fizik</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klima</li> <li>• Ujërat nëntokësorë</li> <li>• Sipërfaqja</li> <li>• Fundi i detit</li> <li>• Baticat, dallgët, rrymat</li> <li>• Sedimentet</li> <li>• Burimet dhe cilësiat e ujit</li> <li>• Gjeomorfologjia dhe gjeologjia</li> <li>• Cilësiat e ajrit</li> </ul> <p><i>Mjedisit Biologjik</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Burimet biologjike dhe ekologjike</li> <li>• Flora dhe fauna detare e tokësore</li> <li>• Larmia e specieve të mbrojtura</li> <li>• Habitë të kritike</li> <li>• Ekosistemet</li> </ul> <p><i>Peizazhit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Peizazhi dhe ndikimet vizuale</li> </ul> <p><i>Pamje të përgjithshme socio-ekonomike</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhurma</li> <li>• Komuniteti</li> <li>• Peshkatarët</li> <li>• Infrastruktura ekzistuese</li> <li>• Grupet e cenueshme</li> <li>• Kultura</li> <li>• Shëndeti publik</li> <li>• Shëndeti dhe siguria në punë</li> </ul> <p><i>Ruajtja dhe Zonat e mbrojtura</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trashëgimia/ arkeologjike</li> <li>• Përdorimi i tokës dhe modelet për sistemimin e tokës</li> <li>• Zonat e mbrojtura detare</li> </ul>
Ndikimet e mundshme të Projektit	<p>Identifikimi i ndikimeve të mundshme mjedisore e sociale, që mund të lidhen me Projektin, duke përfshirë edhe ndikimet e mbledhura e të tërthorta. Në këtë seksion duhen marrë në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet në nivel lokal</li> <li>• Ndikimet në nivel kombëtar</li> <li>• Ndikimet rajonale/globale</li> </ul>
Analizimi i alternativave	<p>Një krahasim sistematik i alternativave të realizueshme për projektin për sa i përket vendndodhjes, teknologjisë ose modelit të projektit lidhur me ndikimin e mundshëm mjedisor.</p>

Dokumentat standarte të tenderit

<p>Karakteristikat e ndikimeve dhe problemeve</p>	<p>Në këtë seksion duhet identifikohen dhe të përshkruhen ndikimet pozitive dhe negative në mjedis lidhur me madhësinë, rëndësinë, kthyeshmërinë, shtrirjen dhe kohëzgjatjen. Duhet bërë identifikimi i të paktën ndikimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet pozitive të Projektit</li> <li>• Ndikimet sociale në komunitet</li> <li>• Ndikimet kryesore mjedisore që nga faza e ndërtimit, vënies në punë dhe mirëmbajtjes.</li> </ul> <p>Rekomandohet që të dhënat sasiore të përdoren sa më shumë të jetë e mundur. Në këtë seksion duhet të identifikohen edhe mundësitë për përmirësime mjedisore, si dhe duhet bërë edhe identifikimi i lidhjeve kyçe të pasigurta dhe mungesës së informacioneve.</p>
<p>Lehtësimi dhe administrimi i ndikimeve dhe problemeve</p>	<p>Në këtë seksion duhet të përcaktohen masat e mundshme me kosto efektive për të parandaluar ose për të minimizuar ndikimet mjedisore në një nivel të pranueshëm dhe për të trajtuar çështje të tjera mjedisore përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nevojën për të përmirësuar shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjësve</li> <li>• Koordinimin ndër-qeveritar</li> <li>• Angazhimin e komunitetit</li> <li>• Kërkesat për krijimin e kapaciteteve sipas Autoritetit Kontraktues ose në nivel komuniteti për realizimin si duhet të Projektit.</li> </ul> <p>Në këtë seksion duhet të paktën:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcaktohen masat për përmirësimin e aspekteve mjedisore brenda zonës mbi të cilën do të ndihet ndikimi i Projektit.</li> <li>• Të përcaktojnë natyrën e mbetjeve që do të kenë ndikime mjedisore ose do të shkaktojnë probleme, dhe për të cilat nuk është gjetur ende një zgjidhje.</li> <li>• Të përcaktojnë dispozitat financiare për administrimin e rreziqeve të mundshme. Për shembull, llogaritë escroë dhe mbulimi i sigurimit për të marrë masa për transferimin e të drejtave dhe heqjen e komisioneve, përmirësimin e terrenit, rrjedhjet e naftës, dhe emergjenca të tjera, etj.).</li> </ul>
<p>Monitorimi dhe Mbikëqyrja</p>	<p>Në këtë kapitull duhet të përcaktohet mënyra e monitorimit dhe administrimit në praktikë e ndikimeve dhe problemeve mjedisore. Në të duhet të përcaktohet gjithashtu edhe mënyra se si do të mbikëqyret projekti nga huadhënësit dhe agjencitë qeveritare. Në të duhet të trajtohet gjithashtu edhe faza e ndërtimit, faza e operacioneve dhe mirëmbajtjes, deri te faza e heqjes së komisioneve.</p> <p>Nga ana tjetër, duhet të bëhen parashikime për shpenzimet kryesore dhe për kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, në rastet kur është e mundshme.</p>
<p>Plani i menaxhimit</p>	<p>Do të identifikojë dhe përcaktojë të gjitha masat që kërkohen për të trajtuar ndikimet dhe problemet mjedisore e sociale, monitorimin dhe aktivitetet që lidhen me procesin e mbikëqyrjes. Në të duhet të përcaktohen gjithashtu përgjegjësitë e institucioneve, kufiri kohor dhe kostot e lidhura me to.</p> <p>Në këtë seksion do të përfshihet një përmbledhje e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planit të menaxhimit të palëve të interesuara</li> <li>• Planit për konsultimet publike</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Procesi për trajtimin e ankesave dhe pakënaqësive që lidhen me Projektin.</li> </ul>
Shtojcat	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Emrat e personave të tjerë përgjegjës për përgatitjen e VNM</li> <li>• Referencat dhe burimet e informacioneve</li> <li>• Procesverbalet e mbledhjeve dhe konsultimeve që janë mbajtur me publikun</li> <li>• Të gjitha të dhënat teknike, planet/raportet mbështetëse.</li> </ul>

## 8 STUDIMET E DETAJUARA

### 8.1 Të përgjithshme

Studimet e detajuara do të përgatiten për të gjitha punimet e Fazës 1. Falë tyre do të bëhet më i lehtë procesi i zgjerimit dhe përmirësimit me qëllim për të plotësuar kërkesat e Zhvillimit Përfundimtar.

Studimet do të përgatiten duke përdorur metodat e duhura moderne kompjuterike përfshirëndërtimin e bazave të modelimit të informacionit(BIM)].

Nëstudimin e detajuar të projektit do të përfshihen detyrat e mëposhtme:

- Plotësimi i modelimit numerik të specifikuar sipas fazës sëstudimit.
- Përcaktimi i modelimit fizik të valëve.
- Përgatitja e planit të detajuar për të gjitha punimet bazuar nëstudimet e përgatitura nga Konsulenti dhe të miratuara nga APD.
- Përgatitja e një raporti për studimin, duke përfshirë të gjitha veprimtaritë e studimit, supozimet, bazat dhe rezultatet, së bashku me njëprogram e vlerësim të kostove të punimeve.
- Ndhmon APD për përgatitjen e një plani për organizimet nga të cilët kërkohen lejet, miratimet dhe pëlqime paraprake për të vijuar dhe kryer punimet.

### 8.2 Studimi

Nëstudim do të përfshihen të gjitha elementet e punimeve të përcaktuara te specifikimet teknike dhe nëdokumentet e tjera, si dhe në të do të përfshihen, pa kufizim, aspektet e mëposhtme:

- Do të përcaktohen objektivat dhe vendndodhja e projektit.
- Do të përcaktohen funksionet dhe operacionet e terminaleve dhe të portit në tërësi.
- Do të konfirmohet planimetria dhe thellësitë e zonave që do të pastrohen nga trupat ujorë, si dhe do tëprojektohen shpatet anësore.
- Do të projektohet planimetria dhe karakteristikat e mjeteve ndihmëse për të shkuar në instalacionet e lundrimit në det dhe në tokë. Do të jepen këshilla për nevojën ose për një Sistemi i Monitorimit dhe Informimit të Trafikut Detar (VTMIS), duke marrë në konsideratë nivelet e trafikut detar në të ardhmen.
- Do të përcaktohen kërkesat për heqjen e sedimenteve, përfshirëvendndodhjet, limitet mbi planin dhe trashësinë e lejuar të materialeve.
- Do të përcaktohen burimet e duhura për materialet mbushëse dhe materialet mbushëse me gurë, metodat e transportit dhe shkarkimet gjatë punimeve, karakteristikat e materialeve mbushëse kur ndodhen në vend, si dhe masat përforcuese qëkërkohen për materialet për të

mbështetur në mënyrë tësigurtingarkesat pa i tejkaluar limitet e marrëveshjes gjatëkohëzgjatjes së projektit.

- Do të përcaktohen planimetria dhe paraqitjet vertikalee kërkuara për valëpritisit dhe pritat dallgëthyes, përfshirëmasat përforcuese të kërkuara për fundin e detit, me qëllim për të mbajtur strukturat në të gjitha kushtet. Paraqitje vertikale të detajuara në të cilat do të përfshihen të gjitha argjinaturat, nënshtresat, mbrojtja kundër gërryerjes nga uji, filtrat dhe materialet e bërthamës, si dhe rendin dhe metodat e ndërtimit.
- Do të përcaktohen ngarkesat e projektit për të gjitha strukturat dhe trotuaret.
- Do të përcaktohen kërkesat e detajuara të mureve të molit, përfshirë mbrojtjen nga gërryerja e ujit (nëse kërkohet), të gjitha instalimet si shtyllat e ankorimit, vardallarët dhe shkallët, masat për trasetë e vinçit dhe shërbimet e tjera të kryera me viç, të gjitha shërbimet, instalacionet dhe kullimi i ujërave sipërfaqësorë.
- Do të përcaktohen kërkesat e planimetrisë dhe të ngarkesës për të gjitha zonat e rrugëve të shtruara përfshirë zonat e magazinimit të mallrave.
- Do të përcaktohen nivelet e ngritjes përfundimtare të të gjitha zonave në port së bashku me sistemin e kullimit.
- Do të përcaktohen kërkesat funksionale dhe hapësinore për të gjitha ndërtesat deri në fund të periudhës së operimit.
- Do të përcaktohet planimetria dhe kërkesa për të gjitha shërbimet utilitare dhe do të realizohen diagrame të detajuara për rrjetin për secilën prej tyre. Do të përcaktohet kërkesa e përgjithshme e portit për energji elektrike, ujë dhe kanalizime në bashkimet me rrjetet e ardhshme publike.
- Do të realizohet studimii detajuar i të gjitha punimeve që kërkohen të kryhen, me qëllim që terminalat dhe portit të vihen në punë, me përjashtim tëdepove të mbuluara dhe kullave të silosit, të cilat do të sigurohen nga operatorët, si dhe duke përjashtuar ndërtesat për autoritetet qeveritare, të cukët do t'i sigurojnë vetëobjektet e tyre.
- Do të përfundohet studimi dhe plani për të gjitha punimet që kërkohen të kryhen për rrugët dhe hekurudhat brenda një distance 100 metra nga kufiri i portit.
- Do të sajohet një rend ndërtimi për të gjitha seksionet kryesore të punimeve, si dhe do të tregohen lidhjet mes tyre.
- Do tërealizohet një plan për testet e pranimit, të cilët duhet të jenë të specifikuar në kontratat e punimeve për secilin element të punimeve.
- Do të hartohet një listë me manualet e mirëmbajtjes, të cilët do të specifikohen në kontratën e punimeve për secilin element të impiantit dhe pajisjes.
- Do të rekomandohet se cilët asete do të mirëmbahen nga operatorët e terminalit dhe cilët nga APD.
- Do të përcaktohen vëllimet kryesore të materialeve të ndërtimit, vëllimet maksimale ditore si dhe do të përcaktohet mënyra e mundshme për transportimin e tyre.
- Do të vlerësohen vëllimet ekzistuese dhe të ardhshme të sedimentimit në zonat e pastruara nga trupat ujorë.
- Do të bëhet një përmbledhje e statusit të aplikimeve dhe do të jepen lejet për ndërtimin dhe zbatimin e punimeve.

- Të gjitha detyrat e tjera që mund të kërkohen me qëllim që projekti të zbatohet në përputhje me rregulloret në fuqi.

Të gjitha studimet do të realizohen për të përmbushur kërkesat specifike të operatorëve të terminaleve, me të cilët Konsulenti do të bashkëpunojë ngushtë gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

### **8.3 Modelimi fizik**

Konsulenti do të kujdeset që modelimi fizik i valëve të kryhet në një laborator hidraulik të njohur, si më poshtë:

- Modelimi 3D i valëve të basenit të planimetrisë së portit, për planimetrinë në Fazën 1 dhe Zhvillimin Përfundimtar, për të testuar qetësinë, aftësinë e reflektimit, transmetimin, daljen e ujit mbi sipërfaqe, forcat e ankorimit dhe lëvizjet e anijeve në vendet e ankorimit për mallrat dhe vendet e njësive detare të ankorimit.
- Testimi 2D i paraqitjes vertikale të valëve për të provuar qëndrueshmërinë, reflektimin dhe transmetimin.

Konsulenti do të japë detaje lidhur me rregullimet e tyre për modelimin fizik të propozuar në fazat e VNM/ofertës.

Planimetria dhe studimet për valëpritësit do të modifikohen në rast se rezultatet nuk janë të kënaqshme, ose në rast se shikohet se kostot mund të zvogëlohen pa cenuar integritetin ose rendimentin.

### **8.4 Skicat**

Konsulenti do të realizojë skica të detajuara për të gjitha aspektet e projektit, në të cilat do të përfshihen pa kufizim informacionet e mëposhtme:

- Plani për vendndodhjen e projektit, bazuar në hartën aktuale me veçoritë ekzistuese.
- Planimetria ekzistuese e zonave detare dhe tokësore ku do të kryhen punimet, përfshirë terminalët detare përreth, bregdetin, dhe të gjitha instalacionet dhe veçoritë që ndodhen në breg, identifikimi i të gjitha objekteve që do të hiqen ose do të modifikohen, zonat që janë të disponueshme për t'u përdorur për një periudhë të përkohshme nga kontraktori.
- Planimetria ekzistuese e zonave detare ku do të kryhen punimet, në të cilën përcaktohet batimetria më e fundit dhe zonat tokësore me topografinë më të fundit, vendndodhjet e të gjitha puseve të hapura dhe kantieret e tjera për kërkimet e kryera në terren.
- Planimetria e punimeve që do të kryhen për pastrimin e trupave ujorë, përfshirë shpatet anësore dhe mjetet ndihmëse lundruese, paraqitjet vertikale të punimeve të pastrimit në vendndodhjet përkatëse. Diagramet që tregojnë vendndodhjen dhe shtrirjen e zonave për marrjen e materialeve të pastruara për bonifikim, eliminimi i sedimenteve të nxjerra nga pastrimi.
- Planimetria dhe paraqitja vertikale e valëve, përfshirë strukturat me kokë të rrumbullakët, që tregojnë zonat që duhen pastruar më parë nga trupat ujorë (nëse ka).
- Planimetria dhe paraqitjet vertikale të punimeve të bonifikimit, që tregojnë zonat që duhen pastruar më parë nga trupat ujorë (nëse ka), pritrat dallgëthyese, dhe të gjitha punimet e tjera



përforcuese në tokë. Do të tregohen edhe zonat e përkohshme ku do të kryejë punimet kontraktori.

- Planimetria dhe paraqitjet vertikale sistemit tokësor të drenazhimit dhe kanalet e devijimit.
- Plani, paraqitjet vertikale dhe ngritja e mureve të molit si dhe strukturat e themeleve të traseve të vinçit, detajet e vardallarëve, shtyllat e ankorimit, pajisjet e tjera të molit dhe të gjitha instalacionet për vinçat e molit.
- Planimetria e të gjithë portit dhe zonave të terminaleve, ku paraqiten të gjitha zonat funksionale dhe flukset e trafikut.
- Sinjalistika rrugore dhe sinjalistika në sipërfaqe.
- Planimetria e cila tregon të gjitha zonat e shtruara dhe peizazhet, së bashku me paraqitjet vertikale të secilës zonë të shtruar.
- Planimetria, paraqitja vertikale dhe detajet e traseve hekurudhore përfshirë barrierat rrugore dhe kryqëzimet.
- Planimetria e sistemit të kullimit të ujërave sipërfaqësorë dhe nivelet e fundit të rrugëve të shtruara, përfshirë detajet e kanaleve, tubacioneve, pusetave, interceptorëve, etj.
- Planimetria e të gjitha shërbimeve utilitare dhe detajet e tubacioneve, tubat e kabllor, kanalizimet, ndarjet, pusetat, etj., dhe lidhjet me shërbimet e instaluar nga të tjerët.
- Planimetritë, vendndodhjet dhe detajet e të gjitha instalacioneve utilitare, përfshirë kontrollet e portave, platformat për anijet frigorifer, direktet dhe shtyllat e ndriçimit, nënstacionet elektrike, gjeneratorët, rezervuarët e magazinimit, stacionin e pompimit, pikat e karburantit, etj.
- Detajet arkitekturore, strukturore dhe shërbimet e të gjitha ndërtesave, përfshirë shërbimet industriale dhe pajisjet në punishte, pajisjet e kuzhinës në mensa.
- Detajet të gardheve, portave, pengesave, CCTV dhe instalacioneve të tjera të sigurisë.
- Planimetria e terminaleve në të cilat paraqiten shërbimet nëntokësore, tubacionet e kullimit, binatë e mureve të molit, boshtet e çiftimit (sipas rastit), themele të tjera dhe instalacione të tjera që gjenden nëntokë.
- Planimetri të tjera dhe detaje, sipas kërkesave, për të paraqitur rregullimet e brendshme dhe modifikimet e bëra mes fazave pasardhëse të zhvillimit.

## 8.5 Preventivi

Për punimet kryesore do të realizohet një preventiv, i cili do të jetë i përbërë nga zëra të pasqyruar me detajet e mjaftueshme, me qëllim për të treguar se janë përfshirë të gjitha veprimtaritë dhe sasitë janë përlllogaritur në mënyrë të saktë. Për objektet e siguruar nga operatorët dhe autoritetet qeveritare do të përdoren seksione të veçanta.

Sasitë do të përlllogariten mbi bazën e planeve dhe skicave dhe nëzërat e pagesave të specifikuar do të përfshihen shumat e zbritura. Në këta zëra do të pasqyrohen edhe kostot e tërthorta të kryera nga kontraktori, miratimet dhe testimet nga palët e treta, kostot e konsulencës, si dhe pasiguritë fizike.

Në preventiv do të përfshihet edhe një parathënie ku do të specifikohet baza mbi të cilën është realizuar ky dokument si dhe metodat e përdorura për të përlllogaritur punimet gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

## 8.6 Parashikimet për kostot

Do të përgatitet një parashikim për kostot kryesore të Fazës 1, për të cilin do të përdoret i njëjti format i përdorur edhe për preventivin. Gjithashtu, do të përcaktohet edhe baza mbi të cilën janë realizuar parashikimet, përfshirë edhe supozimet e përdorura.

Do të përllogaritet gjithashtu edhe shpenzimet mujore gjatë kohëzgjatjes së kontratës së punimeve. Kostot do të jenë të vlefshme deri në datën e përgatitjes së parashikimeve dhe do të verifikohen duke përdorur si referencë projekte të tjera të ngjashme dhe në konsultim me kontraktorët. Kostot do të ndahen sipas monedhës lokale ose të huaj, si dhe në një seksion të veçantë do të paraqiten të gjitha taksat që janë të detyrueshme për t'u paguar Shqipëri.

Do të bëhet edhe njëparashikim për kostotvjetore të infrastrukturës dhe të mirëmbajtjes së pastrimit, përfshirë shkallën e shpeshtësisë së kryerjes së pastrimit të trupave ujorë.

Do të realizohet gjithashtu edhe një preventiv i veçantë meqë ndërtesat e mëposhtme lidhen me:Kapiteni i Portit

- Doganën
- Autoritetet shëndetësore
- Kontrollin/sigurinë e kufirit
- Shërbimet e urgjencës
- Flotën
- Rojën bregdetare

## 8.7 Programi

Konsulenti do të hartojë një program, ku do të paraqiten të gjitha aktivitetet kryesore që do të kryhen gjatëkohëzgjatjes së kontratës së punimeve, përfshirë të gjitha lidhjet mes aktiviteteve dhe zërave kritikë të rrugës. Gjithashtu, do të përcaktohen edhe supozimet e përdorura për hartimin e këtij programi.

## 8.8 Koordinimi me APD dhe të tjerët

Në të gjitha fazat e projektit, konsulenti do të konsultohet për të gjitha çështjet teknike me kapitenin e portit, policinë kufitare, shërbimet e urgjencës, autoritetet rrugore dhe hekurudhore, ofruesit e shërbimeve utilitare, operatorët ekzistues të terminaleve detarë, koncensionarët/operatorët e zgjedhur për terminalet, si dhe çdo organizatë tjetër që lidhet me to. Ai do ta ndihmojë APD-it për të përgatitur aplikimet për t'u pajisur me lejet e duhura për projektin.

## 8.9 Raportet

Konsulenti do të përgatisë një draft raport të detajuar në të cilin do të trajtohen të gjitha aspektet e lartpërmendura. Ky raport do t'i dorëzohet APD-së. Pas marrjes së komenteve përkatëse nga APD, do të vijohet me rregullimin e përfundimit të raportit, i cili do të dorëzohet sërish. Gjithashtu, Konsulenti do të dorëzojë pranë APD-së një raport për përfundimin e modelimit fizik.

## 9 DOKUMENTET E TENDERIT

Konsulenti do të përgatisë setin e plotë me dokumentet e tenderit për kontratën e kryerjes së punimeve për Fazën 1, në një mënyrë të lehtë që APD më pas të mund t'ua përcjellë kontraktorëve.

Pas miratimit nga APD, dokumentet do të jenë si më poshtë:

- Udhëzime për tenderuesit.
- Shtojcat me specifikimet përkatëse.
- Kriteret për vlerësimin dhe kualifikimin.
- Formularët e ofertës.
- Vendet që kanë të drejtë të marrin pjesë në tender.
- Kërkesat e sipërmarrësit.
- Kushtet e përgjithshme të kontratës.
- Kushtet e veçanta të kontratës.
- Formularët e kontratës.

Kushtet e përgjithshme të kontratës do të jetë Libri i Kuq FIDIC dhe dokumente të tjera të njohura ndërkombëtarisht.

Në kërkesat e tij, Sipërmarrësi do të përcaktojë specifikimet, skicat dhe informacionet plotësuese që japin një përshkrim të punimeve që do të kryhen. Ato do të bazohen në specifikimet dhe skicat e miratuara më parë.

Në dokumente duhet të përcaktohen dispozitat për Tenderuesit, me qëllim që të dorëzojnë plane alternative për elementet e punimeve, me kush që të paraqesin oferta si për projektet e specifikuarra ashtu edhe ato alternative.

Konsulenti do të përgatisë një set me dokumentet e tenderit, të cilat do të dorëzohen pranë APD-it. Pas marrjes së komenteve përkatëse nga APD, do të vijohet me plotësimin e përfundimin e dokumenteve, të cilat do të dorëzohen sërish.

## 10 AFATI DHE DORËZIMET E DOKUMENTEVE

### ***Dorezimi dhe miratimi i raporteve***

Projekti me të gjitha raportet e kerkuara do te dorezohet ne forme te printuar ne 5 (pese) kopje ne shqip dhe 5 (pese) kopje ne anglisht, te firmosura ne origjinal dhe ne formatet e kerkuar.

Projekti per miratimin e lejes se ndertimit do te dorezohet ne formatin e nevojshem per aplikim per leje zhvillimi ne sistemin e-leje dhe duhet te jete i firmosur me vule elektronike te secilit inxhinjer te firmes projektuese.

I gjithë materiali i projektit (ne CD) ne PDF versionet finale dhe ne formatin origjinal te punuar, kompatibel me programet AutoCAD, Word, Exel sipas pikës 4 më poshtë në vijim "Raportet" dhe nën-pikës 4.1 "Kërkesat për raportim" me një afat total maksimal prej 8 muajsh.

## 11 PËRGJEGJËSITË E APD-së

Gjatë kohëzgjatjes së projektit, APD do të jetë përgjegjës për veprimtari të ndryshme, duke përfshirë: Do të lehtësojë hyrjen në kantier të kontraktorëve dhe Konsulentin, të cilët do të kryejnë edhe kërkimet në terren.

Do të vërë në dispozicion të dhënat përkatëse që disponon.

Do të bëjë të mundur që Konsulenti të ketë akses në organizatat përkatëse.

Do të koordinojë me ministritë, autoritetet rajonale dhe bashkiake.

Do të bëjë aplikimet e duhura për t'u pajisur me lejet dhe për të marrë miratimet përkatëse për kryerjen e punimeve.

Do të merret me çështjet ligjore dhe financiare.

Do të rishikojë, komentojë dhe aprovojë në kohën e duhur të gjitha dokumentet e dorëzuara nga Konsulenti. APD do të japë komentet e tij lidhur me të gjitha draft raportet, një javë pas dorëzimit të tyre.

## **Shtojca - Gjeologjia, Raportimet, Licensat dhe Stafi**

### ***Studimi gjeologjik dhe gjeoteknik***

#### **Te pergjithshme**

Me qëllim që të përcaktohen parametrat gjeologjik dhe parametrat gjeoteknik si dhe profilet e truallit për zonën e bonifikimit, është e nevojshme të përgatitet një studim gjeologjik dhe gjeoteknik për investigimin e truallit.

Ky studim, përfshirë dhe shpimet e nevojshme do të shërbejnë për të identifikuar karakteristikat e shtresave të truallit, testuar fortësinë e truallit në terren dhe marjen e kampioneve për t'i testuar në laborator. Këto të dhëna do të përdoren nga konsulenti për të caktuar vlerat e parametrat karakteristik të truallit, për llogaritjet statike dhe të stabilitetit e strukturave.

Për investigimin e truallit aktual, do të duhet të kryhen punime shpimi dhe testet përkatëse të nevojshme për të nxjerrë rezultatet e duhura për punën e projektimit.

Shërbimet në lidhje me mekanikën e tokës, tërmetet dhe gjeotekniken përgjithësisht përfshijnë:

- Vlerësimin e tabanit fundor ujqor dhe konsulencën për punimet në lidhje me punimet e bonifikimit, thellimit dhe ndertimit të skolieres, për llogaritjen ngakesave të strukturave portuale që parashikohen të ndertohen, ku shërbime të tilla nuk mund të kryhen duke përdorur tabela standarte ose të dhëna të ngjashme psh. nga rregullat e ndërtimit.

## Dokumentat standarte të tenderit

- për marrjen e kuotimeve dhe supervizionin e punimeve përgatitore në vend për kryerjen e testeve laboratorike dhe testet në terren
- këshilla mbi sigurimin e strukturave të afër tyre
- zgjidhjen për produktin, zgjidhjen e depërtimit dhe të llogaritjeve statike në terren ku shërbime të tilla nuk mbulohen nga shërbime të tjera bazë
- studimet të përfshijnë cilesite statike dhe dinamike të dherave dhe shkëmbinjve që janë prezente në sheshin e propozuar për studim të cilat shërbejnë për llogaritjet për llogaritjen e themeleve
- Këshilla mbi masat për forcimin e themeleve me materiale shkëmbore
- gërmimet e pranuar dhe pikat e mbështetjes
- vlerësime të përgjithshme të kapaciteteve ngarkesë mbajtëse të strukturës së truallit dhe opsionet për themelet, që nuk lidhen me një ndërtim specifik ose punime inxhierike
- Sigurimin e cilësisë---

### **Qëllimi i punës për studimin gjeologjik dhe gjeoteknik**

Bazuar në kërkesat të specifikuar më lart, qëllimi i punës për investigimet e truallit duhet të konsistojnë në vlerësimin e tabanit fundor uhor dhe konsulencën e punimeve të themelit siç është përmendur më poshtë:

1. Rishikim i dokumentave ekzistuese dhe rënia dakort për fushën e shërbimit të projektit
2. Testet në terren
  - Mobilizimi dhe ç'mobilizim i plotë i pajisjeve për kryerjen e shpimeve me marrje të plote kampioni, teste të SPT dhe CPT-të si dhe për investigimet e mundshme gjeofizike të tokës
  - Përgatitjet për shpimet dhe për CPT-të

## Dokumentat standarte të tenderit

- Shpime, poshtë tabanit të tokës në nivelin e ujit të detit deri në -15 m nën taban, përfshirë SPT-të në pusin e shpimit, mbrojtja e kolonës së pusit me tubo rrethimi dhe mbas mbarimit të shpimit mbushja e vrimes me llac cimento.
  - Tetsti CPT ku përfshin depërtimin e konit deri në 15 m nën taban thellësi duke paraqitur rezistencën e konit në majë, fërkimin anësor dhe presionin e poreve – e matur nga niveli i tokës e poshtë.
  - Dokumentacioni fotografik i bërthamave të shpimit të vendosur në arka 4m ose 5m
3. Testet laboratorike si në pikën më poshtë “Investigimi i tokës dhe provat laboratorike”.
  4. Vlerësimin e parametrave fizike të truallit sikurse janë përberja granulometrike, pesha volumore, pesha specifike, kufinjte e plasticitetit.
    - Vlerësimi i parametrave mekanike sikurse janë: kundi i ferkimit të brendshëm, kohezioni, moduli i deformimit të matura me testet prej e drejte, prova e triaksialit, prova oedometrike.
    - Vlerësimi i tabanit ujor fundor bazuar në analizat fushore dhe laboratorike
    - Llogaritja e parametrave kyç të strukturës së truallit sikurse janë kapaciteti mbajtës dhe deformimi (uljet e truallit me kalimin e kohës)
  5. Paraqitja e rekomandimeve për gjendjen natyrore të truallit dhe masat për përmirësimin e tij.
    - Rekomandimet për tipet e ndryshme të themeleve bazuar në cilësitë e truallit të vlerësuara nga provat fushore dhe laboratorike dhe në peshën e ushtruar nga objektet.
    - Rekomandimet e duhura për studime më të detajuara në vendet ku janë objektet e rëndësishme sikurse janë kalatat e reja që do të ndërtohen ose godina me pesha të rënda
    - Instruksione për gjurmimin e themeleve dhe për mbajtjen e saj dhe të strukturës së thatë, dhe për të kontrolluar impaktin e projektit mbi strukturat ngjitur.

### **Dokumentat që do të dorëzohen**

Raportet ditore përfshirë regjistrit dhe shpimeve dhe një raport të përditshëm në vend.

E gjithë puna duhet të jetë certifikuar si e saktë dhe e plotë në përputhje me standartet dhe me specifikimet teknike. Kjo përfshin rregjistrat e shpimeve (standartin e peshkrimit, standartin e kruesjes së testeve, standartin e marrjes së kampioneve ruajtjen e tyre dhe dergimin në laborator), testet laboratorike (certifikatat për secilin test ku të jete i shënuar dhe standarti i kryerjes së testit), raportin e matjeve sizmike lloji i aparateve, standarti i matjeve dhe interpretimi i tyre, vizatimet gjeologjike, llogaritjet gjeoteknike.

## **Studimi mjedisor**

### **Qellimi i studimit**

Në projekt do të parashikohet realizimi i studimeve të nevojshme mjedisore sipas legjislacionit në fuqi dhe marrja e lejeve përkatëse mjedisore.

Bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi:

- Ligji Nr.10 081, Datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”; (Ndryshuar me ligjin nr.6/2015, datë 12.2.2015,)
- Ligji Nr. 10 431, Datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji Nr.10 448, Datë 14.7.2011 ”Për lejet e mjedisit”;
- Ligji Nr. 10 440, Datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Ligji Nr. 8905, Datë 06.06. 2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”
- Ligji Nr.8672, Datë 26.10.2000, “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t.iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.

Në fazën e hartimit të projektit, duhen marrë në konsideratë këto aspekte mjedisore:

Projekti të hartohet duke marrë në konsideratë një vlerësim të përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;

Në hartimin e projektit duhen identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit në mjedisin ku do të zbatohet.

## Dokumentat standarte të tenderit

Të krahasohen përparësitë dhe mangësitë e një projekti, të propozuar në variante të tjera të mundshme, që përmbajnë ndryshime:

- Në vendin ku do të zbatohet projekti
- Në përmasat dhe kapacitetet e tij
- Në teknologji
- Në krahasimet me gjendjen e mjedisit, nëse nuk do të zbatohet projekti
- Në përcaktimin e masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis.

Të merren në konsideratë normat e shkarkimeve të ndotësve të prishëm në ajër, ujë dhe tokë.

Të parashikohet marrja e masave të detyrueshme që mbështeten në teknikat më të mira të mundshme të ndërtimit dhe vënies në punë të projektit.

Të parashikohet marrja e masave të detyrueshme për mbrojtjen e ajrit, ujit tokës, biodiversitetit dhe për të penguar transferimin e ndotjes nga një përbërës i mjedisit tek një tjetër.

Të parashikohen kërkesat për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodikën e matjeve, frekuencën e tyre, procedurën e vlerësimit dhe publikimin e rezultateve.

Të parashikohen kushtet për kufizimin e ndotjes ndërkufitare mbi normat e lejuara.

Të parashikohet shkalla e rrezikut për aksidente me ndikim të rëndësishëm në shëndet e mjedis.

Me qëllim përcaktimin e kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike., Parlamenti Shqiptar ka miratuar Ligjin Nr. 10 440, Datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”. Ky Ligj është përafuar plotësisht me Direktivën 85/337/KEE të Këshillit, Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin”, të ndryshuar, numri CELEX:31985L0337, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr. 175, datë 5.7.1985, faqe 40-48.



Perpara fillimit të zbatimit të projektit, duhet të aplikohet për procedurat e pajisjes me Leje Mjedisore.

Përpara marrjes së Lejes Mjedisore, është i nevojshëm hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis VNM, nga një ekspert apo kompani e licensuar për këtë qëllim, ku do të identifikohen impaktet mjedisore dhe sociale që do të gjenerohen nga zhvillimi i projektit dhe masat për zbutjen e këtyre impakteve. Këto masa do të konsiderohen në pikat e Lejes Mjedisore dhe do të jenë kushte të detyrueshme për zbatim.

### **Raporti dhe kërkesat e përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis**

- 1 Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo moszbatimit të projektit.
- 2 Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.
- 3 Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë, dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.
- 4 Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projekti në fjalë, përfshihet në Shtojcën I, të Ligjit Nr. 10 440, Datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

### ***Raporti i kriterëve të projektit***

Konsulenti duhet të hartojë raportin fillestar të projekti i cili duhet të përmbajë (nder të tjera dhe pa u kufizuar):

## Dokumentat standarte të tenderit

- Pershkrimin e projektit dhe fushen e shërbimeve
- Kushtet e terrenit (meteorologjike, kushtet e detit, kushtet e truallit)
- Rezultatet e studimit topografik
- Rezultatet e studimit batimetrik
- Rezultatet e studimit gjeologjik / gjeoteknik
- Rezultatet e Studimit mjedisor
- Te dhenat sizmike
- Modelimi i valëve me software numeric Delft 3D, SWAN ose të tjere.
- Kriteret e projektimit për punimet e bonifikimit dhe strukturave të tjera mbështetëse, ku përfshihen standardet, referencat, jetëgjatësia e projektit, veprimet dhe ngarkesat nga strukturat portuale që do të ndërtohen në të ardhmen, ngarkesat sizmike, parametrat e tokës, materialet për projektin, faktorët e sigurisë për materialet, ngarkesat dhe projektimin gjeoteknik.
- Kriteret e projektimit për punimet e dallgëthyesve ku përfshihen standardet, referencat, jetëgjatësia e projektit, veprimet dhe ngarkesat nga strukturat portuale që do të ndërtohen në të ardhmen, ngarkesat sizmike, parametrat e tokës, materialet për projektin, faktorët e sigurisë për materialet, ngarkesat dhe projektimin gjeoteknik.
- Vizatimet përkatëse në shkallë.

### **Raporti teknik**

Konsulentit duhet të hartojë raportin teknik të projektit I cili duhet të përmbajë (nder të tjera dhe pa u kufizuar):

- Llogaritjet përkatëse për të gjithë projektin, si dhe modelimi i valëve me softëare numeric Delft 3D, SWAN ose të tjere.
- Metodologjia e zbatimit të punimeve. Ku të përfshihen skenarat e mundshëm të zbatimit të punimeve në fazë paralele dhe/ose të një pas njëshme.
- Projekti i zbatimit, vizatimet, specifikimet, preventive për punimet e bonifikimit.
- BoQ dhe metoda e matjeve për secilin komponent të projektit.
- Preventivat e punimeve do të paraqiten të vecantë për secilin komponent të projektit dhe një i përbashkët.

- Dokumentacionet e tenderit.

Specifikimeve Teknike per te gjitha zerat e punimeve, ku te perfshihet pershkrimi i detajuar, vizatime te detajeve apo ilustrime

Preventivit te Punimeve, i ndare ne grupe, zerat e se ciles te korespondojne me specifikimet teknike.

## **KAPITULLI II - Menaxhimi i kontrates**

### **1. Organi Pergjegjes i Autoritetit Kontraktues**

Organi pergjegjes per menaxhimin e kontrates dhe marrjen ne dorezim te projektit eshte:

Autoriteti Portual Durres, Drejtorise Teknike, Sektori i Zhvillimit dhe Infrastruktures

Autoriteti Portual Durres, Drejtoria e Mjedisit, Sektori i Standardeve dhe monitorimit mjedisor.

#### **1.1. Lehtesirat qe ofrohen nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose palet e tjera**

Të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në kete prokurim jane te hapur per te vëzhguar terrenin, objekt i realizimit te detyres se projektimit.

Autoriteti Portual Durres do te veje ne dispozicion te kontraktuesit te gjithe informacionin e nevojshem, gjate periudhes se zbatimit te kontrates, si psh

- planimetri ekzistuese te zones,
- rrjetin ekzistues infrastrukturor
- cdo informacion tjetër qe do te kerkohet nga projektuesi te nevojshem per realizimin e projektit.

Projektuesi, duhet te jete gjate gjithe periudhes se hartimit te projektit ne kontakt me specialistet e APD-se, per realizimin sa me optimal te projektit.

### **Logjistika dhe koha**

#### ***Data e fillimit dhe periudha e zbatimit***

**Data e fillimit te punes per projektimin eshte ajo e lidhjes se kontrates. Afati per perfundimin dhe dorezimin e projektit eshte 8 muaj.**

### **Kerkesat**

#### ***Lista e stafit projektues dhe deklarimet paraprake***

## Dokumentat standarte të tenderit

Subjekti projektues duhet të plotësojë dhe të paraqes gjatë procedurës së prokurimit:

Shtojcën 1 “Deklarata e shoqërisë dhe lista e grupit të projektimit”

Shtojcën 2 “Deklaratat e inxhinjereve projektues”

- për disponueshmëri për kryerjen e shërbimeve që kanë marrë përsipër të realizojnë,
- për konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulenti dhe stafi i tyre duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë.
- për konfliktin ndërmjet detyrave të konsulencës. Konsulenti dhe stafi i tyre duhet të vetëdeklarojnë se nuk janë apo do të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.
- për marrëdhënien me stafin e autoritetit kontraktor. Konsulenti dhe stafi i tyre duhet të vetëdeklarojnë se nuk kanë marrëdhënie biznesi ose familjare me një anëtar të stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejt ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen/monitorimin e kësaj kontrate.

### Raportet

#### ***Kerkesat për raportim***

<b>Emertimi i raportit</b>	<b>Permbajtja</b>	<b>Koha e dorezimit</b>
Raporti fillestar i projektit		Java 6
Raporti i studimit topografik		Java 8
Raporti i studimit batimetrik		Java 8
Raporti i studimit gjeologjik/gjeoteknik		Java 10
Raporti i vleresimit të ndikimit në mjedis		Java 12
Raporti i kritereve të projektit - Draft		Java 16-20
Projekt Zbatimi, Raporti Final - Draft		Java 24
Raporti i kritereve të projektit - Final		Java 24

Dokumentat standarte të tenderit

Projekt Zbatimi, Raporti Final (***)		Java 32
Projekti per miratimin e lejeve zhvillimore	I gjithe dokumentacioni dhe materiali teknik i duhur per aplikim dhe miratimin e lejes se ndertimit. (****)	

(\*) Konsulenti te hartoje specifikimet teknike per cdo etape pune dhe material qe do te perdoret ne veper. Keto specifikime duhet te mbeshteten ne standartet shqiptare ne fuqi, dhe ne standarte europiane duke treguar se ku jane mbeshtetur.

(\*\*) Bazuar ne llogaritjet edhe vizatimet e projektit, konsulenti do te hartoje nje liste me te gjitha zerat e punimeve qe jane pjese perberese e Listes Perfundimtare te Volumeve (Preventivit). Preventivi do te shoqerohet me tabelat e volumeve dhe menyren e llogaritjes se tyre. Cmimet do te jene sipas analizave teknike ne fuqi. Zerat e punimeve qe nuk jane parashikuar ne kete liste cmimesh njesi te miratuar, konsulenti do t'i shoqeroje me analizen e llogaritjes se cmimit.

(\*\*\*) Projekti duhet te jete ne perputhje me Standartet kombetare dhe nderkombetare te pranuar.

(\*\*\*\*) Projektuesi duhet te jete i gatshem dhe ne dispozicion per plotesimin e dokumentacionit te nevojshem te kerkuar nga institucionet pergjegjese per dhenien e lejes se zhvillimit.

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>6</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

---

<sup>6</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

**Shtojca 17**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Etj.

\* \* \*

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës nëfazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_

(me numra dhe fjalë)

Dokumentat standarte të tenderit

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)  
Etj.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikëtë mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*  
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it*  
Etj.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri, Nipti dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me \_\_\_\_\_ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



**Shtojca 18**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Dokumentat standarte të tenderit

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 19

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës**

#### **Neni 1 Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2 Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3 Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4 Praktikak Korrutive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korrutive. Veprimet korrutive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Neni 5 Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtun ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6 Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat,

diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

#### **Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

#### **Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

#### **Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

#### **Neni 12 Vendndodhja**

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

#### **Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

#### **Neni 14 Çmimi i Kontratës**

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### **Neni 15 Afatet e Pagesës**

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

#### **Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës**

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare

#### **Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### **Neni 18 Forca Madhore**

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

- 18.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmybtja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

### **Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

- 19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuadojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t’i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

### **Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar**

- 20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.



## **Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## **Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

- 22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

## **Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

- 23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

## **Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

- 24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

## **Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

- 25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të

Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## **Neni 26 Nënkontrata**

- 26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejtë të marrë pjesë në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nënsipermarrje.
- 26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

## **Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

- 31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

## **Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

- 28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar
- 28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

## **Neni 29 Baza Ligjore**

- 29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

### **Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 31 Përfaqësimi i Palëve**

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### **Neni 32 Lajmërimet**

- 32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

### **Neni 33 Llogaritja e Afateve**

- 33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

## Shtojca 20

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës**

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës

#### **Neni 1 Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është \_\_\_\_\_

1.2 Kontraktuesi është \_\_\_\_\_

#### **Neni 2 Sigurimi i kontrates**

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10 % te vleres se kontrates) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 3 Fillimi i Kontrates**

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të filloje më \_\_\_\_\_. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

#### **Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

4.1 Shërbimet do të kryhen në: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## **Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: \_\_\_\_\_

---

---

---

## **Neni 7 Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale**

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale me shumë minimale si vijon: \_\_\_\_\_

---

---

---

## **Neni 8 Kushtet e Pagesës**

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: \_\_\_\_\_

---

---

---

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

## **Neni 9 Pagesa Paraprake**

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë \_\_\_\_\_. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shumën do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: \_\_\_\_\_

---

## **Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

---

---

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Shtojca 21**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I PUBLIKIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR**

**Seksioni I Autoriteti Kontraktor**

**I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel/Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Adresa në Internet \_\_\_\_\_

**I.2 Lloji i autoritetit kontraktor:**

Institucion Qëndror

Institucion i Pavarur

Njësi e Qeverisjes Vendore

Tjetër

**Seksioni 2 Objekti i Kontratës**

**2.1 Numri i referencës së procedurës/lotit** \_\_\_\_\_

**2.2 Lloji i “Kontratave Publike për Shërbime”**

Konkurs Projektimi

Shërbime Konsulence

Shërbime të tjera

**2.2.1 Kontratë në bazë të Marrëveshjes Kuader**

Po

Jo

**Nëse Po, lloji i Marrëveshjes Kuadër**

**Me 1 Operator Ekonomik**

**Me disa operatorë ekonomikë**

**Të gjitha kushtet janë të përcaktuara**

Po  Jo

**2.3 Përshkrim i shkurtër i kontratës**

1 Fondi limit \_\_\_\_\_

2. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

**2.4 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në muaj  ose ditë

ose

duke filluar nga  me përfundim në

**2.5 Ndarja në LOTE:**

Po  Jo

Nëse Po, numri i LOTEVE:

**2.6 Opsionet:**

Numri i rinovimeve të mundshme(nëse ka):

ose: nga  në

**2.7 Kontrate me nenkontraktim:**

Po  Jo

**Seksioni 3 Procedura**

**3.1 Lloji i procedurës:** Shërbim Konsulence

**3.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

**Oferta më e mirë bazuar në:**

Çmimi  Propozimi teknik

**3.3 Numri i kërkesave të dorëzuara:**  **Numri i kërkesave të rregullta:**

**3.3.1 Numri i propozimeve të dorëzuara**  **Numri i propozimeve të rregullta**

#### **Seksioni 4 Informacion mbi kontratën**

**4.1 Numri i Kontratës:** \_\_\_\_\_ **Data e Kontratës** //

#### **4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Adresa e Internetit \_\_\_\_\_

#### **4.2.1 Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja e Internetit \_\_\_\_\_

#### **4.3 Vlera totale përfundimtare e kontratës** *(duke përfshirë lotet, opsionet dhe nenkontraktimin):*

Vlera \_\_\_\_\_ *(pa TVSH)* Monedha \_\_\_\_\_  
Vlera \_\_\_\_\_ *(me TVSH)* Monedha \_\_\_\_\_

#### **4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit :** \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ *(pa TVSH)* Monedha \_\_\_\_\_  
Vlera \_\_\_\_\_ *(me TVSH)* Monedha \_\_\_\_\_



#### 4.4 Informacione shitesë

---

---

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi   /   /

## Shtojca 22

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike]

### 1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel/Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Faqja në Internet \_\_\_\_\_

2. Lloji i procedurës: \_\_\_\_\_

3. Numri i referencës së procedurës/lotit \_\_\_\_\_

4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër \_\_\_\_\_

5. Fondi limit \_\_\_\_\_

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

Vlera e nenkontraktimit \_\_\_\_\_ me Tvsh Monedha \_\_\_\_\_

7. Data e lidhjes së kontratës \_\_\_\_\_

### 8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktorit

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Nr. NIPT \_\_\_\_\_

### Shtojca 23

## **FORMULAR PËR NJOFTIMIN E ANULIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

### **1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel/Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Faqja në Internet \_\_\_\_\_

**1. Lloji i procedurës:** \_\_\_\_\_

**2. Numri i Referencës:** \_\_\_\_\_

**3. Objekti i kontratës** \_\_\_\_\_

**4. Fondi limit** \_\_\_\_\_

**5. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 24, pika 1:

a) ;

b) ;

c) ;

ç) ;

d) ;

dh) ;

Etj. \_\_\_\_\_

**6. Informacione shtesë**

---

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi \_

## Shtojca 24

*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

*[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]*

### **FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data \_\_\_\_\_]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Ne Emer te: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës ]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që *[emri i ofertuesit të përcaktuar fitues]* t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të përcaktuar fitues]* ka derdhur një depozitë pranë *[emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimeve]* në një shumë prej *[monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me *[emri i autoritetit kontraktor]*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

**Shtojca 25.**

**FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Ankesë drejtuar: *Autoriteti Kontraktor*

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqëror).*

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

---

Adresa

---

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

E-mail

---

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

---

Firma e zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

## Seksioni II. Informacion për Procedurën

### 1. Numër Identifikimi

Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar(PK), Procedurë me Negociim(PN), Shërbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).

---

### 2. Autoriteti Kontraktor

Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

---

### 3. Vlera e Përlogaritur e Prokurimit

Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)

---

### 4. Objekti i Kontratës

Përshkrim i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve që blihen.

---

### 5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës

Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.

---

Data (viti/muaji/dita)

### 6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese

Data (viti/muaji/dita) nëse zbatohet

---

## Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

### 1. Baza Ligjore e Ankesës

(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)

---

## 2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

## 3. Lista e Shtojcave

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj**. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për prokurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

## Shtojca 26

### **DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR** ( KU TE GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA) **PER PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

[Përdorimi i këtij draft marrëveshje është detyruese për të gjitha Autoritetet Kontraktore që do të përdorin marrëveshjen kuadër)

Nr \_\_

#### **DATA:**

Kjo kontratë lidhet [*data*], midis [*emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor*] tani e tutje të referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [*emri dhe adresa e Kontraktuesit*] të përfaqësuar nga [*përfaqësuesi*], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë [*data*] bie dakord të furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e përcaktuara në:

- Këtë kontratë
- Formulari i Deklarimit të Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj kontrate.

#### **Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëve në vijim.

[*përshkrimi i përgjithshëm*]

1.2 Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatorët ekonomikë, palë në marrëveshje.P.sh. kurdoherë që Autoriteti Kontraktor i përfshirë në këtë marrëveshje, do të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate, duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të parashikuara, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe nuk do t'i lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktor vendosë të blejë më pak apo



më shumë sasi se sa ato të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktor vendos të mos blejë asnjë nga këto sasi për disa artikuj.

1.5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër:

\_\_\_\_\_

## Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimet për njësi për punë/mallra /shërbime janë treguar në Formularin e Cmimit të Ofertës.
- 2.2 Çmimet e njërive duhet të jenë fikse dhe nuk duhet t'i nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura në këtë marrëveshje kuadër.

## Nënshkrimet dhe Datat

<b>Për Kontraktuesin</b>		<b>Për Autoritetin Kontraktues</b>	
<b>Emri:</b>		<b>Emri:</b>	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrimi :	
Data:		Data:	
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## Shtojca 27

**DRAFTI I MARRËVESHJES KUADËR**  
**( KU JO TË GJITHA KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA)**  
**PËR PUNË / MALLRA / SHËRBIME**

**Emri i Autoritetit Kontraktor,**

Dhe

**Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Të nënshkruajnë këtë marrëveshje kuadër për Kryerjen e:** < vendosni titullin > me numrin identifikues : <vendosni Numrin e Prokurimit>

### **Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i kësajmarrëveshje kuadër është të vendosë rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes procesit të mini-konkursit vetëm ndërmjet operatorëve ekonomike që janë palë e kësaj marrëveshje kuadër.

1.2 Kjomarrëveshje kuadër nuk është një kontratë në vete por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen në bazë të saj.

1.3 Kontraktuesi është vetëm një nga palët e marrëveshjes kuadër.

### **Neni 2 Detyrimet e Palëve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, palë në këtë marrëveshje, do t'i dërgojë kontraktuesit "Ftesën për Ofertë" kurdo që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet të dorëzojë një ofertë kurdo që kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 3 Kontratat në zbatim të marrëveshjes kuadër**

3.1 Kontratat do të nënshkruhen vetëm pas procesit të mini-konkursit.

### **Neni 4 Procesi i mini-konkurrencës**

4.1 Procesi i mini- konkursit do të kryhet me të gjithë operatorët ekonomikë, palë në marrëveshjen kuadër, kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mallra/shërbime për Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hapë konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall/shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Oferte dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomike, palë në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë

## Neni 5 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

---

### Nënshkrimet dhe datat

<b>Për Kontraktuesin</b>		<b>Për Autoritetin Kontraktues</b>	
<b>Emri :</b>		<b>Emri:</b>	
Pozita:		Pozita:	
Nënshkrimi:		Nënshkrim:	
Data:		Data:	
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	